



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Kukës”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË KUKËS

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	11
II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit).....	13
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA	14
1. Objektivi i auditimit.....	14
2. Qëllimi i auditimit.....	14
3. Identifikimi i çështjes.....	14
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	15
5. Përgjegjësitë e audituesve	15
6. Kriteret e vlerësimit	15
7. Standardet e auditimit	16
8. Metoda e auditimit.....	16
9. Dokumentimi i auditimit.....	18
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	19
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	19
2.1 Auditim mbi menaxhimin fl.nciar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.	19
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	36
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit fl.nciar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.....	55
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	70
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.	118
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.....	126
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	132
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	147
MASA DISIPLINORE	166
V. ANEKSET	168

Lista e shkurttimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e FI.ncave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së FI.ncave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 524/1 Prot, datë 20.06.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 29.06.2023 deri në datë 04.08.2023, në subjektin Bashkia Kukës u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi Financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i asetëve, si dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 14 akt konstatime dhe 1 (një) akt verifikim.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtime, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas trajtimit të observacioneve për projektraportin, bazuar në shkresën me nr. 391 prot., datë 10.11.2023, nga Bashkia Kukës nuk është kërkuar që të kryhet takim përmbyllës pranë zyrave të KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raportin përfundimtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
I	Nga auditimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatua se: 1. Disa nga subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, nuk kanë paraqitur Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna. 2. Drejtuesja e Njësisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka kryer sigurimin e cilësisë së punës. Plani Strategjik pjesë e të cilit është dhe plani vjetorë është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2022-2024 me shkresën nr. 4448 Prot., datë 07.10.2021, bazuar në standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të FI.ncave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Plani vjetor i auditimit për vitin 2022 është ndryshuar me urdhrin nr.853 prot. datë 01.11.2022, plani i ndryshuar është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 6261 Prot. datë 02.11.2022. Në relacionin bashkëngjitur praktikës për ndryshimin e planit drejtuesi i njësisë		I mesëm	Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

	<p>shprehet se: “ndryshimi planit për vitin 2022 ka ardhur si rezultat i angazhimit të kësaj njësie në ndjekjen e zbatim rekomandimeve të lëna në vitin paraardhës nga auditimi i brendshëm, qenia e kësaj njësie në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH për periudhën qershor-korrik dhe mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion të kësaj njësie për vitin 2022.”</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masat e nevojshme që ndryshimi i planit të kryhej më përpara si dhe jo gjatë vitit, duke mos cënuar eficientë e punës audituese.</p>			
2	<p>Nga auditim i u konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, pasi planifikimi ka vlerën 146,581,425 lekë, ndërsa realizimi vlerën 209,035,532 lekë, ose në masën 143%. Tejkalimi i planit me 43%, nuk ka ardhur si rezultat i arkëtimit nga ndonjë taksë e pa mundur për tu parashikuar më parë, por nga mungesa e një plani të studiuar dhe të pa mbështetur në të dhëna reale të numrit të taksapaguesve privat dhe familjar, si dhe pa bërë llogaritje konkrete për të ardhurat që realizohen nga secila lloje takse dhe tarife vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mos identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në planifikimin jo të saktë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Kukës, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale.</p>		I Lartë	<p>Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë si dhe të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.</p>
3	<p>Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më 31.12.2022 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Kukës, ka marrë 14 vendime për prishje objektesh pa leje nga ku rezulton se janë ekzekutuar vullnetarisht 8 vendime janë në proces gjyqësor 2 vendime, janë anuluar nga IMTV 2 vendime, si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedurë për 2 vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara nga ana e IMT Bashkia Kukës, për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Në mënyrë të detajuar vendimet e mara nga IMT për prishjen e objekteve pa leje paraqiten në aneksin nr. 3 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.</p>		I Lartë	<p>Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatohet vendimi i prishjes së objektit si dhe të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.</p>

4	<p>Referuar analizimit të të dhënave bazuar në shkresën nr. 398 prot datë 03.02.2023, rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2022 është në vlerën 168,213,052 lekë, por duke marrë parasysh faktin që vlera për institucionet buxhetore prej 84,419,759 lekë nuk është regjistruar në thesar për arsyen e përmendur më lart, në total vlera e detyrimeve i takon të jetë 83,793,293 lekë (168,213,052 - 84,419,759). Përsa i takon vlerës së detyrimeve financiare për vitin 2022, Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, poshtë nivelit prej 25 për qind (< 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara, referuar shkresës përcjellëse në MFE. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës ka dërguar në MFE edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Sipas këtij plani shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 35,717,090 lekë, shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2024 është 45,650,000 lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2025 është 88,569,097 lekë. Gjithashtu, përsa i takon faturave të pa likuiduara rezultojnë 61 fatura të pa likuiduara për shërbime (tabelës 10/1) në vlerën 63,656,753 lekë, e cila nuk përputhet me totalin e raportuar në bilancin e vitit 2022 referuar llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila ka vlerën 0 lekë ndërsa llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” ka vlerën 392,934 lekë dhe llogaria 401-408 ka vlerën 66,592,381 lekë, në total detyrimet në pasiv janë në vlerën 66,985,315 lekë e cila nuk rakordon me detyrimet e raportuara në MFE.</p>		I Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.</p>
5	<p>Referuar akt rakordimit me degën e thesarit Kukës llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” paraqitet në vlerën 250,479,334 lekë e cila nuk rakordon me llogarit kundërparti në pasiv të bilancit, respektivisht llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” paraqitem në vlerën 23,392,531 lekë dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në vlerën 149,444,012 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për diferencën 77,642,791 lekë, ku nga 250,479,334 duhet të jetë 172,836,543 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.</p>		I Lartë	<p>Nëpunësi Zbatues të marrin masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” në vlerën 77,642,791 lekë.</p>
6	<p>Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 Bashkia Kukës nuk ka kryer procesin e inventarizimit çka do të thotë që llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike. Konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke mos</p>		I Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të pasqyruar në llogarit analitike inventariale. Nëpunësi zbatues të marrë masa për</p>

	<p>specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s' kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për llogaritë 32- "Inventar i imët", 202- "Studime dhe kërkime", 210- "Toka, Troje, Terrene", 211 - "Pyje, Plantacione" llog 212- "Ndërtesa e Konstruksione", 213- "Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore", 214 - "Instalime teknike, makineri e pajisje", 215- "Mjete Transporti".</p>			<p>hartimin e regjistrimit të aktiveve, me të gjithë elementët e nevojshëm të tij.</p>
7	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 5 (pesë) procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s'kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjen. Gjithashtu rezultoi se disa prej kërkesave të veçanta, në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, duke sjellë një konfuzion ndaj OE pjesëmarrës, nuk është sqaruar lidhja e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrës së kontratës. <i>Këto kritere nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP, vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurimet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.</i></p>		I Lartë	<p>Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.</p>
8	<p>Nga auditimi, u konstatua se për objektin "Godinë shërbimesh 3 kate", miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën "Rruga "Kosova", lagja nr.2, Kukës, në shqyrtimin e projektit të ndërtimit dhe mbivendosjen me plan sistemin, evidentohet që daljet konsol në katin e parë zhvillohen jashtë kufirit të pronës dhe nuk pasqyrohet me përmasat e sakta në planvendosjen e miratuar. Nga auditimi, u konstatua se për objektin "Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt", miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën "D.", Kukës, në përshkrimet dhe specifikimet e paraqitura në planvendosje nuk përputhen me projektin arkitektonik, pasi evidentohet që fasada lindore nuk është faqe kallkan.</p> <p>Nga auditimi, u konstatua se për objektin Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt", miratuar me vendim Nr.61,</p>		I Lartë	<p>Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar planvendosjen e paraqitur si edhe të dhënat e përshkruara në të, që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.</p> <p>Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të</p>

	<p>datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës, në dokumentacionet e ngarkuara në sistemin e-leje, të cilat vërtetojnë pronësinë e truallit dhe ndërtesës në të cilën do të zhvillohen katet shtesë, paraqiten të dhëna dhe përshkrime të ndryshme lidhur me sipërfaqen ekzistuese të ndërtimit përpara miratimit të shtesës.</p> <p>Nga auditimi, u konstatua se certifikata e përdorimit është miratuar përpara përfundimit të punimeve të ndërtimit në objektin: “Objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë dhe objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë”, miratuar me vendimin Nr.5489 datë 22/09/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në adresën Lagjja 5, Kukës.</p>			<p>miratuar.</p> <p>Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi objekte pa verifikuar më parë përfundimin e realizimit të punimeve të ndërtimit.</p>
9	<p>Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna konstatohet se, Bashkia Kukës ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 5927 prot., datë 11.10.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezultoi se Bashkia Kukës nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve.</p> <p>Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Kukës nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Projektraportit të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:</p> <p>- Nga 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat është realizuar pjesërisht 2 masë në proces zbatimi 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 13 masa.</p> <p>Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.</p> <p>Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Kukës, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Kukës nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm, për të cilën kjo masë rezultoi e pa zbatuar.</p>		I Lartë	<p>Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi.</p>
10	<p>Në objektin “Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”, sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “C.” ShPK me Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 305,672,177 lekë me TVSH, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet progresive, janë përfshirë volume punimesh të pakryera</p>		I Lartë	<p>Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 983,375 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht</p>

	në fakt, për 5 (pesë) zëra punimesh në shumën 983,375 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.			nga sipërmarrësi i punimeve OE "C." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 për zbatimin e punimeve.
11	Në objektin "Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar 'Havzi Nela', Kukës", sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE "C." ShPK me Nr.139Prot. datë 25.11.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 127,064,830.80 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet progresive, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 7 (shtatë) zëra punimesh në shumën 1,384,600 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.		I Lartë	Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuar më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 1,384,600 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "C." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.139Prot. datë 25.11.2022 për zbatimin e punimeve.
12	Nga auditimi rezulton se, referuar të dhënave të vëna në dispozicion, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqiten në vlerën 2,370,800 lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga DAPPLL për vitin 2022 është në vlerën 568,328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë.		I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë .
13	Nga auditimi rezultoi se struktura që administron dokumentacionin dhe përlogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Referuar auditimit të ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se në fundin e vitit 2022 në territorin e Bashkisë Kukës janë legalizuar 766 objekte me vlerë totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë për t'u paguar 28,513,783 lekë, kanë paguar detyrimin 142 qytetarë në vlerën 4,577,342 lekë dhe janë ende debitor ndaj bashkisë 624 qytetarë me vlerë 23,936,441 lekë. Vetëm për vitin ushtrimor 2022 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 109 qytetar në vlerën 5,904,323 lekë. Gjithashtu rezulton se, gjatë vitit 2022 nga ASHK nuk është dërguar informacion i plotë në Bashkinë Kukës lidhur me objektet e legalizuara.		I Lartë	Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 624 debitorë në vlerën 23,936,441 lekë .
14	Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Kukës konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën 146,202,964 lekë . Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën 30,166,419 lekë . Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më		I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit

	datën 31.12.2022, në Bashkinë Kukës janë në vlerën 176,369,383 lekë, e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) për buxhetin e Bashkisë Kukës.		2022 në vlerën: Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare në shumën 14,545,865 lekë (2247 familje); Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 161,823,517 lekë (471 subjekte); <i>a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.</i> <i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për njetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i> <i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i> <i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i> <i>e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</i> <i>f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</i>
15	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga strukturat e Bashkisë Kukës DAPPLL rezulton se në këtë bashki janë 4 subjekte (G.P., V.SH., S.P.A., D. 2001 SHPK) që rezultojnë aktiv në QKB dhe operojnë të pa pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, në kundërshtim me përcaktimet ligjore	I Lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G.P., V.SH., S.P.A. dhe D. 2001 SHPK dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.
16	Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Kukës u konstatua se për vitin 2022	I Lartë	Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike

<p>janë dhënë 25 masa “Dënim me gjobë”. Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2022 është 5,250,000 lekë. Janë paguar në mënyrë vullnetare vetëm 7 gjoba me vlerë 370,000 lekë dhe mbeten për tu paguar 18 gjoba me vlerë totale 4,880,000 lekë. Nga IMTV Kukës për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave rezulton se, ka filluar procesi për të arkëtuar gjobat që nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore. Të gjithë kundërvajtësit janë njoftuar për detyrimin që kanë si rezultat i shkeljes që është konstatuar nga IMTV.</p>		<p>të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale 314,710,000 lekë, nga e cila vlera 4,880,000 lekë i përket vitit 2022. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.</p>
---	--	--

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkia Kukës dhe japim opinion për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, fondet neto, investimet e aktivet afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar/kualifikuar

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të modifikuar (kualifikuar)**¹ për llogaritë vjetore të vitit 2022 të Bashkisë Kukës, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të shprehura në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit, që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 1700) Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi

¹ “Opinion i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore.

arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përshkrim i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë nivelin e materialitetit për shpenzimet, i cili ka vlerën 30,627 mijë lekë, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin saktë vlerën e tyre reale, si më poshtë:

-Nga grupi i auditimit u konstatua se referuar akt rakordimit me degën e thesarit Kukës. Llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” është në vlerën 250,479,334 lekë, ndërkohë që duhet të jetë 172,836,543 lekë pra është mbivlerësuar për vlerën 77,642,791 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

- Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit Financiar të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” më 31.12.2022 e cila paraqitet në vlerën 23,392,531 lekë.

- Nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022 respektivisht; për llogaritë 32- “Inventar i imët”, 202- “Studime dhe kërkime”, 210- “Toka, Troje, Terrene”, 211 – “Pyje, Plantacione” llog 212- “Ndërtesa e Konstruksione”, 213- “Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore”, 214 – “Instalime teknike, makineri e pajisje”, 215- “Mjete Transporti”.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Institucionit të Bashkisë Kukës.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit Financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashttrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DST, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një

auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Kukës janë evidentuar devijime nga kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar (kualifikuar).

Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë:

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia Kukës nuk ka ngritur një sistem efektiv të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën 501,005,576 lekë nga të cilat 52,583,154 lekë i përket vitit 2022.

-Në 5 raste në procedurat e prokurimit janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe konkretisht për procedurat me objekt: “Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit Kukës, Bashkia Kukës – Faza III”, “Rikualifikimi i shkollës së mesme të Bashkuar, Havzi Nela”, “Blerje karburanti viti 2022”, “Ndërtim i Rrugës Qendër Shtiqën-Aeroport” dhe “Ndërtim i rrugës Kolsh, gjatësi 1543 ml”.

-Nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratave të punëve civile u konstatua se në 3 raste nuk janë kryer punimet në përputhje me likuidimet e kryera nga ku rezultoi një dëm ekonomik në shumën 2,367,975 lekë.

-Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren.

1-Në 2 raste plan vendosja e paraqitur nuk është në përputhje me projektin e miratuar.

2-Në 2 raste nuk janë respektuar distancat minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

3-Në 1 rast dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-leje, paraqitet me deviacione të sipërfaqes ekzistuese të truallit para miratimit të shtesës për leje.

4-Në 2 raste realizimi i punimeve të ndërtimit nuk është në përputhje me leken e ndërtimit të miratuar.

5-Në 1 rast u konstatua se certifikata e përdorimit është miratuar përpara përfundimit të punimeve të ndërtimit.

8-Në lidhje me auditimin e IMTV rezultoi se janë vendosur në total 25 gjoba me vlerë 5,250,000 lekë, asnjë nga këto masa janë paguar vetëm 7 gjoba në vlerën 370,000 lekë dhe nuk janë marrë masat për arkëtimin e 18 gjobave të tjera në shumën 4,880,000 lekë, sipas parashikimeve ligjore.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 524/1 Prot, datë 20.06.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 29.06.2023 deri në datë 04.08.2023, në subjektin Bashkia Kukës u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E.M., *Përgjegjës Grupi*
2. H.I., *Anëtar*
3. J.G., *Anëtare*
4. S.D., *Anëtar*
5. O.F., *Anëtar*
6. S.H., *Anëtar*.

Titulli: Auditim Financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Projekt Raporti i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Kukës.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivi i auditimit.

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Kukës kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuar dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)²;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit Financiar në Bashkinë Kukës është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit Financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Kukës dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

²Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit Financiar për vitin 2022.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Kukës.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Kukës.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kukës, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave fl.nciarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin Financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Kukës është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Kukës. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për fl.ncat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH^{së}”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë Kukës, etj.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Kukës grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metoda e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Kukës me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale³.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe

³ ISSAI 1315

ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon⁴.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin Financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

⁴ *Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit*

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Zona Gjeografike: Kukësi kufizohet në veri me Bashkinë Krumë, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 933.86 km² me një densitet prej 63.59 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 51.38 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhëna të tjera: Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimit të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj).

Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshtit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash si dhe në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegan. Transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmendur të falimentojë tërësisht, sepse ajo industri ishte ngritur për të funksionuar në kushtet e një ekonomie të centralizuar. Mirëpo kjo shkaktoi shumë plagë sociale, duke krijuar një numër të madh të papunësh.

Misioni i Bashkisë Kukës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

2.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm Financiar publik.

Në zbatim të pikës nr. 1, dhe nën-pikës nr. 1.1, të programit të auditimit nr. 524/1 prot., datë 20.06.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit.
2. Struktura organizative me ndryshimet përkatëse.
3. Urdhrat për caktimin e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues.
4. Kod sjellje, etike ose udhëzim mbi zbatimin e etikës.
5. Urdhrat për caktimin e Koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit strategjik.

6. Deklarata e cilësisë, raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, pyetësorët e vetëvlerësimit të dorëzuar në Ministrinë e Financave.
7. Dokumentacion tjetër mbështetës.

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm Financiar publik.

1.1. Identifikimin dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raportit përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Auditimi për menaxhimin Financiar dhe kontrollin kryhet në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tjera që janë lëshuar për të zbatuar këtë ligj dhe synon të vlerësojë nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet e njësisë publike janë të përshtatshme dhe efektive për të ofruar shërbime publike dhe për të adresuar risqet me efikasitet dhe efektshmëri.

Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:

- Pajtohet me legjislacionin, aktet e brendshme dhe kontratat,
- Siguron informacione operative dhe financiare të besueshme e të plota, dhe
- Mbron informacionin dhe aktivitetet e saj.

Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në vetëvlerësimin e Bashkisë Kukës, të dhënat e mbledhura nga përgjigjet e pyetësorit të realizuar prej grupit të auditimit, si dhe rezultatet e testeve të kryera u konstatua se, komponentët e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit nuk po funksionojnë mjaftueshëm në gjithë strukturat e njësisë. Bashkia Kukës në përgjithësi ka realizuar hartimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit por nuk kryen sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator në fuqi, implementimin dhe monitorimin e tyre, duke cënuar cilësinë e shërbimeve publike dhe adresimin e reziqeve me efikasitet dhe efektshmëri.

Më poshtë, në mënyrë të detajuar argumentohet puna e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është bazë për menaxhimin e fondeve në njësinë publike, ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

Ky komponent përbëhet nga:

1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike

Nëpunësit e njësisë të vetëqeverisjes vendore duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përmendur më sipër, vendosur në dispozicion nga Bashkia Kukës u konstatua se për periudhën në auditim:

- Kodi i Etikës për institucionin, në të cilin përfshihen rregullat e nevojshme që duhen zbatuar nga stafi i punonjësve të Bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 305, datë 30.03.2022.

- Zhvillimi profesional i stafit i cili përfshin hartimin, implementin dhe monitorin e programeve të trajnimit nuk rezulton të jetë kryer (në evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nuk u evidentuan gjurmë të këtij procesi), veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

- Procesi i vlerësimit të punonjësve nuk rezulton të jetë kryer, (në evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nuk u evidentuan gjurmë të këtij procesi) veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

-Bashkia Kukës ka për detyrë funksionale “Trajtimin e kërkesave dhe ankesave, praktikat shkresore, marrdhëniet me publikun” në zbatim të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportele", Ligjin nr. 119/2014“Për të drejtën e informimit”, etikën në punë dhe zakoneve të mira si dhe në nenin 7 “Kërkesat dhe ankesat” Pikat 1,2,3, nenin 28 “Marrëdhëniet me Publikun” nenin 29 “Zyra e shërbimit me një ndalesë” të rregullores së brendshme.

Trajtimi i kërkesave dhe ankesave, praktikat shkresore, marrdhënia me publikun duhet të zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor të përmendur më sipër. Ky proces nuk fillon me regjistrimin në “Zyrën e Protokollit me një ndalesë” apo në protokollin e Bashkisë por qytetarët e interesuar për shërbime të ndryshme orientohen pranë drejtorive përkatëse duke paraqitur kërkesat e tyre verbalisht. Vërtetimet e lëshuara nga ky institucion përgatiten dhe protokollohen pa depozituar më parë nga qytetarët në “Zyrën e Protokollit me një ndalesë” apo në protokollin e Bashkisë një kërkesë me shkrim për tu pajisur me këto shërbime si dhe mungojnë formatet standarte të miratuara për aplikim sa i përket llojeve të shërbimeve që ofron ky institucion. Në evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se nuk kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave dhe mungon një analizë e këtij procesi ku të trajtohen problematikat e konstatuara me të cilat është ndeshur ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe plani i masave për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

- Rregullorja e brendshme është miratuar nga Kryetari Bashkisë me Urdhrin nr. 328, datë 05.04.2022 ,“Për rregulloren e brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës”.

Ky dokument shërben si instrument i rëndësishëm për menaxhimin e veprimtarisë të institucionit, koordinimin e punëve të administratës vendore dhe siguron një qeverisje efikase e në përputhje me interesat e nevojat e komunitetit lokal. Rregullorja e brendshme duhet të përmbajë informacionin e detajuar për politikat, procedurat, dhe standardet e veprimit brenda institucionit dhe njësisive të varësisë, ku përgjegjësitë dhe detyrat përcaktohen qartë dhe komunikohen ndaj të gjithë punonjësve, ajo duhet të jetë e përditësuar në mënyrë të vazhduar për të pasqyruar ndryshimet në mjedisin e punës dhe përshtatjen e tyre me standartet e përcaktuara në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Struktura organizative e miratuar për vitin 2022, përbëhet nga 713 punonjës. Në 68% të pozicioneve të strukturës të cilat përfaqësojnë 482 pozicione pune nuk janë të përcaktuara detyrat dhe kompetencat në rregulloren e brendshme të miratuar me Urdhrin nr. 328, datë 05.04.2022 „Për rregulloren e brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës”.

Pozicione në strukturë për të cilat nuk janë të përcaktuara detyrat dhe kompetencat janë konkretisht: Sekretari i Këshillit Bashkiak, Koordinator i Njësive Administrative, Sekretari i Sekretariatit të Këshillit Bashkiak, Drejtor Drejtorie, Shef Sektori, Kryenspektor i Policisë Bashkiake, Përgjegjës Sektori, Inspektor, Specialistë, Edukatore, Punonjës ndihmës/Roja Operative, Shofer administrate, Sanitare, Policë bashkiak, punonjës të sigurisë zjarrfikës.

Rregullorja e brendshme e Bashkisë Kukës nuk është hartuar, implementuar dhe përditësua në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi .ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 8, pika 2 dhe nenin 9, pika 1.1, gërma “b”, për funksionimin efikas dhe efektiv të veprimtarisë dhe realizimit të funksioneve dhe kompetencave të saj, duke cënuar cilësinë e shërbimeve publike dhe adresimin e rreziqeve me efikasitet dhe efektshmëri.

Gjate vitit 2022 janë protokolluar gjithsej:

- 75 vërtetime nga Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licensave.
- 36 vërtetime nga Drejtoria e e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit.

Këto vërtetime janë protokolluar pa kërkesë me shkrim nga qytetari pasi është bërë kërkesa verbalisht dhe është pranuar nga drejtoritë përkatëse. Protokollimi i vërtetimeve është bërë gjithmonë pas konfirmimit të titullarit.

Gjate vitit 2022 janë protokolluar gjithsej:

- 75 vërtetime nga Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licensave.
- 36 vërtetime nga Drejtoria e e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit.

Këto vërtetime janë protokolluar pa kërkesë me shkrim nga qytetari pasi është bërë kërkesa verbalisht dhe është pranuar nga drejtoritë përkatëse. Protokollimi i vërtetimeve është bërë gjithmonë pas konfirmimit të titullari.

Gjate vitit 2022 janë protokolluar gjithsej:

- 75 vërtetime nga Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licensave.
- 36 vërtetime nga Drejtoria e e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit.

Këto vërtetime janë protokolluar pa kërkesë me shkrim nga qytetari pasi është bërë kërkesa verbalisht dhe është pranuar nga drejtoritë përkatëse. Protokollimi i vërtetimeve është bërë gjithmonë pas konfirmimit të titullari.

1.2. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Në rregulloren e brendshme të institucionit duhet të jenë të përcaktuara procedurat për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse të cilat përcaktojnë rolin, fushëveprimin e nëpunësit autorizues dhe të stafit menaxherial. Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se për periudhën në auditim:

- Bashkia Kukës ka të përcaktuar por nuk kryen sipas procedurës së miratuar në rregulloren e brendshme hartimin, implementimin, ndjekjen dhe raportimin e brendshëm sa i përket realizimit të objektivave nga sektorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e Njësive Administrative për informacion të titullarit sipas fushave që ato mbulojnë veprime këto që nuk janë në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin të miratuar me Urdhrin e Ministrit të

Fl.ncave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

-Bashkia Kukës ka paraqitur raport vjetor monitorimi pranë Këshillit Bashkiak dhe në Ministrinë e Financave për realizimin buxhetin vjetor.

-Në Bashkinë Kukës mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, nuk ka plan menaxhimi për veprime korigjuese lidhur me mangësitë e evidentuara në këtë drejtim. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Nga Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.a, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit të administrimit dhe raportimit Financiar për efekt argumentim subvencioni sepse bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat.

-Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese që ai kryen.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë nëpërmjet vendim-marrjes.

1.3. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Bashkia Kukës në kuadër të organizimit, funksionimit dhe realizimit me efikasitet të objektivave të veta ka hartuar, miratuar dhe implementuar strukturën organizative. Linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë brenda institucionit nuk funksionojnë sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor mbi të cilin janë hartuar dhe implementuar. Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se për periudhën në auditim:

-Me urdhrin e Titullarit Nr. 352 Prot. datë 23.10.2019 “Për Caktimin e Nëpunësit Zbatues Bashkia Kukës”, z. M.I. është caktuar Nëpunësi Zbatues deri më datë 31.12.2022.

-Me urdhrin e Titullarit Nr.778 Prot. datë 20.12.2021 “Për Caktimin e Nëpunësit Autorizues të Nivelit të Dytë Bashkia Kukës”, z. G.GJ. është caktuar Nëpunësi Autorizues deri më datë 31.12.2022.

-Punonjësit të cilët janë pjesë e strukturës organizative të miratuar dhe kanë të përcaktuar detyrat dhe kompetencat në rregulloren e brendshme janë njohur me rregulloren e institucionit në formë shkresore ose elektronike.

- Numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 24.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/62 prot., datë 06.01.2022. Struktura organizative e Bashkisë Kukës është miratuar me Urdhrin nr, 04 datë.13.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë, kjo strukturë nuk është e shoqëruar me organigramën përkatëse, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 90/2012, datë 27.09.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21, pikat 1-2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit të miratuar me Urdhrin të Ministrit të Financave, nr. 108, datë 17.11.2016.

Realizimi i strukturës për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës	Fakt/Numër punonjës	Diferenca
2022	Janar	710	691	-19
2022	Shkurt	710	707	-3
2022	Mars	710	702	-8

2022	Prill	710	697	-13
2022	Maj	710	699	-11
2022	Qershor	710	701	-9
2022	Korrik	710	704	-6
2022	Gusht	710	699	-11
2022	Shtator	710	701	-9
2022	Tetor	710	701	-9
2022	Nëntor	710	705	-5
2022	Dhjetor	709	710	-1

Burimi i të dhënave: Bashkia Kukës.

-Nga Bashkia Kukës është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti e PBA-së. Në dokumentet e PBA-ve, nga ana e këtij institucioni është hartuar dhe miratuar strategjia me objektivat dhe prioritetet strategjike, në përputhje me ligjin organik të buxhetit si dhe plan veprimi i menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Janë kryer konsultime me palët e treta, grupet e interesit si dhe dëgjësat me publikun në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

1.4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Marrëdhëniet e punës në Bashkinë Kukës rregullohen bazuar në Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, përsa i përket punonjësve administrativë dhe terrenit ata i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se për periudhën në auditim ky institucion:

Referuar Kreut III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, në të cilin përcaktohet që:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.

- Kriteria dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent.

- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, për periudhën e auditimit viti 2022 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

Në rastet e largimeve dhe emërimeve në pozicionet drejtuese për vitin 2022 sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është

larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.

Për periudhën objekt auditimi në Në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Titullari i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, dhe luan një rol kyç për sa i takon, integritetit të informacionit Financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm dhe sjelljes etike. GMS ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë, të garantojë se komponentët e Menaxhimit Financiar e kontrollit dhe menaxhimi efektiv i riskut janë të pranishëm dhe funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Me Urdhrin nr, 137 datë.02.02.2022, të Kryetarit të Bashkisë z. S.GJ. është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2022, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, gërma “b”, neni 24, pika 2, pjesë e mbledhjeve të këtij grupi është dhe drejtuesi i njësisë se auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni u konstatua se, ky grup (GMS) është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit dhe Koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.4, nën pikat 1-5. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

2. MENAXHIMI I RISKUT

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ngjarjeve të mundshme apo situatave të cilat mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për, zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij, analizimin dhe rifreskimin e kontroleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut të miratuar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, hapa këto të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e prioriteteve lidhur me shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silllet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut. Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se për periudhën në auditim:

-Bashkia Kukës ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila rishikohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Por nuk ka marrë masa për implementimin dhe më tej kontrollin e funksionimit të kësaj strategjie. Në evidencat e vëna në dispozicion nga Bashkia Kukës nuk u evidentuan analiza konkrete sa i përket kontrollit të funksionimit të strategjisë së miratuar të riskut në nivel programi, aktiviteti, lidhur me nivelin e realizimit të objektivave, evidentimit të problematikave që patën ndikim në realizimin e objektivave dhe përgatitjen e planit të masave për minimizimin e riskut lidhur me to në të ardhmen. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, mungon vlerësimi për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, Aneksi 2, “Regjistri dhe matrica e riskut” si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të FI.ncave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.2, “Menaxhimi i riskut”.

3. AKTIVITET E KONTROLLIT

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit Financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesat.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin Financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullari i njësisë publike, miraton gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtaritë kryesore të njësisë dhe siguron që, të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm apo autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë

mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit duhet të ketë në përbërje të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë Financiar dhe transparencës”.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, të sigurojë se në përgatitjen e “Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës” do të përfshihen hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishëm për një sistem të shëndoshë të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit. Nga auditimi i dokumentacionit të përmendur më sipër vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se për periudhën në auditim:

Bashkia Kukës nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3, “Aktivitetet e kontrollit”.

Titullari i njësisë ka përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, i cili duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit.;
- Procedurat e sinjalizimit.

- Bashkia Kukës ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Kukës ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Kukës ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej

kontrollin e performancës, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. MONITORIMI

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, monitorimi synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Nëpërmjet vetëvlerësimit një përdorues i buxhetit përcakton nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, në të cilin rregullat dhe procedurat sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Duke plotësuar pyetësonin e vetëvlerësimit çdo nëpunës autorizues për çdo vit përgatit një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimet dhe objektivat, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin Financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është rritja e llogaridhënies së menaxhimit dhe inkurajimi i përpjekjeve për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi të nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

-Bashkia Kukës me shkresën nr.1129 prot.,01.03 datë.2023, ka hartuar dhe dërguar në MFE deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pyetësonin e vetëvlerësimit për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon Memaxhimi Financiar dhe Kontrolli.

Pjesë e shkresës përcjellëse nr.1129 prot.,01.03 datë.2023, është edhe plani i veprimit për menaxhimin Financiar dhe kontrollit në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit dhe Koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

5. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Titullari i njësisë publike miraton dhe vë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin Financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikim iëhtë shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, si dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me eficiencë dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përbushjes së objektivave në nivel aktiviteti dhe në nivel objektivash të përgjithshme për mbarë njësinë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Kukës dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht, sipas nivelit të hierarkisë shkëmbet në mënyrë shkresore dhe elektronike dhe verbale. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pasi menaxhimit i mungojnë raportet e nevojshme lidhur me performancën e njësisë në raport me objektivat e caktuara.

Titulli i gjetjes nr.1: KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Kukës funksionimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, komponentët e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit nuk po funksionojnë mjaftueshëm në gjithë strukturat e njësisë. Rekomandohet një vëmendje e shtuar nga ana këtij institucioni për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar.

Situata: Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në vetëvlerësimin e Bashkisë Kukës, të dhënat e mbledhura nga përgjigjet e pyetësorit të realizuar nga grupi i auditimit, si dhe rezultatet e testeve të kryera, u konstatua se komponentët e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit nuk po funksionojnë mjaftueshëm në gjithë strukturat e njësisë. Edhe pse ka përpjekje

për të arritur konsolidimin dhe përmirësimin e funksionimit ende ka hapësira për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit.

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Vërtetimet e lëshuara nga ky institucion përgatiten dhe protokollohen pa u depozituar më parë në protokoll një kërkesë me shkrim nga qytetarët për tu pajisur me këto shërbime si dhe mungojnë formatet standarte të miratuara për aplikim sa i përket llojeve të shërbimeve që ofron ky institucion. Në evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se nuk kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave dhe mungon një analizë e këtij procesi ku të trajtohen problematikat e konstatuara me të cilat është ndeshur ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe plani i masave për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se struktura organizative e miratuar për vitin 2022, përbëhet nga 713 punonjës, 68% të pozicioneve të strukturës të cilat përfaqësojnë 482 pozicione pune nuk kanë të përcaktuar detyrat dhe kompetencat në rregulloren e brendshme, konkretisht: Sekretari i Këshillit Bashkiak, Koordinatori i Njësisë Administrative, Sekretari i Sekretariatit të Këshillit Bashkiak, 16 Drejtor Drejtorie, 5 Shefa Sektori , Kryenspektori i policisë bashkiake, 10 Përgjegjësa sektori , 4 Inspektorë , 147 Specialistë dhe edukatore, 207 Punonjës ndihmës/Roja Operative/ Shofer administrate./Sanitare dhe 89 Policë bashkiak, punonjës të sigurisë zjarrfikës.

“Menaxhimi i Riskut”

Në evidencat e vëna në dispozicion nga Bashkia Kukës nuk u evidentuan analiza konkrete sa i përket kontrollit të funksionimit të strategjisë së miratuar të riskut në nivel programi, aktiviteti, lidhur me nivelin e realizimit të objektivave, evidentimit të problematikave që patën ndikim në realizimin e objektivave dhe përgatitjen e planit të masave për minimizimin e riskut lidhur me to në të ardhmen. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, mungon vlerësimi për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

“Aktivitetet e Kontrollit”

Bashkia Kukës nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

- Bashkia Kukës ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsisë. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie.

-Bashkia Kukës ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Kukës ka përfunduar hartimi dhe

miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës.

“Informimi dhe komunikimi”

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Kukës dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, sipas nivelit të hierarkisë shkëmbehet në mënyrë shkresore dhe elektronike dhe verbale. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pasi menaxhimit i mungojnë raportet e nevojshme lidhur me performancën e njësisë në raport me objektivat e caktuara.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Trajtuar gjerësisht në akt-konstatimin nr.1, datë 04.09.2023

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të bashkisë Kukës.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga Titullari i Bashkisë Kukës, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe KordI.tori i Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. Të merren masa për përcaktimin e detyrave dhe kompetencave sipas pozicioneve të strukturës së Bashkisë. Të kryhet motivimi i repsektimit të afateve për trajtimin e kërkesave/ankesave në mënyrë që të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve. Të merren masa që të plotësohet struktura e punonjësve si dhe krijimi i organigramave sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi: z. S.G.J. me detyrë Kryetar i Bashkisë , z.G.G.J. dhe z. M.I..

1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Nga shyrtimi i dokumentacionit të përmendur më sipër u konstatua se për periudhën në auditim Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar dhe përbëhet nga 1 (një) drejtor dhe 2 (dy) specialist, ku aktualisht drejtor i NJAB është emëruar Z. S.S..

NjAB Bashkia Kukës në veprimtarinë e saj për periudhën në auditim nuk ka vlerësuar si duhet auditimin e fushave me risk, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik”, neni 11 pika 2, gërmat “b” dhe “c” dhe neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm” gërmat “i” dhe “ç”.

Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Kukës për vitin 2022 nuk ka funksionuar bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” Neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm”, pika “2” gërmat “c” dhe “ç” si më poshtë:

c) audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;

ç) punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Nga auditimi dosjeve të punonjësve të Njësies së Auditimit Bashkia Kukës konstatohet se

-Znj.M.D. me arsim të lartë, profili ekonomi agrare është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB, Bashkia Kukës me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.183, datë 13.09.2019 pa qenë i pajisur me certifikatën e audituesit.

-Z.E.C. me arsim të lartë profili drejtësi është emëruar në detyrën e audituesit të brendshëm me urdhërin nr 370/8, datë 01.03.2016, pa qenë pajisur me certifikatën e audituesit.

-Znj.E.G. me arsim të lartë, profili ekonomik është emëruar në detyrën e audituesit të brendshëm me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.840, datë 26.10.2022 pa qenë i pajisur me certifikatën e audituesit .

NR	Emër Mbiemër	Roli në NJAB	Dt. e fillimit të punës në NJAB (dd/mm/vvvv)	Ka Certifikatë si AB në SP? (PO/JO)	Dt. e marrjes së certifikatës (dd/mm /vvvv)	Ekperienca punës në AJ apo AB përpara certifikimit si AB (për personat e pacertifikuar, eksperienca aktuale):	Ekperienca punës në AB pas certifikimit si AB(kjo pyetje vlen për audituesit e certifikuar):
1	S.S.	Drejtuës	05.11.2019	PO	Çertifikate Nr.1481. Korrik 2012	6 muaj	9 vite
2	E.C.	Specialist	02.09.2015	JO	Ne proces certifikimi	6 vite	----
3	M.D.	Specialist	13.09.2019	JO	JO	3 vite	----
4	E.G.	Specialist	26.10.2022	JO	JO	5 VITE	-----

Burimi i të dhënave Bashkia Kukës.

1. Karta e Auditimit të Brendshëm e cila është aplikuar për vitin 2022 është miratuar me Urdhërin nr. 847, datë 27.10.2022 të titullarit të institucionit. Nga kjo njësi nuk u paraqitën evidenca që tregojnë se është dërguar njoftim pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE lidhur me miratimin e saj, bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik pjesë e të cilit është dhe plani vjetorë shtë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2022-2024 me shkresën nr. 4448 prot., datë 07.10.2021, bazuar në standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Plani vjetor i auditimit për vitin 2022 është ndryshuar me urdhërin nr.853 prot.datë 01.11.2022, plani i ndryshuar është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 6261 prot. datë 02.11.2022. Në relacionin bashkëngjitur praktikës për ndryshimin e planit drejtuesi i Njesisë shprehet se:“ndryshimi planit për vitin 2022 ka ardhur si rezultati i angazhimit të kësaj njësie në ndjekjen e zbatim rekomandimeve të lëna në vitin paraardhës nga auditimi i brendshëm, qenia e kësaj njësie në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH për periudhën qershor-korrik dhe mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion të kësaj njësie për vitin 2022.”

3. Raporti Vjetor i Veprimtarisë Audituese i miratuar nga titullari i institucionit për vitin 2022, është dërguar me shkresën nr. 423 prot., datë 07.02.2023, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, bashkëlidhur shkresës së përmendur më sipër ndodhen edhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkuese të raportit të përgatitur bazuar në standartet që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, Pika 3.6.

4. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuara bazuar në kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në të është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njesisë së auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në planin vjetor të auditimeve për vitin 2022 të përgatitur nga NJAB Bashkia Kukës dhe të miratuar me shkresën nr. 559 prot., datë 07.10.2023, subjektet që kanë qenë objekt auditimi për këtë periudhë paraqiten si më poshtë:

1. Zbatim rekomandimesh lidhur me rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm për vitin 2021 (Auditim Zbatim Rekomandimesh).
2. Drejtoria e Ujësjetës Kanalizimeve Sh.a” (Auditim i kombinuar)
3. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Auditim Përputhshmërie)
4. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (Auditim Përputhshmërie)
5. Policia Bashkiake (Auditim Përputhshmërie)
6. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit (Auditim i kombinuar)
7. Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimit (Auditim i kombinuar)
8. Njësia Administrative Bushtricë (Auditim Përputhshmërie)
9. Dr. e Rrugëve Rurale. (Auditim Përputhshmërie)

Për vitin 2022 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 9 auditime dhe janë realizua 6 auditime, e shprehur në përqindje 67% e auditimeve të planifikuara. Në relacionin bashkëngjitur ndryshimit të planit vjetor të auditimeve të miratuar nga Kryetari Bashkisë me urdhërin nr.853 prot.datë 01.11.2022 dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 6261 prot. datë 02.11.2022 drejtuesi i njësisë z. S.S. shprehet se ndryshimi planit për vitin 2022 ka ardhë si rezultati i angazhimit të kësaj njësie në ndjekjen e zbatim rekomandimeve të lëna në vitin paraardhës nga auditimi i brendshëm, qenia e kësaj njësie në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH për periudhën qershor-korrik dhe mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion të kësaj njësie për vitin 2022.

Për periudhën në auditim në bazë të evidencave të vëna në dispozicion nga njësia e auditimit të brendshëm u konstatua se janë kryer 6 auditime si më poshtë:

1. Zbatim rekomandimesh lidhur me rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm për vitin 2021 (Auditim Zbatim Rekomandimesh).
2. Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi .
3. Dr. e Rrugëve Rurale.
4. Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a.
5. Njësia Administrative Bushtricë.
6. Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimi (Auditim i Kombinuar për periudhën 01.06.2021 deri më 31.01.2006)

Bazuar në përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Seksioni VI, Kreu III, pika 1, programet kanë përmbledhur orientimet kryesore dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës.

Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022 dhe faza e zbatueshmërisë së tyre paraqitet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

VITI 2022							
Nr .	Subjekti i Audituar	Numri i rekomandimeve	Pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
1	Zbatim Rekomandimesh të dhëna për vitin 2021	303	303	16	15	15	272
2	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimin(MZSH) (2)	5	5	0	0	0	5
3	Drejtoria e FI.nces dhe Buxhetit	2	2	0	0	0	2
4	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	6	6	0	0	0	6
5	Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Sh.a	123	123	0	0	0	123
6	Drejtoria e Rrugëve Rurale	3	3	0	0	0	3
7	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri e Shpëtimin(MZSH)	14	14	0	0	0	14
8	Njesia Administrative Bushtricë	6	6	0	0	0	6
	TOTALI	462	462	16	15	15	431

Burimi i të dhënave: Bashkia Kukës.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 , datë 25.10.2016.

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare në përgjithësi është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

-Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 është hartuar, miratuar dhe dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MFE me shkresën nr. 423 prot., datë 07.02.2022.

Titulli i Gjetjes nr.2: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se: 1. Disa nga subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, nuk kanë paraqitur Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna. 2. Drejtuesja e Njesisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka kryer sigurimin e cilësisë së punës.

3. Plani Strategjik pjesë e të cilit është dhe plani vjetorë shtë dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2022-2024 me shkresën nr. 4448 Prot., datë 07.10.2021, bazuar në standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Plani vjetor i auditimit për vitin 2022 është ndryshuar me urdhërin nr.853 prot.datë 01.11.2022, plani i ndryshuar është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 6261 Prot. datë 02.11.2022. Në relacionin bashkëngjitur praktikës për ndryshimin e planit drejtuesi i njësisë shprehet se: *“ndryshimi planit për vitin 2022 ka ardhë si rezultati i angazhimit të kësaj njësie në ndjekjen e zbatim rekomandimeve të lëna në vitin paraardhës nga auditimi i brendshëm, qënia e kësaj njësie në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH për periudhën qershor-korrik dhe mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion të kësaj njësie për vitin 2022.”* Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masat e nevojshme që ndryshimi i planit të kryhej më përpara si dhe jo gjatë vitit, duke mos cënuar efencën e punës audituese.

Trajtuar gjerësisht në akt-konstatimin nr.1, datë 04.09.2023

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”; Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Kapitulli IV, pika 4.1.1 “Plafikimi i një angazhimi auditimi”, Kapitulli IV, pika 4.1.12 Hapi 11, Kapitulli VII, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet vetë nga NjAB”.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si FI.nca, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Nga neglizhenca, dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Të merren masa për plotësimin e strukturës me staf auditues në mënyrë të tillë që të mos çënohet plani i auditimeve si dhe të ketë një cilësi të lartë të punës audituese.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 2, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2022-2024;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2022;
- Vendimet e KB "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kukës" për vitin 2022;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit Kukës;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2022 i rakorduar me Degën e Thesarit Kukës;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Kukës;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021

Programimi i PBA 2021-2023 dhe programimi i buxhetit vjetor 2021

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kukës, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e taveve të shpenzimeve sipas programeve.

Bazuar në dokumentet e paraqitura (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat administrohen nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, programet buxhetore afatmesme dhe projekt buxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Për hartimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor nga njësitë vartëse që financohen nga buxheti i Bashkisë dhe nga Drejtoritë e Bashkisë janë përgatitur kërkesat buxhetore lidhur me nevojat dhe objektivat.

Treguesit për buxhetin afatmesëm të Bashkisë Kukës, për periudhën 2021-2023 janë miratuar me VKB-të si më poshtë:

- VKB nr. 169 datë 23.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021” konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/89 Prot, datë 05.01.2021, dërguar në MFE me shkresën nr. 109 Prot, datë 11.01.2021;
- VKB nr. 168, datë 23.12.2020 “Për miratimin e PBA-së për periudhën 2021-2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/92 Prot, datë 06.01.2021, dërguar në MFE me shkresën nr. 109 Prot, datë 11.01.2021;
- Relacioni i Buxhetit vjetor 2021 dhe PBA 2021-2023.
- PBA 2022-2024 miratuar me VKB Nr.72 date 24.12.2021 konfirmuar nga Prefekti me Shkresen Nr. 1/63 date 06.01.2022.
- Buxheti Vjetor 2022 miratuar me VKB Nr.71 date 24.12.2021 konfirmuar nga Prefekti me Shkresen Nr. 1/62 date 06.01.2022.

Miratimi i buxhetit vjetor për vitin 2022 është realizuar brenda afateve që janë të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Buxheti i vitit 2022 është miratuar me VKB nr. 71 datë 24.12.2021, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/62 Prot, datë 05.01.2021, Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2022 janë planifikuar sipas buxhetit fillestar në vlerën **1,409,268 mijë lekë**, sipas aneksit nr. 1 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Duke marrë në konsideratë buxhetin shtesë, shpenzime në total janë planifikuar në vlerën **2,053,903 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën **1,914,689 mijë lekë** me një diferenc në vlerën **139,214 mijë lekë**. Në mënyrë të detajuar plani përfundimtar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

2.3. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura. Përdorimi i të ardhurave

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2022

Për vitin 2022 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **2,053,903 mijë lekë**, ndërkohë që realisht shpenzime janë kryer në vlerën **1,914,689 mijë lekë** me një diferenc në vlerën **139,214 mijë lekë**, ose në masën **93.2%**. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri i shpenzimeve operative, i cili është planifikuar në vlerën 276,147 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 204,189 mijë lekë ose në masën 74%.

Në mënyrë të detajuar përdorimi i të ardhurave paraqitet si vijon;

Në 000/lekë

Emërtimi	Fakt 2022				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithsej	Tr.Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike	
230-Projekte	16,154		5,154	11,000	31.91
231-Investime	274,708		170,283	104,425	61.99
600-Paga	402,746	401,391	154	1201	0.04
601-Sigurime shoqërore	70,963	70,337	417	209	0.59
602-Shpenzime operative	204,189	118,718	85,471		41.86
604-Transf.Institucioneve	9,087	9,087			0
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	928,873			928,873	0
Kuotë qarku					
Të tjera	1,906,720	599,533	261,479	1,045,708	136

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Përdorimi i të ardhurave, viti 2022

Në totalin e shpenzimeve të kryera për vitin 2022 (në vlerën 1,906,720 mijë lekë, duke llogaritur vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK), shpenzimet të cilat janë mbuluar nga të ardhurat e veta janë në vlerën 261,471 mijë lekë ose në masën 13.8% ($261,479/1897,810 \cdot 100$). Duke analizuar vetëm vlerën e të ardhurave të përdorura, pra drejtimi se ku janë shpenzuar të ardhurat e veta për vitin 2022 (të cilat kanë vlerën 175,437 mijë lekë), konstatohet se 67% e tyre është përdorur për zërin investime ($175437/261/471 \cdot 100$), 32.6% në zërin i shpenzime operative dhe 0.4% në zërin paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Pra vihet re se përqindjen më të lartë të shpenzimeve, nga të ardhurat e veta, e zënë investimet në masën 67% dhe përqindjen më të ulët e zënë sigurimet në masën 0.4%.

Raportet e monitorimit mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 janë përgatitur raportet periodike si vijon:

Për vitin 2022, janë përgatitur dy raportet periodike 4-mujore të miratuara me VKB Nr.36, datë 31.05.2022 “Për miratimin e Raportit periodik katërmujor i buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Prill 2022”, VKB Nr.57, datë 22.09.2022 “Për miratimin e Raportit periodik të buxhetit të Bashkisë Kukës për periudhën Janar – Gusht 2022”, si dhe Raporti vjetor është miratuar me VKB nr.07 date 27.02.2023 “Per raportin e konsoliduar te buxhetit 2022” për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara

Raportimi i detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vlera e këtyre detyrimeve është llogaritur nga vetë njësia vendore. Bazuar në shkresën nr. 921 Prot, datë 23.02.2022, Bashkia Kukës ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrime të prapambetura në vlerën **193,913 mijë lekë** për vitin 2021 dhe për vitin 2022 ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë detyrime të prapambetura në vlerën **168,213 mijë lekë**, paraqitur sipas zërave në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 5: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Kukës sipas raportimit në MFE, 31.12.2022
Në 000/lekë

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2021	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2022-31.12.2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022
Investime	45,071		45,071	13,356	31,715
Investime nga FZSH			0		
Mallra dhe shërbime	30,168	113	30,281		30,281
Vendime gjyqësore	1,064	3,325	4,389		4,389
Të tjera	117,610		117,610	15,781	101,828
Totali	193,913	3,438	197,351	29,137	168,213

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, bazuar në raportimin sipas shkresës përcjellëse nr. 398 prot., datë 03.02.2023 në MFE, vihet re se detyrimet për investimet përbëjnë 18.8% të vlerës së detyrimeve totale, mallra dhe shërbime zënë 18% të vlerës së detyrimeve totale, vendimet gjyqësore zënë 0.2% të vlerës së detyrimeve totale, institucionet buxhetore zënë 60.2% të vlerës së detyrimeve totale.

Rezulton se vlera e detyrimit prej 84,419,759 lekë ndaj institucioneve të ndryshme shtetërore është raportuar në MFE por nuk është e pasqyruar në akt rakordimet me thesarin sepse rregjistrimi i këtyre detyrimeve është ende në proces rakordimi apo një pjesë janë në proces gjyqësor. Vlera e detyrimeve të rakordua me thesarin është **83,793,293 lekë** (168,213,052 - 84,419,759).

Nëse bëjmë llogaritjet me vlerën totale të detyrimit 83,793,293 lekë, pra pa llogaritur vlerën për institucionet buxhetore prej 84,419,759 lekë, vihet re se detyrimet për investimet përbëjnë 36.1% të vlerës së detyrimeve totale, mallra dhe shërbime zënë 37.8% të vlerës së detyrimeve totale dhe vendimet gjyqësore zënë 0.5% të vlerës së detyrimeve totale prej **83,793,293 lekë**.

Në bilancin e vitit 2022, llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” ka vlerën 0 lekë ndërsa llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” ka vlerën 392,934 lekë dhe llogaria 401-408 ka vlerën 66,592,381 lekë, në total detyrimet në pasiv janë në vlerën 66,985,315 lekë e cila nuk rakordon me detyrimet e raportuara në MFE.

Në vitin 2022 nga auditimi i pasqyrave financiare, vlera e llogarisë 520 – Disponibilitete në thesar (e cila tregon fondet e pa shpenzuara gjatë vitit 2022, të cilat kalojnë për përdorim në vitin 2022), ka vlerën 250,479,334 lekë. Pra në fund të vitit 2022, njësia vendore ka trashëguar fonde të lira për vitin 2022, në një vlerë prej 149,444,012 lekë më shumë se vlera e detyrimeve të prapambetura të rakorduara me thesarin është në vlerën (83,793,293 lekë).

Detyrimet e prapambetura sipas thesarit

Nga shqyrtimi i akt rakordimeve me Degën e Thesarit, vlerat e detyrimeve të prapambetura është **83,793,293 lekë**, të cilat paraqiten të detajuara sipas zërave paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela nr. 6: Detyrimet e prapambetura sipas akt rakordimeve me degën e thesarit Kukës

Nr.	Emërtimi i detyrimit sipas natyrës	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2022 (në lekë)
1	Vendime Gjyqësore	4,388,670
2	Shërbime	8,454,165
3	Mirëmbajtje	6,436,884
4	Investime	31,715,306
5	Mallra	15,390,098
6	Detyrime të prapambetura të tjera	1,660,300
7	Sigurime Shoqërore	8,929,703
8	Sigurime Shëndetësore	568,307
9	Të ardhurat personale	6,249,860
10	Të tjera	0
11	Paga	0
Totali		83,793,293

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Të dhënat e analizuara lidhur me detyrimet e prapambetura paraqiten në tabelën përmbledhëse në vijim, referuar dokumentacionit si bilanci, akt rakordimi me degën e thesarit, raportimi në MFE dhe listat analitike që disponon Bashkia Kukës.

Tabela nr. 7: Ndryshimi i detyrimeve të prapambetura nga viti 2021 në vitin 2022:

Llogaria	Emërtimi	Teprica 31.12.2021	Shtesa	Pakësime	Teprica 31.12.2022
4864100	Detyrime për Vendime Gjyqësore	1,063,545	3,325,125		4,388,670
4864200	Detyrime për Shërbime	12,682,171		4,228,006	8,454,165
4864300	Detyrime për Mirëmbajtje	6,465,584		28,700	6,436,884
4864400	Detyrime për Investime	45,071,088		13,355,782	31,715,306
4864600	Detyrime për Mallra	11,020,394	4,369,704		15,390,098
4864601	Detyrime për Sigurime Shoqërore	6,616,391	2,313,312		8,929,703
4864602	Detyrime për Sigurime Shëndetësore	15,801,265		5,232,958	568,307
4864603	Detyrime për Tatim mbi të Ardhurat Personale	1,274,221	4,975,639		6,249,860
4864604	Detyrime për Tatime të tjera		-		
4864900	Detyrime Të tjera	8,050,251		6,389,951	1,660,300
TOTAL		108,044,910	14,983,780	39,235,397	83,793,293

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës

Në datën 31.12.2021 gjendja e detyrimeve ka qenë në vlerën **108,044,910 lekë**. Gjatë vitit 2022 janë likuiduar detyrime në vlerën **39,235,397 lekë** dhe ka pasur shtesa të detyrimeve në vlerën **14,983,780 lekë**, duke bërë që teprica e detyrimeve në 31.12.2022 të rezultojë në vlerën **83,793,293 lekë**.

Tabela nr. 8: Përmbledhje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Kukës

Viti	Vlera e Detyrimeve sipas bilancit	Vlera e Detyrimeve sipas thesarit	Vlera e detyrimeve sipas raportimit në MFE	Vlera e detyrimeve nga dokumentet analitike
2021	108,044,910	108,044,910	193,912,437	108,044,910
2022	66,985,315	83,793,293	168,213,052	83,793,293

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion:

Në vitin 2022 nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në shkresën përcjellëse nr. 398 prot datë 03.02.2023 në MFE është përfshirë në llogaritje vlera e detyrimit që Bashkia Kukës ka ndaj institucioneve buxhetore, por nuk është bërë regjistrimi në thesar për arsye se janë ende në proces rakordimi dhe një pjesë e tyre janë në proces gjyqësor. Referuar analizimit të të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme (Tabela nr. 8), rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2022 është në vlerën 168,213,052 lekë, por duke marrë parasysh faktin që vlera për institucionet buxhetore prej 84,419,759 lekë nuk është regjistruar në thesar për arsyen e përmendur më lart, në total vlera e detyrimeve i takon të jetë **83,793,293 lekë** (168,213,052 - 84,419,759).

Trajtimi i vështirësive financiare për detyrimet e prapambetura

Bashkia Kukës, përsa i takon vlerës së detyrimeve financiare për vitin 2022, klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive në nivelin prej 25 për qind (< 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara. Ky informacion i referohet shkresës përcjellëse në MFE, nr. 398 prot datë 03.02.2023, ku është paraqitur niveli i vështirësisë në të cilin pozicionohet Bashkia.

Ky klasifikim është realizuar bazuar në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, Kreu XI, neni 56, ku referuar përqindjes që ka rezultuar nga llogaritjet për vlerën e stokut të detyrimeve, Bashkia Kukës është në vështirësi financiare. Klasifikimi i Bashkisë Kukës, si njësi e vetëqeverisjes vendore në kategorinë me vështirësi financiare tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 55, të këtij ligji.

Bashkëlidhur më shkresën nr. 398 prot datë 03.02.2023, Bashkia Kukës ka dërguar në MFE edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Sipas këtij plani shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 35,717,090 lekë, shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 45,650,000 lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2024 është 88,569,097 lekë.

Vendimet gjyqësore për ndërprerje të kontratës së punës

Nga shqyrtimi i listave analitike të detyrimeve të prapambetura për periudhën objekt auditimi rezultojnë se gjatë vitit 2022 nuk është likuiduar asnjë nga 6 vendimet që paraqiten në tabelën më poshtë (Tabela nr. 10), duke rezultuar kështu që në datën 31.12.2021 vlera e mbetur pa u likuiduar të jetë **4,388,670 lekë**.

Tabela nr. 10: Detyrimet e prapambetura nga vendime gjyqësore të tjera për vitin 2022 (në lekë)

Nr.	Përshkrimi	Vendimi	Data	Objekti	Vlera	Mbetur 31.12.2022
1	Largim nga Puna S. S.	312(247)	04.05.2016	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	798,560	798,560
2	Largim nga Puna D. B.	298	04.12.2020	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	760,000	760,000
3	Largim nga Puna I. D.	1295	28.12.2020	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	928,120	928,120
4	Largim nga Puna Sh. Sh.	260	25.03.2021	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	826,000	826,000
5	Largim nga Puna Y. Sh.	(1047)153	27.10.2020	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	556,950	556,950
6	Largim nga Puna L.S.	405	15.11.2021	Ndërprerje e marrëdhënieve të punës	519,040	519,040
Totali					4,388,670	4,388,670

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Kukës, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Përsa i takon vendimeve të tjera gjyqësore, për gjashtë vendimet e paraqitura në tabelën e mësipërme (Tabela nr. 10) nuk është kryer asnjë likuidim deri në datën 31.12.2022,

duke rezultuar kështu që vlera e mbetur për vitin në vijim për këto vendime të jetë 4,388,670 lekë që përputhet me vlerën e raportuar në MFE.

Faturat e pa likuiduara për vitin 2022

Nga dokumentet e analizuara, të paraqitura nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, për vitin 2022 rezultojnë pa u likuiduar deri në datën 31.12.2022, 61 fatura të pa likuiduara për shërbime dhe investime në **vlerën 63,656,753 lekë** dhe vlerë kontrate **520,903,284 lekë** të pa likuiduar, me burim financimi buxhetin e shtetit dhe të ardhurat e veta. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 3 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZSHH dhe Ministrisë së linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës/ Buxhetit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, në lidhje me investimet publike, u konstatua se:

- **Për financimet nga Ministritë e linjës, FZHR dhe donatorë të tjerë,** janë lidhur për vitin 2022 gjithsej 5 kontrata në vlerën 496,774 mijë lekë.

Për kontratat e vitit 2022 në vlerën 145,592 mijë lekë. Financuar në vitin 2022 vlera prej 45,000 mijë lekë, dhe mbetet akoma për likuidim vlera 334,695 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 4 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- **Për financimet nga buxheti Bashkisë Kukës dhe Grande.** janë lidhur për vitin 2022 gjithsej 68 kontrata në vlerën **358,745 mijë lekë.**

Për kontratat e vitit 2022 në vlerën **358,745 mijë lekë.** Financuar në vitin 2022 vlera prej **117,554 mijë lekë,** financuar me vonesë në vitin 2023 vlera prej **0 mijë lekë** dhe mbetet akoma për likuidim vlera **207,683 mijë lekë;**

Struktura organizative e Bashkisë Kukës

Miratimi i Strukturave për vitin 2022 janë miratuar me Vendimi i Këshillit Nr.71 date 24.12.2021, për miratimin e strukturës organizative dhe konfirmimi i Prefektit Shkresen Nr. 1/62 date 06.01.2022, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore.

Ndarja e strukturës

Emërtimi	Viti 2022	
	Plan	Fakt
Aparati i Bashkisë.	136	136
Gjendja Civile	12	12
Policia Bashkiake	52	52
Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	45	45
Qendra Kombetare e Biznesit	2	2
Drejtoria e Bujqesise dhe Bordi i Kullimit	20	20
Administrimi i Pyjeve	13	13
Rruget Rurale	8	8
Spektori i Gjellberimit dhe Ndriçimit	20	20
Menaxhimi i Mbetjeve	32	32
Urbanistika	16	16
Shërbimet Publike	52	52
Klubi Shumesportesh	10	10
Qendra Kulturore, Rinia dhe Integrimi	29	29

Arsimi Parashkollor	165	165
Arsimi Parauniversitar dhe Konvikti	41	41
Kujdesi Social	5	5
Çerdhet	35	35
Ndihma Ekonomike	20	20
Shuma	713	713

Nga verifikimi për raportin e punonjësve me status dhe me kontratë pune rezulton se:

a. Për vitin 2022:

Nga të punësuarit **95** janë me statusin e nëpunësit civil, marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjin nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, ndërsa **374** punonjës janë me kontratë pune marrëdhëniet e punës e të cilëve rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Sipas strukturës së miratuar me VKB,

a. Sa pozicione pune ka të vlerësuara me status të Nëpunësit Civil, gjithsej **95** pozicione, nga të cilat:

- 1 pozicion i kategorisë së lartë,
- **31** pozicione të kategorisë së mesme drejtues,
- **0** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese
- **63** pozicione të kategorive ekzekutive.

Në lidhje me largimet dhe emërimet sipas periudhave paraqiten në aneksin nr. 5 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Titulli i Gjetjes: *Bashkia Kukës për periudhën objekt auditimi, klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, nënë 25 % të shpenzimeve vjetore të miratuara.*

Situata: Në vitin 2022 nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në shkresën përcjellëse në MFE është përfshirë në llogaritje vlera e detyrimit që Bashkia Kukës ka ndaj institucioneve buxhetore, por nuk është bërë regjistrimi në thesar për arsye se janë ende në proces rakordimi dhe një pjesë e tyre janë në proces gjyqësor. Referuar analizimit të të dhënave bazuar në shkresën nr. 398 prot datë 03.02.2023, rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2022 është në vlerën 168,213,052 lekë, por duke marrë parasysh faktin që vlera për institucionet buxhetore prej 84,419,759 lekë nuk është regjistruar në thesar për arsyen e përmendur më lart, në total vlera e detyrimeve i takon të jetë **83,793,293** lekë (168,213,052 - 84,419,759). Përsa i takon vlerës së detyrimeve financiare për vitin 2022, Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, poshtë nivelit prej 25 për qind (< 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara, referuar shkresës përcjellëse në MFE. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës ka dërguar në MFE edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Sipas këtij plani shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 35,717,090 lekë, shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2024 është 45,650,000 lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2025 është 88,569,097 lekë.

Gjithashtu, përsa i takon faturave të pa likuiduara rezultojnë 61 fatura të pa likuiduara për shërbime (tabelës 10/1) në vlerën 63,656,753 lekë, e cila nuk përputhet me totalin e raportuar në bilancin e vitit 2022 referuar llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila ka

vlerën 0 lekë ndërsa llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” ka vlerën 392,934 lekë dhe llogaria 401-408 ka vlerën 66,592,381 lekë, në total detyrimet në pasiv janë në vlerën 66,985,315 lekë e cila nuk rakordon me detyrimet e raportuara në MFE.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për fl.ncat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 56, pika 1. Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Ndikimi: Identifikimi dhe vlerësimi në kohë i gjendjes së situatës financiare, në të cilën gjendet Bashkia Kukës, ndikon në marrjen e masave dhe hartimin e planeve të duhura të likuidimit të detyrimeve, për të ndihmuar në tejkalimin sa më shpejt të vështirësisë financiare.

Shkaku: Vonesat në likuidimin e detyrimeve ndaj palëve të treta për një kohë më të gjatë se afati i përcaktuar, masa shumë më e lartë që zënë detyrimet e konstatuara si të papaguara krahasuar me masën e përcaktuar në ligjin përkatës dhe mos realizimi në kohë i rakordimeve për regjistrimet në thesar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Financës në Bashkinë Kukës, z. M.I.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Struktura e Bashkisë Kukës për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Për vitin 2022, Struktura organizative e Bashkisë Kukës është miratuar me Vendimin e Kryetarit, nr. 04, datë 13.01.2022 “Për miratimin e strukturës organike, kategorive/klasës së pagave të administratës së Bashkisë Kukës”;

Në strukturën e Bashkisë Kukës për vitin 2022 Drejtorja e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave (DAPPLL) ka patur 18 punonjës në total sipas aneksit nr. 1 pika 2.6 bashklidhur projekt raportit të auditimit.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.

Titulli i Gjetjes: Mangësi në programimin e të ardhurave dhe veprimet e kontabilizimit.

Situata: Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Kukës është miratuar me VKB-në nr. 70, datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 1/63 Prot, datë 06.07.2022. *Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 2.6 bashklidhur projekt raportit të auditimit.*

Referuar aneksit të sipërcituar rezulton se në Bashkinë Kukës të ardhurat paraqiten me tejkalim të planifikimit për periudhën në auditim. Përkatësisht, kemi tejkalim në vlerën 62,454,107 lekë ose janë realizuar në masën 142.6% nga 146,581,425 lekë të planifikuara janë realizuar 209,035,532 lekë. Nga auditimi rezulton se, DAPPLL pavarësisht kërkesave që ka dërguar në drejtoritë brenda Bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2022 nuk ka marrë informacion ose ai ka qenë jo i plotë. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAPPLL për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 70, datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022”. Referuar Pasqyrës më sipër, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mos identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në planifikimin jo të saktë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Kukës, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

Duke krahasuar 2 tabelat plan- fakt me akt- rakordimet me thesarin rezulton se këto tabela nuk rakordojnë për disa zëra si psh:

Tarifa e zënies hapsirës publike: Sipas faktit është realizuar 2,087,903 lekë sipas rakordimit me thesarin rezulton në vlerën 2,337,903 lekë.

Taksa e ndërteses: Sipas faktit është realizuar në vlerën 16,201,032 lekë sipas rakordimit me thesarin rezulton në vlerën 16,377,213 lekë.

Taksa e tokës Bujqësore: Sipas faktit është realizuar në vlerën 2,301 lekë sipas rakordimit me thesarin rezulton në vlerën 4,797 lekë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5. Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, *Struktura përgjegjëse për thesarin është përgjegjëse për konstatimin e tyre në momentin e arkëtimit në llogarinë e thesarit, regjistrimin e tyre në SIFQ, njoftimin e njërive të qeverisjes 29 së përgjithshme, rakordimin dhe raportimin e tyre.* Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për problemet e cituara më sipër në metodologjinë e planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave vendore janë z. Sh.D. me detyrë Drejtor i DAPPLL dhe z. V.G. me detyrë Shef i Sektorit të Taksave.

Kriteri: Ligji nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54/c “Raportimi financiar”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV ” pika 200, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Regullorje e Brendshme nr.101 datë 11.09.2018.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave, si dhe mos rakordimi me degën e thesarit.

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mos njohje e situatës nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 të VKB-së nr., 70, datë 24.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022” dhe është e ndarë në 10 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit.

Sipas Aneksit 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Kukës në klasifikimin sipas rretheve klasifikohet në nivelin e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.3: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Burimi: DAPPLL

Referuar këtij klasifikimi, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nën kategorizime.⁵ Ajo që vihet re në VKB-në për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës është se kategorizimi i tokës bujqësore është miratuar siç e ka klasifikuar ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe nuk janë miratuar nën kategorizime, që nënkupton klasifikimin e tokës bujqësore të njëjste të ndryshme administrative brenda kategorizimit të ligjit. Në Bashkinë Kukës 12 njësi administrative janë klasifikuar në kategorinë e VII-X, që do të thotë vlera e taksës lekë/ha/vit është 700 lekë dhe 2 njësi administrative janë klasifikuar në kategorinë e VI-të, vlera e taksës lekë/ha/vit është 800 lekë. Në vijim paraqitet pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës.

Nga auditimi rezulton se, referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqiten në vlerën 2,370,800 lekë lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga DAPPLL për vitin 2022 është në vlerën 568.328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë. Gjithashtu, rezulton se, Bashkia Kukës ka filluar punën për të saktësuar numrin e familjeve që kanë tokë bujqësore me AMTP si dhe kategoritë që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota për të llogaritur më pas saktësisht planifikimin e të ardhurave nga toka bujqësore.

⁵ Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1.

Tabela nr.4

Nr	Njesia Administrative	Numri I familjeve qe kane toke me AMTP	Siperfaqe ne pronesi te Bashkise (ha)	Toke e Marre me AMTP (ha)	Cmimi sipas paketes Fiskale leke/ha	Detyrime vjetore ne leke 31.12.2022
1	NjA Bushtrice	688	567	212	700	148400
2	NjA Kalis	559	560	148	700	103600
3	NjA Gryk-Caj	452	465	193	700	135100
4	NjA Bicaj	1595	707	358	800	286400
5	NjA Shishtavec	990	1343	573	700	401100
6	NjA Zapod	630	319	196	700	137200
7	NjA Ujmisht	904	634	188	700	131600
8	NjA Topojan	855	527	303	700	212100
9	NjA Terthore	889	695	180	800	144000
10	NjA Malzi	1418	521	310	700	217000
11	NjA Kolsh	339	393	119	700	83300
12	NjA Arren	472	99	122	700	85400
13	NjA Surroj	582	236	133	700	93100
14	NjA Shtiqen	337	540	275	700	192500
15	NjA Kukes		447			
	Shuma	10710	8053	3310		2,370,800

Burimi: DAPPLL

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga DAPPLL vërehet se informacioni i vënë në dispozicion pranë grupit të KLSH-së nuk ka ndryshime nga me informacionin i cili është paraqitur dhe në auditimin e mëparshëm , gjë e cila tregon se nga strukturat e DAPPLL të ardhurat planifikohen pa patur një bazë reale të dhënash lidhur me këtë sektor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. Sh.D. ish Drejtor i DAPPLL dhe z. V.G. me detyrë Shef i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Titulli i gjetjes: Mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore.

Situata: Nga auditimi rezulton se, referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqiten në vlerën 2,370,800 lekë lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga DAPPLL për vitin 2022 është në vlerën 568,328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë. Gjithashtu, rezulton se, Bashkia Kukës ka filluar punën për të saktësuar numrin e familjeve që kanë tokë bujqësore me AMTP si dhe kategoritë që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota për të llogaritur më pas saktësisht planifikimin e të ardhurave nga toka bujqësore. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga DAPPLL vërehet se informacioni i vënë në dispozicion pranë grupit të KLSH-së nuk ka ndryshime nga me informacionin i cili është paraqitur dhe në auditimin e mëparshëm , gjë e cila tregon se nga strukturat e DAPPLL të ardhurat planifikohen pa patur një bazë reale të dhënash lidhur me këtë sektor.

Kriteret: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2. VKB-së nr. 70, datë 24.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022.

Ndikimi: Mos planifikim i saktë i të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, rezulton në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit efektiv midis DAPPLL dhe Drejtorisë së Bujqësisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën **1,802,472 lekë**.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Në Bashkinë Kukës struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, që nga viti 2018 deri në fundin e vitit 2021 në territorin e Bashkisë Kukës janë legalizuar 628 objekte me vlerë totale për t’u paguar 22,609,461 lekë. Në vijimësi kanë paguar detyrimin 142 qytetarë në vlerën **4,577,342** lekë, dhe janë ende debitor ndaj bashkisë 624 qytetarë me vlerë 23,936,441lekë, paraqitur më e detajuar në tabelën nr. 5 të akt konstatimit nr. në vijim.

Tabela nr. 5. Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2018-2022

Viti	Numri total i legalizimeve	Detyrimi Financiar në lekë	Numri i faturave të paguara	Vlera në lekë	Numri i faturave të pa paguara	Vlera në lekë
2018	264	9.017.926	40	1.470.834	224	7.547.092
2019	134	5.126.225	17	609.365	117	4.516.860
2020	46	2.057.147	6	141.898	40	1.915.249
2021	184	6.408.163	50	1.679.542	134	4.728.621
2022	138	5.904.323	29	675.703	109	5.228.620
SHUMA	766	28.513.783	142	4.577.342	624	23.936.441

Burimi: Bashkia Kukës DPKZHT & DAPPLL

Grupi auditimit konstatoi se DPKZHT ka filluar të koordinojë punën me DAPPLL duke dërguar informacion pranë Drejtorisë së të Ardhurave me qëllim që të bëhet regjistrimi i detyrimeve që subjektet/familjet që kanë përfituar legalizimin kanë ndaj bashkisë. DAPPLL ka njoftuar të gjithë debitorët e mbartur ndër vite dhe është në proces të ndjekjes së pagesave të kësaj takse. Me gjithë përpjekjet e bëra deri më tani për të rritur nivelet e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pagesa e kësaj takse nga qytetarët vijon të jetë në vlera shumë të ulta.

Për vitin 2022 janë legalizuar gjithsej 138 objekte për të cilat DPKZHT ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 5,904,323 lekë nga të cilët kanë paguar detyrimin 29 subjekte për vitet para vitit 2022 në vlerën 675,703 lekë. Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2022 nga ASHK nuk është dërguar informacion i plotë në Bashkinë Kukës lidhur me objektet e legalizuara. Bashkia Kukës nga ana e saj ka dërguar në ASHK shkresën nr. 2240 Prot., datë 20.06.2023 ku ka kërkuar që nga ASHK t'i dërgohet lista e objekteve të legalizuara sipas të dhënave të nevojshme konkretisht për periudhën Nëntor 2022 – Qershor 2023. DPKZHT nga ana e saj ka bërë llogaritjen e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë që lind në momentin që objektet legalizohen. *Informacion më i detajuar lidhur me debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë gjendet në Aneksin nr.2, bashkëlidhur Akt- Konstatimit nr. 4 datë 04.09.2023.*

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për sa më sipër janë z. A.SH. me detyrë Drejtor i DPKZHT dhe z. Sh.D. me detyrë Drejtor i DAPPLL.

Titulli i gjetjes: Mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Situata: Në Bashkinë Kukës struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezultoi se, që nga viti 2018 deri në fundin e vitit 2021 në territorin e Bashkisë Kukës janë legalizuar 628 objekte me vlerë totale për t'u paguar 22,609,461 lekë. Në vijimësi kanë paguar detyrimin 142 qytetarë në vlerën **4,577,342** lekë, dhe janë ende debitor ndaj bashkisë 624 qytetarë me vlerë 23,936,441 lekë. Grupi auditimit konstatoi se DPKZHT ka filluar të koordinojë punën me DAPPLL duke dërguar informacion pranë Drejtorisë së të Ardhurave me qëllim që të bëhet regjistrimi i detyrimeve që subjektet/familjet që kanë përfituar legalizimin kanë ndaj bashkisë. DAPPLL ka njoftuar të gjithë debitorët e mbartur ndër vite dhe është në proces të ndjekjes së pagesave të kësaj takse. Me gjithë përpjekjet e bëra deri më tani për të rritur nivelet e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pagesa e kësaj takse nga qytetarët vijon të jetë në vlera shumë të ulta.

Për vitin 2022 janë legalizuar gjithsej 138 objekte për të cilat DPKZHT ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën 5,904,323 lekë nga të cilët kanë paguar detyrimin 29 subjekte për vitet para vitit 2022 në vlerën 675,703 lekë. Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2022 nga ASHK nuk është dërguar informacion i plotë në Bashkinë Kukës lidhur me objektet e legalizuara. Bashkia Kukës nga ana e saj ka dërguar në ASHK shkresën nr. 2240 Prot., datë 20.06.2023 ku ka kërkuar që nga ASHK t'i dërgohet lista e objekteve të legalizuara sipas të dhënave të nevojshme konkretisht për periudhën Nëntor 2022 – Qershor 2023. DPKZHT nga ana e saj ka bërë llogaritjen e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë që lind në momentin që objektet legalizohen. *Informacion më i detajuar lidhur me debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë gjendet në Aneksin nr.2, bashkëlidhur Akt- Konstatimit nr. 4 datë 04.09.2023.*

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5. VKB-së nr. 70, datë 24.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës, nga mos arkëtimi i vlerës prej **23.936.441 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga strukturat e Bashkisë Kukës të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 624 debitorë në vlerën 23,936,441 lekë.

Taksat dhe tarifat për familjarët

Në Bashkinë Kukës familjet ngarkohen për taksat e ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore si dhe për tarifat e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit.

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura lidhur me familjet debitorë, rezulton se në fund të vitit 2021 numri i familjeve debitorë në Bashkinë Kukës është 1943 me vlerë totale detyrimi 10,505,643 lekë. Detyrimin në fund të vitit 2021 i shtohet dhe detyrimi i krijuar për vitin 2022 në vlerën 4,040,222 lekë duke sjellë që vlera e detyrimeve nga taksat dhe tarifat familjare në Bashkinë Kukës më datë 31.12.2022 të arrijë në vlerën 14,545,865 lekë. Nga shqyrtimi i të dhënave dhe materialeve të paraqitura rezulton se Bashkia Kukës - DAPPLL, vetëm llogarit detyrimet e familjeve por nuk i njofton për detyrimet që ato kanë ndaj bashkisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 84, datë 17.07.2014, neni 8, ndryshim i nenit 69. Gjithashtu, Bashkia Kukës nuk bashkëpunon me agjent tatimor për të rritur vjeljen e taksave dhe tarifave vendore familjare si vijon;

Nr.	Njësitë Administrative	Detyrimi 31.12.2021		Detyrimi 31.12.2022	
		Nr. Bizneseve	Detyrimi	Nr.Bizneseve	Detyrimi
1	NjA Bushtricë	1	10,312,470	6	10,672,511
2	NjA Kalis	-	-	1	500,000
3	NjA Gryk-Çaje	-	-	2	32,784
4	NjA Bicaj	3	138,743	5	347,691
5	NjA Shishtavec	1	33,224	2	80,365
6	NjA Zapod	1	1,380,356	2	9,454,385
7	NjA Ujmisht	1	4,147,535	1	4,147,535
8	NjA Topojan	4	60,982	4	39,305
9	NjA Tërthore	5	495,448	14	1,765,520
10	NjA Malzi	4	153,297	6	5,077,254
11	NjA Kolsh	5	14,150,844	8	20,887,002
12	NjA Arren	-	-	2	224,664
13	NjA Surroj	9	11,479,356	8	16,906,134
14	NjA Shtiçen	1	15,726	3	174,455
15	NjA Kukës	451	93,329,340	407	91,513,908
	Totali	486	135,697,321	471	161,823,517

Burimi: Bashkia Kuës DAPPLL

Nr i familjeve debitore

Nr	Detyrimi 31.12.2021		Detyrimi 31.12.2022	
	Nr. familjeve	Detyrimi	Nr. familjeve	Detyrimi
	1943	10,505,643	2247	14,545,865

Burimi: *Bashkia Kukës DAPPLL*

Titulli i gjetjes: Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Kukës dhe masat e marra për uljen e tij.

Situata: Në Bashkinë Kukës familjet ngarkohen për taksat e ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore si dhe për tarifrat e pastrimit-gjelbërimit-ndriçimit.

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura lidhur me familjet debitorë, rezulton se në fund të vitit 2021 numri i familjeve debitorë në Bashkinë Kukës është 1943 me vlerë totale detyrimi 10,505,643 lekë. Detyrimet në fund të vitit 2021 i shtohet dhe detyrimi i krijuar për vitin 2022 në vlerën 4,040,222 lekë duke sjellë që vlera e detyrimeve nga taksat dhe tarifrat familjare në Bashkinë Kukës më datë 31.12.2022 të arrijë në vlerën 14,545,865 lekë. Nga shqyrtimi i të dhënave dhe materialeve të paraqitura rezulton se Bashkia Kukës - DAPPLL, vetëm llogarit detyrimet e familjeve por nuk i njofton për detyrimet që ato kanë ndaj bashkisë, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 84, datë 17.07.2014, neni 8, ndryshim i nenit 69. Gjithashtu, Bashkia Kukës nuk bashkëpunon me agjent tatimor për të rritur vjeljen e taksave dhe tarifave vendore familjare. Vlera totale e borxhit tatimor që menaxhohet nga DAPPLL paraqitet:

Vlera e borxhit tatimor më datë 31.12.2021.

Detyrimet nga taksat dhe tarifrat familjare në shumën 10,505,643 lekë (1943familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifrat e bizneseve në shumën 135,697,321 lekë (486 subjekte);

Borxh i krijuar gjatë vitit 2022

Detyrimet nga taksat dhe tarifrat familjare në shumën 4,040,222 lekë;

Detyrimet nga taksat dhe tarifrat e bizneseve në shumën 26,126,197 lekë (439 subjekte);

Vlera e borxhit tatimor më datë 31.12.2022

Detyrimet nga taksat dhe tarifrat familjare në shumën 14,545,865 lekë (2247 familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifrat e bizneseve në shumën 161,823,517 lekë (471subjekte);

Detyrime nga familjet për pagesat e taksave dhe tarifave vendore më 31.12.2022 është në shumën 14,545,865 lekë për 2247 familje.

Referuar informacionit të paraqitur nga DAPPLL Bashkia Kukës, u konstatua se në fund të vitit 2022 gjendja e debitorëve progresiv vetëm për subjektet fizik/juridik është 161,823,517 lekë për 471 subjekte. DAPPLL me shkresën nr. 187 Prot, datë 24.03.2023 ka dërguar listën e subjekteve debitorë për vitin 2022 pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Masat e marra nga DAPPLL për arkëtimin e detyrimeve

Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Kukës është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:⁶

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DAPPLL lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, DAPPLL ka njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, DAPPLL ka nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar 13 bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesve debitorë.

Si rezultat i këtyre masave të marra nga ana e DAPPLL nga debitorët që rezultojnë në fund të vitit 2021 gjatë vitit 2022 kanë likuiduar detyrimet ndaj Bashkisë **172** subjekte me vlerë **11,161,686 lekë**.

Për debitorët e vitit 2022 Bashkia Kukës gjithashtu, ka filluar marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve 360 njoftime subjekte me vlerë **160,566,663 lekë**. Konstatohet se, pavarësisht masave të marra nga strukturat e Bashkisë Kukës niveli i borxhit tatimor në fund të vitit 2022 ka pësuar një ulje në numër subjektësh debitorë dhe një rritje në vlerën totale të borxhit nga viti 2021 në vitin 2022. *Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.*

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

- **14,545,865 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifatat familjare;

- **26,126,197 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifatat e bizneseve.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarrë për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Grupi i auditimit auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Kukës për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 17 subjekte. Në 13 raste është lidhur akt – marrëveshje ndërmjet Bashkisë Kukës dhe subjekteve, për pagesën me këste për autorizimit të lëndëve djegëse, ku sipas nenit 4 të akt – marrëveshjes vlera totale e akt- marrëveshjes është 1,000,000 lekë e ndarë në këste vjetore për 5 (pesë) vite nga 200,000 lekë në vit pagesë e cila do të bëhet për llogari të Bashkisë Kukës në Bankën e nivelit të dytë. Po t’i referohemi nenit 3 pika 8 e akt- marrëveshjes ku specifikohet se nëse subjekti pas kalimit të afatit 1 vjeçar nuk bën pagesën e këstit, *dhe pasi kanë kaluar 10 ditë nga ky afat i mbyllet aktiviteti*, dhe konsiderohet se ky biznes ushtron aktivitet tregtar pa u pajisur me Autorizim e Lëndëve Djegëse. Nga auditimi rezulton se për 13 rastet janë kryer pagesat sipas aneksit nr 3 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga strukturat e Bashkisë Kukës DAPPLL lidhur me subjektin “Kompleksi D.” ish “P. N.” rezulton se, egziston vetëm një fotokopje e autorizimit, nuk disponohet një dosje të kompletuar lidhur me dokumentacionin përkatës. Autorizim cili është i vlefshëm për 5 vite, dokument i pa shoqëruar me asnjë mandat pagese ku të vërtetojë likuidimin e detyrimit lidhur me këtë autorizimin, pagesë e cila duhet të ishte 1,000,000 lekë për 5 vite. Përsa i përket subjektit “D. 2001” Sh.p.k nuk rezulton të jetë licensuar dhe autorizuar me dokumentet përkatëse, subjekti ka paraqitur kërkesë me nr.13/1 prot., datë 13.10.2020 për rinovimin e licencës së tregëtimit me pakicë, protokollar me nr. 5008 prot., datë 14.10.2020 pranë Drejtorisë të të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave. Nga ana Drejtorisë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, nuk rezulton asnjë dokument i cili të pasqyrojë korespondencën ndërmjet DAPPLL dhe subjektit. Për subjektin V.SH. sh.p.k sipas komunikimit verbal me DAPPLL janë shprehur se subjekti është në proces gjygjësor, dhe subjekti aktualisht është i mbyllur. Për subjektet “V.SH.” dhe “S. P.” ku bëhet fjalë për një pikë të vetme, është mbajtur akt – kontroll me datë 12.07.2022 në zbatim të urdhërit të punës nr. 112 datë 17.02.2021, ku si rezultat i kontrollit në terren rezulton se subjekti nuk ushtron aktivitet, pra është i mbyllur. Përsa i përket subjektit “D.” rezulton se subjekti është aktiv në QKB dhe ushtron aktivitetin e tij pranë territorit të Bashkisë Kukës i pa u pajisur me autorizimet përkatëse. Nga auditimi arrihet në konkluzion se subjekteti “Kompleksi D.” i cili rezulton të jetë pajisur me autorizim por në dosje nuk disponohet dokumenti i pagesës, nga ky subjekt Veprimet janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë

24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”. Neni 20-Autorizimet pika 2. “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje”.

Titulli i gjetjes: Mbi pagesën e autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse.

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga strukturat e Bashkisë Kukës DAPPLL rezulton se, në Bashkinë Kukës janë 4 subjekte (G.P., V.SH., S.P.A., D. 2001 SHPK) që rezultojnë aktiv në QKB dhe operojnë të pa pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20.

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

Ndikimi: Efekt Financiar Negativ për buxhetin e Bashkisë Kukës

Shkaku: Puna jo efektive e DAPPLL në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G.P., V.SH., S.P.A. dhe D. 2001 SHPK dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Punonjësit që ngarkohen me përgjegjësi për problematikat e trajtuara më sipër në pajisjen me autorizim të subjekteve hidrokarbure janë, z. Sh.D. me detyrë ish Drejtor i DAPPLL dhe z. K. E. me detyrë Specialist për dhënien e licencave dhe autorizimeve.

➤ **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave**

Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Kukës u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave. Në Bashkinë Kukës ushtrojnë aktivitet në fushën e minierave 34 subjekte. Nga auditimi i dosjeve dhe i regjistrave të bizneseve debitore që administron DAPPLL, 17 nga 34 subjekte rezultojnë debitorë për pagesën e taksave dhe tarifave

vendore ndaj Bashkisë Kukës, në vlerën **66,304,464 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Kukës dhe e përfshirë te debitorët progresiv.**

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në prodhimin e energjisë (HEC-et)

Në Bashkinë Kukës ushtrojnë aktivitet 20 subjekte në fushën e prodhimit të energjisë. Nga shqyrtimi i dosjeve dhe i regjistrit të debitorëve që administron DAPPLL, 3 nga 20 subjekte janë debitorë për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **10,287,371 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Kukës dhe e përfshirë te debitorët progresiv.**

2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

3.4. Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në zbatim të pikës 3, të programit të auditimit Nr. 524/1, datë 20.06.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

1. Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese të vitit 2022,
2. Procedurat e inventarizimit të aktiveve për 2022,
3. Akt Rakordimet me Degën e Thesarit Kukës për mbylljen e vitit buxhetor 2022,
4. Vendime dhe urdhra të Bashkisë Fier në lidhje me të dhënat e pasqyrave financiare.

“Vlerësim i raportimit Financiar për të parashikuar Opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2022.

Për vitin 2022, Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Kukës me shkresën Nr. 721 prot., datë 27.02.2023, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave. (*Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 1 e Pozicionit Financiar bilanci i v. 2022*)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Kukës” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kukës si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

• **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

➤ ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti nuk është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në programe kompiuterike “Excel”.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, magazinës, të pagave etj si dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Përsa i përket sistemimeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë jo të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhenat te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - Financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2022.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhen e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë rregjistruar, ndërsa detyrimet nuk janë rregjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk janë të paraqitura të plota në bilanc.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumatat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni Financiar është paraqitur në mënyrë të deri diku të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni Financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë, por jo në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022, rakordon me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivitetit dhe të Pasivitetit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivitetit për vitin 2022 është **4,122,226,308 lekë** dhe për vitin 2021 është **4,863,739,646 lekë**, në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 1 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2022

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën **250,479,334 lekë**.

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Kukës kjo llogari është për vlerën **250,479,334 lekë**. Konstatohet se “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”.të paraqitur është e në shumën e “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” në vlerën **279,726,426 lekë** e pasqyruar në formatin nr. 1.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur projektraportit të auditimit.

Titulli i gjetjes: *Mos raportim i saktë në bilanc i llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar”.*

Situata: Referuar aktit të rakordimit me degën e thesarit Kukës llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” paraqitet në vlerën **250,479,334 lekë e cila** nuk rakordon me llogaritë kundërpartit në pasiv të bilancit, respektivisht llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” paraqitem në vlerën

23,392,531 lekë dhe logaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në vlerën 149,444,012 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për diferencën 77,642,791 lekë, ku nga **250,479,334** duhet të jetë 172,836,543 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP” pika 46/a, 49, 50, i ndryshuar.

Kriteri: UMF nr. nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36, i ndryshuar; Ligji nr. 10296 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103.

Ndikimi: Paraqitja jo e saktë në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse të disponibilitetit në thesar, keq informon subjektin mbi gjendjen reali si dhe përdoruesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kukës.

Shkaku: Mosnjohje e legjislacionit të fushës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marri masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” në vlerën 77,642,791 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

-Gjendja e llogarisë **31 “Materiale”** në pasqyrat e pozicionit Financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 6,665,991 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit Financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 9,513,723 lekë.

-Gjendja e llogarisë **32 “Inventar i imët”** në pasqyrat e pozicionit Financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 79,508,247 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit Financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 93,117,218 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit dhe materialeve, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit” në shumën (-16,456,703) lekë.

Titulli i Gjetjes: *Nuk janë marë masat e nevojshme për mirëadministrimin e të gjitha Aktiveve afatgjatë materiale dhe jo materiale. Konkretisht për llogaritë e Aktiveve me vlerat neto sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të vitit 2021.*

Situata:

Referuar kërkesave të dërguara nga grupi i auditimit rezulton se për vitin 2022 Bashkia Kukës nuk ka kryer procesin e inventarizimit cka do të thotë që llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike. Konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për

llogaritë 32- “Inventar i imet”, 202- “Studime dhe kërkime”, 210- “Toka, Troje, Terrene”, 211 – “Pyje, Plantacione” llog 212- “Ndertesa e Konstruksione”, 213- “Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore”, 214 – “Instalime teknike, makineri e paisje”, 215- “Mjete Transporti”. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar, Kreu II, neni 7, pika 2, neni 9, neni 10; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstëve që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitëve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 2, neni 4 ,pika 9 “përgjegjshmëria menaxheriale”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I. si dhe z. S.G.J. kryetar i Bashkisë Kukës.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

-ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III

Impakti

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë të llogarive, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku

Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2022 është në vlerën 507,510,537 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepicën e vitit 2021 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 507,510,537 lekë me 1,611,347 lekë.

Nr.	Llogarite Ekonomike Sipas Modleve			Gjendja me 31/12/2022		Ngarkimi ne SIFQ	
	3/shifrore	4/shifror	7/shifrore	Institucioni	SIFQ	Shtese	Pakesim
	468	4682	4682100	509,121,884	507,510,537	1,611,347	

Burimi: Bashkia Kukës

Nga auditimi i llogarisë analitike rezulton se për vitin 2022 janë evidentuar debitorët për taksat dhe tarifat vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Kukës, ku janë pasqyruar detyrimet për vitin 2022. Ky veprim është kryer në përputhje me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022.

- **Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 119,848,553 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 119,848,553 lekë. Vlera prej 119,848,553 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	66,592,381
42	Detyrime ndaj personelit	26,796,617
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	5,403,554
435	Sigurime Shoqërore	19,200,272
436	Sigurime Shëndetësore	1,601,424
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	254,305
TOTALI		119,848,553

Burimi Bashkia Kukës

Mbi Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale” në vlerën prej **13,032,892 lekë** përbëhen nga:

Llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 13,032,892 lekë.

Nr.	Llogarite Ekonomike Sipas Modleve			Gjendja me 31/12/2022	SIFQ	Ngarkimi ne SIFQ	
	3/shifrore	4/shifror	7/shifrore	Institucioni		Shtese	Pakesi m
	202		2020100	13,032,892	13,032,892		

Burimi: Bashkia Kukës

Diferenca në rritje e llogarisë 202”Studime dhe Kërkime” përfaqëson sistemimin e vitit 2022 për amortizimin e mbartur në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2022 rezulton në vlerën neto 13,032,892 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 “Studime e kërkime” e cila është dhënë në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Viti i Ndërtimit	Vlera fillestare	Vite në Përdorim	Amortizimi	Vlera Mbetur
1	Studime e Kërkime	2013	166,911	9	0	166,911
2	Projekte	2005	1,345,000	17	0	1,345,000
3	Projekte	2012	300,000	10	0	300,000
4	Projekt Rikonstruksion I shkollës Bardhoc	2011	471,573	11	0	471,573
5	Projekte të ndryshme	2012	190,800	10	0	190,800
6	Projekte të ndryshme	2011	186,000	11	0	186,000

7	Projekte	2012	500,000	10	0	500,000
8	Studime projektive	2011	280,000	11	0	280,000
9	Projekte	2012	1,114,541	10	0	1,114,541
10	Studime e Kërkime	2012	1,056,953	10	0	1,056,953
SHUMA			5,611,778			5,611,778

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes 14: *Pasaktësi në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.*

Situata: Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, konstatohet se vlera e studimeve dhe projektiveve i përkasin edhe objekteve të përfunduara, duke siguruar vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 5,611,778 lekë.

Kriteri: Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6,9 dhe 10; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

Ndikimi: Ky konstatim jep një paraqitje jo reale të vlerës financiare të pasqyruar në bilanc duke deformuar informacionin dhe gjendjen financiare të raportuar.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të kryej veprimet e sistemit për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

Mbi Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”, AAM në vlerën neto prej **2,691,262,942** lekë sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022 përbëhet nga:

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 70,974,458 lekë;
- Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 123,645,599 lekë
- Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 1,145,104,029 lekë;
- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujre” në vlerën 1,287,925,877 lekë;
- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 18,495,383 leke;
- Llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 24,209,649 lekë; dhe
- Llogaria 218 “inventar ekonomik” në vlerën 15,495,456 lekë.
- Në vitin paraardhës 2021, vlera totale neto e AAM-ve paraqitet në shumën 2,549,118,075 lekë.

Referuar rakordimit me thesarin shtesat dhe paksimet e AAM-le vlerësuar me koston neto, sipas të dhënave të siguruara nga zyra e Financës paraqiten si në tabelën më poshtë:

Nr.	Llogarite Ekonomike Sipas Modleve			Gjendja me 31/12/2022	Ngarkimi ne SIFQ		
	3/shifrore	4/shifror	7/shifrore	Institucioni	SIFQ	Shtese	Pakesim
	210	2101	2101000	70,974,458	70,974,458		
	211	2111	2111000	123,645,599	113,372,265	10,273,334	
	212	2120	2120101	1,145,104,029	1,071,245,436	73,858,593	
	213	2131	2131000	1,287,925,877	1,246,476,959	41,448,918	
	214	2140	2140320	18,495,383	10,345,739	8,149,644	
	215	2151	2151140	24,209,649	22,708,181	1,501,468	
	218	2181	2181000	15,495,456	8,582,546	6,912,910	

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes: *Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:

Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën neto 70,974,458 lekë e pa ndryshuar gjatë vitit ushtrimor 2022;

Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 123,645,599 lekë me një ritje në vlerë neto 10,273,334 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit 2022;

Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 1,145,104,029 lekë me një ritje në vlerë neto 73,858,593 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit 2022 dhe vlerën e amortizimit.

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujre” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 1,287,925,877 lekë me një ritje në vlerë neto 41,448,918 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese dhe vlerën e amortizimit.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 18,495,383 leke me një ritje në vlerë neto 8,149,644 lekë e cila perfaqson blerjet e kryera gjatë vitit 2022.

Llogaria 215 “Mjete transporti” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 24,209,649 lekë me një ritje në vlerë neto 1,501,468 lekë e cila perfaqson blerjet e kryera gjatë vitit 2022.

Llogaria 218 “inventar ekonomik” më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 15,495,456 lekë me një ritje në vlerë neto 6,912,910 lekë e cila perfaqson blerjet e kryera gjatë vitit 2022.

Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozionit Financiar 2022, është marrë bruto nga pasqyrat financiare dhe sipas shtesave dhe pakësimët e rakorduara me thesarin. Referuar analizës së logarive rezultoi se bashkia Kukës nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2022, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues.

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave

të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2.Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nën-pika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jo materiale".

Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për shtesat nga rivlerësimi:

Do të debitohen llogarit e klasës 2 të aktiveve afatgjata; dhe

Do të kreditohet llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve"

Kriteri: UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nën-pika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Impakti: Mungesa e regjistrimit të AAGJ si dhe mos pasqyrim i saktë i vlerës neto të aktiveve afatgjata materiale nga përlllogaritja e gabuar e amortizimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të AAGJ, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për inventarizimin e disa prej AAGJ e evidentimin e tyre me të gjitha të dhënat në regjistrin e aktiveve si dhe llogaritjen e pasaktë të amortizimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Kukës të marrë masapër kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrimit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

-Llogaria 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara" paraqet vlerën e aktiveve afatgjata të dëmtuara në pronësi të Bashkisë Kukës më datë 31.12.2022 në shumën 5,412,491 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2021 në vlerën 5,412,491 lekë është e njëjtë. Që do të thotë se gjatë vitit 2022 nuk ka patur shtesa apo pakësime në Llogarinë 24 "aktive afatgjata të dëmtuara", deri në ekzekutimin e daljeve fizikisht nga Inventari i Bashkisë Kukës.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	5,412,491
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
Gjendja në 31.12.2022 (D)	5,412,491

Burimi: Bashkia Kukës

- Testi substancial i amortizimit

Qëllimi: Ripërdorimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme” për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërfunduar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet. Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Rrjeshti	Nr. Referencë Llogarive	EMERTIMI	Teprica në fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica në Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/O MATERIALE	13,032,892	0	13,032,892	0	0	0	0	13,032,892	0	13,032,892
2	201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	13,032,892	0	13,032,892					13,032,892	0	13,032,892
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	0	0	0					0	0	0
5	21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	3,649,573,288	1,100,455,213	2,549,118,075	294,917,709	150,473,345	3,832,494	1,532,997	3,940,658,503	1,249,395,561	2,691,262,942
6	210	Toka, troje, Terene	70,974,458	0	70,974,458	0	0	0	0	70,974,458	0	70,974,458
7	211	Pyje, Kullota Plantacione	113,372,265	0	113,372,265	10,273,334				123,645,599	0	123,645,599
8	212	Ndertime e Konstruksione	1,531,017,817	459,772,381	1,071,245,436	141,505,480	67,646,887			1,672,523,297	527,419,268	1,145,104,029
9	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,649,866,477	403,389,518	1,246,476,959	109,234,490	67,785,572			1,759,100,967	471,175,090	1,287,925,877
10	214	Instalime teknike, makineri, pajise, vegla pune	50,661,394	40,315,655	10,345,739	12,853,200	4,703,556			63,514,594	45,019,211	18,495,383
11	215	Mjete transporti	166,733,331	144,025,150	22,708,181	7,553,880	6,052,412			174,287,211	150,077,562	24,209,649
12	216	Rezena shtetore	0	0	0	0	0			0	0	0
13	217	Kalfshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0			0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	61,535,055	52,952,509	8,582,546	11,581,078	4,284,918	1,916,247	1,532,997	71,199,886	55,704,430	15,495,456
15	24	Aktive të Qend. te trupezuara te demtuara	5,412,491	0	5,412,491	1,916,247		1,916,247		5,412,491	0	5,412,491
16	28	Caktime	0	0	0	0	0			0	0	0
17		TOTALI (I + II)	3,662,606,180	1,100,455,213	2,562,150,967	294,917,709	150,473,345	3,832,494	1,532,997	3,953,691,395	1,249,395,561	2,704,295,834

Burimi: Bashkia Kukës

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare,

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 202 me vlerën 887,353,000 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, siç shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
59	25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	15,000,000	887,353,000
60	25	Huadhënie e Nënhuadhënie	0	0
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet	15,000,000	887,353,000

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli gjetjes: Mbi llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare”

Situata: Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në çelje të vitit ushtrimor Bashkia Kukës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 12,5% të aksioneve të Klubit të Futbollit Kukës si dhe 100% të Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.A me NUIS përkatëse L.....F dhe J.....S. Gjat vitit 2022 është pakësuar vlera aksionare 872,353,000 lekë, që Bashkia Kukës zotëron në Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh.A. pakësimi i kësaj llogari është bërë në kundërshtim me urdhrin e ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investitorit në përputhje me paragrafët 37-42 të SNK 27 e cila thotë:

Kur përgatiten pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht dhe në sipërmarrjet që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten ose:

(a) me kosto, ose

(b) në përputhje me SNK 39.

Pasi referuar “Ekstraktit historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjekteve Shoqëri Aksionare” rezulton se më datë 13.04.2023 Bashkia Kukës është 100% aksionere e Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh.A me NUIS J.....S.

Kriteri: Urdhrin e ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje” pika 35.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit Financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2022, të llog 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e veta”, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 872,353,000 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjellës Kanalizime Kukës SHA me vlerë kontabël 872,353,000 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet, deri në transferimin përfundimtar të aksioneve dhe marrjes në dorzim të tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

Mbi Investimet

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2022, paraqiten në vlerën 391,495,678 lekë. Ky vlerësim Financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jo materiale sipas tabelës më poshtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 391,495,678 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jo materiale	39,654,832
2	Aktive Afatgjata materiale	351,840,846
3	Totali	391,495,678

Burimi: Bashkia Kukës

Për investimet e kryera gjatë vitit 2022, është debituar saktë llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata".

II. Rubrika, pasivet afat shkurtër.

- **Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kukës më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në fund të vitit 2022 është në vlerën 66,592,381 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Kukës më 31.12.2022, përbëhet nga fatura të pa likuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Kukës, paraqitet në vlerën 26,796,617 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t’u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

- **Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 5,403,554 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për periudhat e kaluara si dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2022 të cilat do të paguhen në periudhën pasardhëse.

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2022 si dhe detyrimet e viteve të kaluara përkatësisht në vlerat 19,200,272 lekë dhe 1,601,424 lekë.

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kukës, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 23,392,531 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Lëvizja e Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2022	15,423,224
Shtesa	26,462,738
Pakësime	21,647,492
Gjendja në 31.12.2021	

Burimi: Bashkia Kukës

Titulli i gjetjes 18: *Mbivlerësim i llogarisë 466 Kreditorë për mjete nën ruajtje.*

Situata: Vlera e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk është e njëjtë me terpicën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 10,607,978 lekë pjesa tjetër prej 4,815,246 lekë është në afat.

Kriteri: ligjin nr. 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10” ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit Financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, gjendje kjo e mbi vlerësuar për 1,169,275 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, urdhrin nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kuatridri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen

e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale **10,607,978 lekë** dhe të kryeje sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, të 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, -të 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, të 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, të 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, nuk është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 8,524,875 lekë për vitin 2022. E analizuar për vitin 2022 për vlerën **36,978,285 lekë përbëhet** dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2022
1	Paga Personeli llogaria 42	6,153,280
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	201,001
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,170,594
4	Furnitorë llogaria.401-408	28,453,410
	TOTALI	36,978,285

Rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara pasive**, pra në vitin 2022 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

Gjendja e llogarisë 42 “**Detyrime ndaj personelit**” në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 6,153,280 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2022.

-Gjendja e llogarisë 431 “**Detyrime ndaj shtetit tatim taksa**” në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 201,001 lekë detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2022.

-Gjendja e llogarisë 435 “**Sigurime shoqërore**” në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 2,170,594 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe sigurimet shëndetsore për muajin dhjetor 2022.

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Situata: Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 15,423,224 lekë, ndërsa më 31.12.2022 paraqitet në vlerën **23,392,531 lekë**. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e Financës nuk ka bërë përditësimin e listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “*Kreditor për mjete në ruajtje*” Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshur, Kap. III, pikat 30, 50.*

Pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)", UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 50.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit Financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2022 të llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".

Shkaku: Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

1. Pasqyra e Performancës financiare (F2)

-Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Kukës më datë 31.12.2022 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Kukës, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	1,721,195,321	1,721,195,321	0
II	Shpenzime	1,571,751,309	1,571,751,309	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	149,444,012	149,444,012	0

Burimi: Bashkia Kukës

Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 "shpenzimet" dhe klasës 7 "të ardhurat", janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", konkretisht:

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **149,444,012 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4):

Reference	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Teprioc/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Teprioc/Deficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
b	c	1	3	4	5	6
101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	2,914,284,951	-5,774,880	-1,720,396	272,851,170	3,179,640,845
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(I+2)	287,992,454	-84,264,995	194,402,268	-123,407,158	274,722,569
	1.NGA BURIME TE BRENDSHME	268,257,819	-166,031,643	194,402,268	-123,407,158	173,221,286
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	180,946,300	138,483,430.00		-95,543,495	223,886,235
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	6,375,262	31,694,009.00			38,069,271
1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0	6,525,125			6,525,125
12	Nga Rezultatet e mbarura(+,-)	130,198,878	-192,681,872	142,935,930		80,452,936
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	141,215,534		-141,215,534	149,444,012	149,444,012
111	Nga Rezervat (+,-)	0				0
115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	83,953,633		192,681,872	-177,307,675	99,327,830
15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)	0				0
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	-266,702,144	-150,473,345			-417,175,489
1015	Nga nxjerrjet jashtepedorimit dhe demtimet(-)	-7,729,644	421,010			-7,308,634
107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne perdorim(+,-)	0				0
109	Diferenca nga Rivleresimi I AAGJ(+,-)	0				0
	2.NGA BURIME TE JASHTME	19,734,635	81,766,648	0	0	101,501,283
106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	19,734,635	81,766,648			101,501,283
1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0				0
	TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	3,202,277,405	-90,039,875	192,681,872	149,444,012	3,454,363,414

Burimi: Bashkia Kukës

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **3,454,363,414 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi;

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Bashkisë Kukës, NA, z.S.G.J.; dhe Drejtori i Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. M.I..

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet përkatëse të KB.

Në zbatim të drejtitimit 4, të programit të auditimit nr. 524/1 Prot, datë 20.06.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- 1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- 2) Dosjet e procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.
- 3) Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara dhe marrja në dorëzim sipas rastit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Kukës, në disa raste nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëveçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për FI.ncat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Kukës, në disa rast nuk është bërë e mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, i ndryshuar.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Kukës (*regjistrat e parashikimit dhe realizimit*), për periudhën 01.01.2021–31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara të cilat paraqiten (*bashkëlidhur projektraportit në aneksin nr. 1 dhe aneksin nr. 2, pika 4, “Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021-31.12.2022”*).

Në lidhje me këtë pikë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se;

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021-31.12.2022, Bashkia Kukës ka realizuar **130** procedura prokurimi (tender) me vlerë të fondit limit në shumën **719,486,368** lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **694,181,226** lekë nga të cilat:

Për vitin 2021 janë realizuar 16 procedura tenderimi, me fond limit në shumën **334.344.781** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **331.444.302** lekë pa TVSH ose 99% e fondit limit.

Gjithashtu për të njëjtën periudhë objekt auditimi, ka realizuar 46 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **17.915.100** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **15.646.311** lekë.

Për vitin 2022 janë realizuar 25 procedura tenderimi, me fond limit në shumën **342.829.328** lekë dhe Kombëtar vlerë kontrate të lidhur në shumën **336.954.547** lekë pa TVSH ose 98.29% e fondit limit.

Gjithashtu për të njëjtën periudhë objekt auditimi, ka realizuar 43 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **24,397,159** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **31,790,205** lekë.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Me shkresën nr. 421prot., datë 19.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë z. S.GJ., është autorizuar zj. M. O., me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues për procedurat e prokurimit etj.

Me shkresën nr. 764prot., datë 10.12.2021 të Kryetarit të Bashkisë z. S.GJ., është autorizuar z. G.GJ. me detyrë zv/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues për procedurat e prokurimit etj.

Me urdhrin nr. 60prot., datë 20.01.2021, të titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, z. S.GJ., në cilësinë e kryetarit të Bashkisë, ka caktuar personin përgjegjës për prokurimet për vitin 2021 me përbërje z. H.M. dhe z. E.T. (jurist).

Me urdhrin nr. 279 prot., datë 02.06.2021, të titullarit të AK, të titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, zj. M. O., në cilësinë e personit autorizues janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet e konkretisht zj. I.P. dhe zj. M.D.

Me urdhrin nr. 25 prot., datë 19.01.2022, të titullarit të AK, të titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, z. G.GJ., në cilësinë e personit autorizues janë caktuar personat përgjegjës për prokurimet e konkretisht zj. M.D. dhe zj. I.P..

Më poshtë trajtohen disa nga procedurat e prokurimit të audituara në Bashkia Kukës, e konkretisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Optimizimi i furnizimit me uje te qytetit Kukës, Bashkia Kukës – Faza III” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Optimizimi i furnizimit me uje te qytetit Kukës, Bashkia Kukës – Faza III”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur” REF- REF-86506-02-09-2021 Urdhri nr. 89 prot., datë 08.02.2021	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr 89 prot., datë 08.02.2021 1.A.SH. 2.E.T. 3.H.M. 4.E.P. 5.Sh.G.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr 89 prot., datë 08.02.2021, titullari Granit z. G.GJ. 1.A.SH. 2.E.T. 3.H.M. 4.E.P. 5.Sh.G.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 88 prot., datë 08.02.2021. 1.V.H. 2.K.T. 3.E.S.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 254.991.757 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (C. ShPK) 254.726.814 lekë pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 264.943 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 18.03.2021	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1.BOE “B. C.” ShPK & “S.” &”B.’ ShPK, 2.C. ShPK 3.K.M.K ShPK b) S’kualifikuar X 1 BOE “B. C.” ShPK & “S.” &”B.’ ShPK X B/OE, 2. K.M.K ShPK
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 14 muaj Amendim kontrate:deri me 05.07.2023			

		c) Kualifikuar: C. ShPK
10. Ankimime AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 55 prot., datë 26.04.2021 Nr.5224prot., datë 01.09.2022	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “*Optimizimi i furnizimit me uje te qytetit Kukës, Bashkia Kukës – Faza III*”, me fond limit në shumën 254.991.757 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 254.726.814 lekë, kanë marrë pjesë 1. BOE “B. C.” ShPK & “S.” & “B.” ShPK, 2. C. ShPK. 3. K.M.K ShPK, nga të cilët C. ShPK. janë kualifikuar dhe BOE “B. C.” ShPK & “S.” & “B.” ShPK, 2. K.M.K ShPK janë s’kualifikuar, ku është shpallur fitues OE “C. ShPK” me vlerë oferte në shumën 254.726.814 lekë konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 89 datë 08.02.2021 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.A.SH.(Arkitekt), 2.E.T. (Jurist), 3.H.M.(Jurist) 4.E.P.(Arkitekthe), 5.Sh.G.(Jurist).

Sipas procesverbalit të datës 09.02.2021, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit është bërë duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, analizat teknike të çmimeve të përfshira në manual, është marrë në konsideratë analiza cilësore dhe sasiore e rrishtit në menyrë që të përcaktohen ato element negativë të cilët mund të ndikojn në mos realizimin e punimeve gjatë zbatimit të projektit, cila rezulton të jetë **254, 991, 756** lekë pa TVSh.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr nr. 89 datë 08.02.2021 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.A.SH. (Arkitektur), 2.E.T.(Jurist), 3.H.M.(Jurist), 4.E.P. (Arkitekthe)5.Sh.G. (Jurist) Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 01, datë 09.02.02021 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.A.SH. (Arkitekt), 2.E.T.(Jurist), 3.H.M.(Jurist), 4.E.P. (Arkitekthe), 5.Sh.G. (Jurist), janë evidentuar në procesverbalin e datës 09.02.2021, ku disa prej tyre nuk janë të argumentuara (cilësuar më gjerësisht në akonstatimin e mbajtur për këtë procedurë dhe gjatë Raportit Përfundimtar të Auditimit) të cilat janë si më poshtë;

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

3. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

4.2. Një punësim mesatar i të paktën 180 (njqind e tetetehjete) punonjesve per periudhen Gusht 2020 - Janar 2021, te vërtetuar me;

- Kjo te deshmohet me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (**Formulari E-SIG 02/a**) dhe te shoqerohet me **Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore** formularet **E-SIG 025/a**.

4.3. Operatoret Ekonomik duhet te kete si pjese te stafit te tij te punes si drejtues teknik, per periudhen e kerkuar sa me siper:

- Inxhinier Ndërtim i 1 (nje), Inxhinier Hidroteknik 1 (nje), Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder 1 (një), Inxhinier Elektrik 1 (një), Inxhinier Mjedisi 1 (nje), Inxhinier Mekanik 1 (nje), Inxhinier Gjeolog /Hidrogeolog 1 (nje),

a). Per stafin inxhinierik, duhet detyrimisht per periudhen e mesiperme te jene te pasqyruar ne liste-pagesat e operatoreve ekonomik. OE duhet te paraqese kontrate noteriale pune (*me kohe te plote*) me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt, CV, si dhe diplomat profesionale te tyre.

b) Perveçese stafit te mesiperm per te realizuar punimet e parashikuara ne projekt OE duhet te kete te punesuar nje staf mbeshtetes si me poshte vijon:

- Inxhinier Ndërtim i (profili Strukturist) 4 (kater), Inxhinier Ndërtim i (profili Transport) 1 (nje), Inxhinier Ndërtim i (profili Gjeoteknik) 1 (nje), Inxhinier Ndërtim i (master Menaxhim Projektesh) 1 (nje), Inxhinier Gjeoburimesh/Gjeoinxhinieri 1 (nje), Inxhinier Mjedisi (profili Energjitike) 1 (nje),

- c). Operatori Ekonomik duhet qe te percaktoje me ane te nje Deklarate, (*nga administratori i shoqerise*) Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt si dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithe kohes qe do te realizohen punimet ne objekt, te shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- Kontrate pune e vlefshme;

- Diplome profesionale;

4.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 50 punonjës të çertifikuar me deshmi te sigurimit teknik, te lëshuar nga DPA ose Trupa çertifikuese ekuivalente, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv. Brenda kesaj liste duhet te deshmoje, dhe te figurojne ne liste-pagesat e shoqerise per 12 muajt e fundit, pozicionet e meposhtme:

a. **1 (nje) Hidraulik** te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Çertifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b. **4 (kater) Specialistë për montim/saldim tubash (HDPE)**, shoqëruar me çertifikatat dhe dëshmitë përkatëse;

c. **1 (nje) Specialist** për testimin e tubove nën presion (HDPE);

d. **1 (nje) Elektriçist**, te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Çertifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit profesional te lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e. **3 (tre) Teknik Ndërtimi**, te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë /dëshmi /diploma përkatëse të kualifikimit profesional te lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f. **9 (nente) Manovratorë të mjeteve të rënda**, te vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme;

g. **5 (pese) shoferë**, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme;

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, i cili të jetë i argumentuar në përputhje me volumet dhe grafikun e punimeve.

4.5. Operatori Ekonomik duhet te kete ne përbërje te stafit, në përputhje te plote me kerkesat e percaktuara ne VKM Nr.632, date 15.07.2015, i ndryshuar si dhe VKM Nr.108, date 09.02.2011, i ndryshuar, 1 (nje) Mjek.

- Per kete pozicion pune Operatori Ekonomik duhet te paraqese, kontrate pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te leshuar nga Urdheri i Mjekut.

4.6. Operatori ekonomik te kete Liçense per Mbrojtjen nga Zjarri te leshuar nga QKL.Kodi 1.2.A.

- Operatori ekonomik duhet të ketë si pjesë të stafit të punësuar **1(një) Ekspert zjarrëfikës**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të pajisur me Liçensë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, i cili të jetë i argumentuar në përputhje me volumet dhe grafikun e punimeve.

4.7. Operatori ekonomik, duhet te kete Liçençe per Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis (Auditim mjedisor ndikim ne mjedis) Kodi III.2.A (1+2).

- Operatorie konomik ofertues duhet të ketë si pjesë të stafit të punësuar, ose të kontraktuar të paktën **1(një)Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme) dhe të pajisur me Çertifikatën përkatëse.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, i cili të jetë i argumentuar në përputhje me volumet dhe grafikun e punimeve, për më tepër që për këtë procedurë është bërë një raport për ndikimin mjedis nga ekspert i pavarur.

4.8. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçençe profesionale, te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Kod III.2.B, per Grumbullim dhe Transport te mbetjeve jo te rrezikshme.

4.9. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- **1 (një) punonjes** te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë akredituara ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.*

- **1 (një) punonjës** të pajisur me certificate si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me kerkesat e ligjit Nr.10 327, date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". *Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.*

- **1 (një) punonjes** si "Përgjegjës për dëmet në mjedis", gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me kerkest e percaktuara ne ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar). *Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.*

Në lidhje me numrin total të kapacitetit teknik, për punonjësit rezulton se, kriteri i vendosur përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmjet OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 100 punonjës duke filluar nga Drejtues Teknik dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër prej mesatarisht 180 punonjës për Gusht 2020 - Janar 2021 që i është kërkuar pjesëmarrësve ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre çka sjell për pasojë mundësinë e OE favorizues për lidhjen e kontratës në fjalë.

5. Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën ISO 39001 – 2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurise ne trafikun rrugor)
- ISO/ICE 27001:2013 (Per menaxhimin e Sigurise se Informacionit)

- ISO 39001: 2012 (Çertifikate per sistemin menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor)
- ISO 50001:2018 (Çertifikate Per Sistemin e Menaxhimit te Energjise)

Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

7. Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik (**shtojca 10**).

a) Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete/makineri dhe pajisje pune të përshkruara në Projektraportin e auditimit:

Ky kriter përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së mjeteve dhe makinerive të kërkuara, rezulton se janë kërkuar mjete të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasat e objektit të kontratës si psh, Gurrëthyes, frontojë 1 copë, Rimorkiator 2 copë, Koke terheqese 2 copë, ndërkohë që natyra dhe përmasa e objektit janë më të vogla krahasuar me preventivin e punimeve. Gjithashtu janë kërkuar mjete e makineri të cilat nuk janë në përputhje me preventivin e punimeve pasi nuk ka asnjë zë që lidhet me nevojën e përdorimit të tyre si psh; makineri vijëzimi, çekiç për thyerje inertesh, autovinç me kosh, saldatrice ndërkohë që ka kërkuar aparat saldimi për ngjitje tubash etj. Këto kërkesa ndikojnë në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 88 datë 08.02.2021, të titullarit të AK, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, I.V.H. (Agronomi e Larte), 2.K.T. (Inxhinier Hidroteknik), 3.E.S.(Inxhinier Hidroteknik). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 01.të datës 18.03.2021 KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	C. ShPK	254,726,814	Kualifikuar
2	1.BOE “B. C.” ShPK & “S.” &”B.” ShPK,	244,774,993	S’kualifikuar; Nga verifikimi i bere OE nuk ploteson kushtet e vendosura ne DST: 1. 4.3.b – Operatori ekonomik nuk disponon kapacitetin e mjaftueshem te burimeve njerezore per realizimin e kontrates. 2. 4.4.b - Nuk ploteson kushtin per specialistet montim/saldim 3. 4.4.c – Nuk ploteson kushtin per specialistin e tubave nen presion. 4. 4.4.e - Nuk ploteson nr per teknik Ndërtim i. 5. 4.4.f - Nuk ka te gjithe manovratoret e mjeteve te renda (nga 9 manovrator ka vetem 3 te tille) 6. 4.7 -Nuk dipsonon licence per mbrojtjen nga zjarri 7. 4.9 - Nuk ka ekspekt per ndihmen e pare per nderhyje ne emergjenca.

			8. 4.9- <i>Nuk disponon pergjegjes per demet ne mjedis.</i> 9. 6. - <i>Nuk ploteson kerkesat e pikes 6-te</i> 10. 7. - <i>Nuk disponon numerin e kerkuar te makinerive.</i>
3	K.M.K	_____	a). <i>Subjekti ekonomik nuk ka dorezuar asnje dokument te vlefshem persa i perket procedures se prokurimit me objekt:., Optimizimi i furnizimit me uje te qytetit Kukës, Faza e III-te“</i>

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 12.04.2021, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, si dhe ngaverifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 12.04.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “C. ShPK”, për të cilën është lidhur kontrata datë 26.04.2021 për vlerën 254,726,814 pa TVSH dhe vlera 305.762.177 lekë me TVSH, dhe me afat 14 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në lidhje me këtë procedurë rezulton se: me shkresën nr. 8875 prot., datë 21.06.2023, të Prokurorisë së Posaçme dhe Krimin të Organizuar, është kërkuar marrja e dokumentacionit të kësaj dosjeje, në kuadër të hetimeve që lidhen me procedimin penal nr. 279 viti 2020. Me shkresën nr. 2263/1 prot., Bashkia Kukës i ka dërguar dokumentacionin e kërkuar Institucionit të Prokurorisë.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, diskriminuese dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Optimizimi i furnizimit me uje te qytetit Kukës, Bashkia Kukës – Faza III*”, Nga Bashkia Kukës, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret të cilat kanë ulur konkurrencën përmes vendosjes së kriterëve. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre konkretisht: liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen dhe duke sjellë një mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi në cilësinë e titullarit të AK z. S.GJ. e z. G.GJ., ndërsa z. A.SH., z. E.T., z. H.M., zj. E.P., e z. Sh.G. në cilësinë e anëtarëve të NjP për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike.*

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 ku citohet se;

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 2, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

neni 12, Përgjegjësia e autoritetit kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 61, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

.Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Rikualifikim i shkolles se mesme te Bashkuar, Havzi Nela” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim i shkollës së mesme të Bashkuar, Havzi Nela”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Tender i hapur” REF-44841-10-07-2022 Urdhri nr.759 prot., datë 07.10.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri Nr.757 prot date 06.10.2022 1.G.M. 2.S.G. 3.B.Gj.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr.759, date 07.10.2022 1.M.D. 2.G.E. 3.D.B. 4.E.M. 5.H.M.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.786 prot., datë 10.10.2022. 1.A.SH. 2.K.T. 3.Z.J.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 106,555,570 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: C. shpk, 106,042,609 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 512,961 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 07.11.2022	8. Burimi FI.ncimit Te ardhurat / Buxheti i Shtetit		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 4 OE 1.BOE “2 N” shpk & I. shpk 2.A. C. shpk 3.C. shpk 4.Shoqeria S. shpk
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga data e dorezimit te sheshit te Ndërtim it			
10.Ankimime AK-s’ka APP– REKOMANDIME KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.139 prot., datë 25.11.2022		12.Përgjigje

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikualifikim i shkollës së mesme të Bashkuar Havzi Nela, Kukes”, me fond limit në shumën 106,555,570 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 106,042,609 lekë (Pa Tvsh), kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomike, nga të cilët, operatori ekonomik C. shpk është kualifikuar dhe operatorët ekonomik A. C. shpk, Shoqeria S. shpk, BOE “2 N” shpk & I. shpk janë s’kualifikuar. Është shpallur fitues OE/BOE “C. shpk” me vlerë oferte në shumën 106,042,609 lekë (Pa Tvsh) konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr.757 datë 06.10.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.G.M.(Inxhinier Ndërtim shfrytezim miniera), 2. S.G.(Inxhinier Ndërtim i), 3.B.Gj. (Inxhinieri pyjesh)

Sipas procesverbalit të datës 06.10.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit, është bazuar në cmimet e manualit teknik të cmimeve të Ndërtimit, analizave teknike të cmimeve të perfshira në manual si dhe analizat teknike për zerat që nuk perfshihen në manual, e cila rezulton të jetë 106.505.570 lekë pa tvsh.

-Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike janë realizuar nga ana e të njëjtit komision, të percaktuar nga ana e titullarit të AK me urdherin Nr. 757 Prot.,dt. 06.10.2022.

z.G.M. dhe z.S.G., janë specialist të fushës. Nga ky komision është mbajtur procesverbali Nr.5825 Prot., dt.06.10.2022“Për argumentimin dhe dokumentimin e vlerësimit të fondit limit dhe

per hartimin e specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit me objekt:Rikualifikim i shkolles mesme te bashkuar H.Nela.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej

1.M.D. – jurist

2.D.B. – inxhinier Ndërtim i

3.G.E.- jurist

4.E.M.-inxhinier gjeoinformatike

5.H.M. - jurist janë evidentuar në procesverbalin e datës 12.10.2022, ku disa prej tyre nuk janë të argumentuara (cilësuar gjatë Raportit Përfundimtar të Auditimit) të cilat janë si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3.1 Një punësim mesatar i të paktën 90 (nentedhjetë) punonjësve per tre muajt e fundit (korrik-gusht-shtator 2022), te vërtetuar me;

▪ Vërtetim të lëshuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** per pagim detyrimesh dhe per kontributet e **Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a** ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (korrik-gusht-shtator te vitit 2022)

▪ Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën (korrik-gusht-shtator te vitit 2022)

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar ne stafin e shoqerise se tij nje inxhinier auditues energjie i pajisur me certificate per auditimin e energjise. Per inxhinierin audites energjie duhet te kete keto dokumenta provues:

- Kontrata e punes e vlefshme te pakten gjate periudhes se parashikuara te Ndërtim in
- certificate (diplome per efencen e energjise dhe deshmi e kualifikimit te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente)

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te

*fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin **Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, i cili të jetë i argumentuar në përputhje me objektin e kontratës dhe grafikun e punimeve.***

3. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga ana e Administratorit të shoqërisë Drejtuesin teknik të punimeve në kantier ose Përgjegjës të teknik të kantierit i cili duhet të jetë me kohë të plotë në kantier dhe jo i angazhuar në kontrata të tjera i cili duhet të jetë diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Operatorët ekonomik duhet të kenë pjesë të tij, stafin ndihmes si me poshtë:

- Teknik Ndërtim i 4 (kater), Manovrator 8 (tete), Hidraulik 5(pese), Elektricitist 5 (pese), Hidroizolues 5 (pese), Hekurthyes 4 (kater), suvatues 10 (dhjete), murator 4 (kater), Mekanik 3 (tre), Bojaxhi 5 (pese), Karpentier 1 (nje), pllakashtrues 4 (kater), saldator 2(dy), të vërtetuar me: diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”,kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libreze pune dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën korrik-gusht-shtator 2022.
- Punonjes ne lartesi (te pakten njeri nga muratoret, suvatuesit, bojaxhiu dhe teknik Ndërtim i duhet te jete i pajisur me certificate te punimeve ne lartesi).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

*Duke qene se makinerite dhe pajisjet te cilat duhet te disponoje operatori ekonomik per ekzekutimin e kontrates kerkohen te jene te jene ne pronesi ose me qera , rrjedhimisht ne rastin kur makinerite disponohen me qera, vendosim qe **manovratorët** te mos disponohen ne listepagesat e shoqerise ofertuese, pasi ata mund te kontraktohen nga shoqeri te tjera.*

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- Një inxhinier i pajisur me Certifikatë trajnimi për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë ” i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

3.Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën ISO 9001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
- Çertifikatën ISO 14001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
- Çertifikatën ISO 45001 – 2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit e sigurisë në punë).
- Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Këto kërkesa për çertifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjrisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerite (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronesi të tij ose me qera të vertetuara këto me dokumentacionin perkates:

a). Në funksion të zbatimit të kontratës, kërkohej të jenë në dispozicion këto mjete/makineri dhe pajisje pune të përshkruara në Projektraportin e auditimit.

Kriteri për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.

Pika 3 e DST BEHET:

Operatorët ekonomik duhet të kenë pjese të tij, stafin ndihmes si me poshte:

- Inxhinier Ndërtim i 1(nje), Teknik Ndërtim i 2(dy), Manovrator 2(dy), Shofer 5(pese), Hidraulik 4(kater), Elektracist 4 (kater), Hidroizolues 4 (kater), Hekurthyes 3(tre), Suvatues 6 (Gjashte), Murator 3 (tre), Mekanik 3 (tre), Bojaxhi 4 (kater), Karpentier 1 (nje), pllakashtrues 4(kater), saldator 2(dy).

Në lidhje me numrin total të kapacitetit teknik, për punonjësit rezultojnë se, kriteri i vendosur përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 53 punonjës duke filluar nga Drejtues Teknik dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër prej mesatarisht 90 punonjës për korrik-gusht-shtator 2022 që i është kërkuar pjesëmarrësve ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 786 datë 10.10.2022 të titullarit të AK, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.A.SH. (Arkitekt), 2. Z.J. (Ekonomist), 3.K.T. (inxhinier). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 02, të datës 14.11.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	BOE “2. & I.” SHPK	87,914,197	SKUALIFIKUAR Operatori Ekonomik I. megjithëse në shtojcën 8, ka deklaruar se Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e

		<p>parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. Operatori Ekonomik I. ka cituar në shtojcën 8 vetëm Autoritetin ose organin lëshues: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Lloji i dokumentacionit: Vertetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, Vertetim për pagim Detyrimesh, por nuk ka as të shënuar në shtojcën 8 numrin e protokollit dhe datën e vërtetimit dhe as dokument të skanuar dhe ngarkuar në sistem, nisur nga kjo por edhe sipas Kontratës së bashkëpunimit nr. 761 prot. Datë 04.11.2022 Për bashkimin e operatorëve ekonomikë 2. dhe I. ky BOE nuk plotëson kriterin e përgjithshëm të përzgjedhjes.</p> <p>Operatori Ekonomik 2. në shtojcën 8, ka deklaruar se kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, nga ana tjetër po në shtojcën 8, OE 2. deklaroi se ka 60 Punonjës për periudhën Korrik - Shtator, gjithashtu deklaroi se disponon personelin kryesor, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse. Kështu në dokumentin e ngarkuar nga Operatori Ekonomik 2. në sistem DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" për muajin Korrik 2022 figurojnë 58 persona të siguruar për muajin Gusht 2022 figurojnë 63 persona të siguruar dhe për muajin Shtator 2022 figurojnë 63 persona të siguruar. Gjithashtu Operatori Ekonomik I. megjithëse në shtojcën 8, ka deklaruar se kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, në shtojcën 8, Operatori Ekonomik I. deklaroi se ka 65 Punonjës për periudhën Korrik – Gusht dhe nuk e deklaroi fare muajin Shtator, si dhe i mungon krejtësisht dokumenti DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" dhe Vërtetim (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a). Në këto kushte meqenëse për periudhën Korrik-Shtator për Operatorin Ekonomik 2. në dokumentin DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi", figurojnë përkatësisht 58 persona të siguruar për muajin Korrik 2022, për muajin Gusht 2022 figurojnë 63 persona të siguruar, po kështu për muajin Shtator 2022 figurojnë 63 persona të siguruar, në këto kushte por dhe sipas Kontratës së bashkëpunimit nr.761 prot. Datë 04.11.2022 Për bashkimin e operatorëve ekonomikë 2. dhe I., ku në nenin 3 faqe 4, paragrafi i parafundit, BOE shprehet se Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje, ky BOE nuk plotëson kriterin e veçantë 2.3.1 të DST-së (ndryshuar me shtojcën e datë 25.10.2022), Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetëdhjetë) punonjësve për tre muajt e fundit(korrik-gusht-shtator 2022), të vërtetuar dhe përbën kusht për skualifikim.</p> <p>Operatori Ekonomik 2. ka deklaruar në dokumenta se: Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 87.914.197 [Tetëdhjetë e shtate milion e nentëqind e katermbëdhjetë mijë e njëqind e nentëdhjetë e shtate];</p> <p>Operatori Ekonomik 2. ka deklaruar në dokumenta se: Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 102.511.956 [Njëqind e dy milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtë];</p> <p>Autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës, ka publikuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve (nëpërmjet APP-së) me datë 25.10.2022, Shtojcë për ndryshimin e kërkesave të procedurës Rikualifikim i Shkollës së Mesme të Bashkuar Havzi Nela, Kukës me Nr. REF-44841-10-07-2022, por këto ndryshime nuk janë reflektuar në kriteret e publikuara në llogaritë e përdoruesve të sistemit si anëtar të KVO-së, dhe pas konfirmimit nga ana e Administratorit të Sistemit të Autoritetit/Entit Kontraktor, KVO-ja vlerësimin do ta bëjë sipas ndryshimit të kërkesave të procedurës në shtojcën e sipërpërmendur.</p>
--	--	--

2	A. C.	122.338.316	<p>Operatori ekonomik A. C. ka deklaruar në dokumenta se: Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 122,338,316.25 leke [Njeqind e njëzet e dy milion e treqind e tridhjetë e tete mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë pikë njëzet e pese] Leke.</p> <p>Operatori ekonomik A. C. ka deklaruar në dokumenta se: Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 146,603,479.50 leke [Njeqind e dyzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë] Leke</p> <p>Kjo ofertë është në kundërshtim me Njoftimin e kontratës dhe DST-së sepse çmimi i ofertës është më i madh se fondi limit që është 106,555,570.00 Lekë, për pasojë oferta nuk kualifikohet.</p>
3	S. SHPK	105.455.595	<p>Operatori ekonomik S. nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të DST-së, ku formulari i Sigurimit të Ofertës duhet të jetë Letër me kokë e Bankës apo e Kompanisë së Sigurimeve, duhet të përmbajë angazhimin që marrin përsipër të transferojnë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar dhe në fund ky dokument duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit, pikërisht mosrespektimi i këtij kriteri përbën kusht për skualifikim.</p> <p>Operatori ekonomik S. ka deklaruar në dokumenta se: Çmimi total i Ofertës sonë, pa TVSH, është: 105,455,595 leke [Njeqind e pese milion e katerqind e pesëdhjetë e pese mijë e peseqind e nentëdhjetë e pese] leke</p> <p>Operatori ekonomik S. ka deklaruar në dokumenta se: Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 127,356,714 leke [njeqind e njezet e shtate milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e katermbëdhjetë] leke.</p>
4.	C. shpk	106.042.609	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 16.11.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 3 OE, është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 16.11.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “C.” shpk për të cilën është lidhur kontrata datë 25.11.2022 për vlerën 106,042,609 lekë pa TVSH dhe vlera 127,064,830 lekë me TVSH, dhe me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj, nga momenti i dorëzimit të sheshit të Ndërtimit.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Rikualifikim i shkolles se mesme te Bashkuar, Havzi Nela*” Nga Bashkia Kukës, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezultoi se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret të cilat kanë ulur konkurrencën përmes vendosjes së kriterëve. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre konkretisht: licencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen dhe duke sjellë një mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e

specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi në cilësinë e titullarit të AK z. S.GJ. e z. G.GJ., ndërsa. Z. G.M., z. S.G., z. B.Gj., zj. M.D., zj. G.E., zj. D.B., zj. E.M. e z. H.M. në cilësinë e anëtarëve të NjP për hartimin e kriterëve dhe njësisë së hartimit të specifikimeve teknike.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, nenin 3, parimet e përgjithshme, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburanti” me të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF-90446-03-18-2021 Urdhri nr.150 prot.,datë 11.03.2021	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 49, datë 18.01.2021 1.B.Sh. 2.S.H. 3.M.A. 4.D.Sh. 5.K.E.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 150, datë 11.03.2021 1.E.T. 2.H.M. 3.B. N.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 151 prot., datë 11.03.2021 1.V.H. 2.Xh.S. 3.M.A.
4. Fondi Limit Lek (pa tvsh) 21.000.000 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (K. shpk) 15.4% Marzhi i Fitimit lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 0 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit/Ofertave Data 14.04.2021	8. Burimi FI.ncimit Buxheti i shtetit.		9. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, OE-K. shpk OE-U.C. shpk b) S’kualifikuar- Nuk ka c) Kualifikuar OE-K. shpk,OE-U.C. shpk
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Nga data e nënshkrimit të kontratës deri në furnizimin e plote të sasise se prokuruar.			
10. Ankimime AK-Nuk Ka APP-Nuk Ka KPP-Nuk Ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 66 prot., datë 26.05.2021		12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburanti”, me fond limit në shumën 21.000.000(njzet e nje milion) lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate në shumën 25.200.000 lekë me Tvsh kanë marrë pjesë 2(dy) OE, nga të cilët 2(dy) jane kualifikuar(referohu me lart) ku OE-“K.” shpk është shpallur fitues me vlerë oferte në shumën 15.4% Marzhi i Fitimit lekë pa tvsh. lekë konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 49 datë 18.01.2021 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.B.Sh., 2.S.H. 3.M.A.,4.D.Sh.,5.K.E..

Sipas procesverbalit të datës 02.02.2021, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën sipas normatives se harxhimit të karburantit në baze të Urdhrit Nr.218 prot date 03.02.2020.Gjithashtu janë marrë në konsideratë“Vlera doganore,taksa doganore,akzia,taksa e karbonit,Tvsh-ne,si dhe kursi i kembimit”, si dhe faktoreve të cilët influencojnë në percaktimin e çmimit gjatë vitit si dhe sasise se nevojshme vjetore të mallit.Pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit (jane marre ne konsiderate“Vlera doganore,taksa doganore,akzia,taksa e karbonit,Tvsh-ne,si dhe kursi i kembimit”, si dhe faktoreve të cilët influencojnë në percaktimin e çmimit gjatë vitit si dhe sasise se nevojshme vjetore të mallit.) e cila rezulton të jetë 21.000.000 lek pa tvsh.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 49 datë 18.01.2021 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.B.Sh. (Inxhinier Topograf), 2.S.H. (Inxhinier Pyjesh) 3.M.A. (Oficer), 4.D.Sh. (Jurist), 5.K.E.. (Inxhinier Mekanik.) Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 478, datë 02.02.2021 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriteve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1. E.T.(Jurist anetar i njesise prokurimit), 2.H.M., (Jurist, anetar i njesise prokurimit) 3. B. N. (Inxhinier Pyjesh,anetar i njesise prokurimit), janë evidentuar në procesverbalin e datës 18.03.2021, të cilat janë në përgjithësi sipas kuadrit ligjor për prokurimin publik.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 151 datë 11.03.2021, të titullarit të AK, nr.151 prot., datë 11.03.2021, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.V.H. (Agronomi e larte), 2.Xh.S. (Marrëdhënie Ndërkombëtare), 3.M.A. (Oficer), emrat dhe profilet e personave të caktuar, kush është specialist i fushës. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2(dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 02, të datës 29.04.2021, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	K. shpk	15.4 % Marzhi i fitimit	Kualifikuar
2.	U.C. shpk	9.997% Marzhi i fitimit	Kualifikuar(kërkesë për terheqje nga realizimi i procedurës date 30.04.2021, protokolluar me tonen Nr.1695 dt.04.05.2021)

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 07.05.2021në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2(dy) operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar (nuk ka të skualifikuar sipas KVO) OE, janë kualifikuar 2(dy) OE. Rezulton se OE “U.V. ShPK”, ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga oferta pasi nuk ka të mundur aksesin e kartave të furnizimit. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 07.05.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “K. shpk” për të cilën është lidhur kontrata datë 26.05.2021 për vlerën

21.000.000 lekë pa TVSH dhe vlera 25.200.000 lekë me TVSH, dhe me afat nga date e nenshkrimit te saj deri ne furnizimin e plote te sasise se prokuruar.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Karburanti” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedur e Hapur” REF-21139-03-2022 Urdhri nr. 214 prot., datë 25.02.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 172 datë 15.02.2022 1.K.E. 2.B.T. 3.Z.D. 4.F.S. 5.D.M.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 214, datë 25.02.2022 1.M.D. 2.I.P. 3.G.d H.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 213 prot., datë 25.02.2022. 1.L.K. 2.H.A. 3.E.N.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 21,000,000 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (K.) 21,000,000 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit XXX,XXX lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 29.03.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender OE, K. U.C. b) S’kualifikuar OE U.C., c) Kualifikuar OE K.
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Nga data e nenshkrimit te Kontrates deri ne furnizimin e plote te sasise se prokuruar.			
10.Ankimime AK- ka APP-s’ka; KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 69 prot., datë 03.06.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Karburanti”, me fond limit në shumën 21,000,000 lekë pa tvsh, dhe vlerë kontrate në shumën 21,000,000 lekë pa tvsh, kanë marrë pjesë OE K. dhe U.C., nga të cilët janë kualifikuar OE K. janë s’kualifikuar U.C., ku është shpallur fitues OE “K.” me vlerë oferte në shumën 21,000,000 lekë pa tvsh konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 172 datë 15.02.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.K.E.(Inxhinier Mekanik) 2.B.T.(Mesues Matematike) 3.Z.D. (Administrim Biznesi) 4.F.S. (Juriste) 5.D.M. (Teknologji Agroushqimore) Sipas procesverbalit të datës 25.02.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga OE të ndryshëm duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 21,000,000 lekë pa tvsh.(Gjithashtu percaktimet e normave te Harxhimit te Karburantit per Automjetet dhe Makinerite ne pronesi te Bashkise Kukes .

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 172 datë 15.02.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.K.E. (Inxhinier Mekanik) 2.B.T. (Mesues Matematike) 3.Z.D. (Administrim Biznesi) 4.F.S.(Juriste) 5.D.M. (Teknologji

Agroushqimore). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 1017 Prot datë 25.02.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim me përjashtim të kriterit të licencave të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht e ligjërisht për çfarë i janë kërkuar OE për ti paraqitur e konkretisht si më poshtë:

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.M.D.(Juriste) 2.I.P. (Juriste)3.G.H.(Inxhinier) (emrat e komisionit dhe profilet e fushës së secilit anëtar), janë evidentuar në procesverbalin e datës 03.03.2022, nga të cilat disa kritere nuk janë të argumentuara, konkretisht janë si më poshtë;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% (840,000) të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a)Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

3.Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Per kete arsye ofertuesit duhet qe te paraqesin:

▪ Vertetim laboratorik te cilesise leshuar nga Inspektoriati Shteteror i Kontrollit te Naftes dhe N/Produkteve te saj.

4.Subjekti kontraktues duhet qe te kete pike te licensuar furnizimi ne qytetin e Kukesit.

5. Shoqeria fituese duhet qe te siguroje furnizimin me *Karta Elektronike te Personalizuar*, cilat mundesojne identifikimin e targes se makinave dhe perdoruesin e saj.

6. Ofertuesi duhet te paraqese nje *Deklarate* me ane te ciles duhet te deklarroje se merr persiper furnizimin 24 ore ne çdo dite te javes, deri ne perfundim te Kontrates.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme:

Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë).

Certifikatën e cilësisë ISO 14001:2015 (Standart për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit).

(Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë).

Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr 213 datë 25.02.2022 të titullarit të AK, nr.213prot., datë 25.02.2022, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.L.K.(Ekonomist); 2.H.A.(F. Farmaci);3.E.N.(Ekonomist).emrat dhe profilet e personave të caktuar, kush është specialist i

fushës. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2, të datës 06.04.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	K.	21,000,000	Kualifikuar
2	U.C.	X	S'kualifikuar; (Operatori Ekonomik nuk ploteson asnjë nga kriteret e DST-se pasi ka ngarkuar ne sistem elektronik vetem ekstraktin historik)

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 02.06.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga K. dhe U.C. operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar OE U.C., janë kualifikuar OE K.. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 02.06.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “K.” për të cilën është lidhur kontrata datë 03.06.2022 për vlerën 21,000,000 lekë pa TVSH dhe vlera 25,200,000 lekë me TVSH, dhe me afat Nga data e nenshkrimit te Kontrates deri ne furnizimin e plote te sasise se prokuruar .

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (nëse ka patur ankimime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se është paraqitur një ankesë nga OE U.C., duke kundërshtuar Kriteret e DST-se si dhe perlllogaritjen e fondit Limit.Kjo Kerkes ka marre pergjigje me dt.23.03.2022,nepermjet sistemit elektronik duke u nisur ne adrese te operatorit ekonomik. Titullari i AK, përkatësisht për secilin ankim, ka Ngritur Urdhrin Nr.345/1,dt.15.04.2022 me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe caktimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës të përbërë nga 1.K. A.;2.E. E.;3.V.T.. **Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës** i ngritur për këtë qëllim me Vendimin Nr.03 date 18.04.2022 ka vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “U.C.”shpk.

KOMISIONI I PROKURIMEVE PUBLIKE (KPP).

Me Vendim Nr.502 /2022 Vendosi:

1.Te perfundoj procedimin administrativ per proceduren e prokurimit “E Hapur” me nr. REF-21139-03-03-2022 parashikuar per tu zhvilluar me dt.29.03.2022 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia kukes.

2.Autoritete Kontraktor Lejohet te vijoje me hapat e metejshme te procedures se prokurimit. Pas përfundimit të fazës së Shqyrtimit të Ankesës dhe dërgimit të vendimit Nr.502/2022 me shkrese Nr.761/8 Prot Dt. 27.04.2022 të Komisionit të Prokurimeve Publike (KPP) u hartua dhe u ngarkua në sistemin elektronik të prokurimeve, Formulari i njoftimit përfundimtar të fituesit, Nr.368/1 Prot., dt. 02.06.2022. Ky vendim shpreh qartë se nuk qëndron ankesa e OE për pretendimet e paraqitura.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Karburanti” për vitin 2011 dhe vitin 2022 Nga Bashkia Kukës, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar

kritere dhe specifikime teknike të cilat nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre konkretisht për specifikimet e vendosura në të dy procedurat, pra të vitit 2021 dhe vitit 2022 si dhe certifikatat e kërkuara për procedurën e vitit 2022. Referuar LPP vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Për hartimin e specifikimeve teknike për procedurat e të dy viteve rezulton se nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi në cilësinë e titullarit të AK z. S.GJ. e z. G.GJ., ndërsa z. B.Sh., z.S.H., z.M.A., z.D.Sh., z.K.E. për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së vitit 2021, z.K.E., z.B.T., zj.Z.D., zj.F.S., z.D.M. për hartimin e specifikimeve teknike dhe zj.M.D., zj.I.P., z.G.d H. për hartimin e kritereve të kualifikimit të procedurës së vitit 2022.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, nenin 3, parimet e përgjithshme, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kritereve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim i i Rrugës Qender Shtiqën-Aeroport” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i Rrugës Qender Shtiqën-Aeroport”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e Hapur” REF-30992-05-27-2022 Urdhri Prokurimit.Nr.429 prot.,datë 23.05.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.376,datë 06.05.2022 1.G.d M.j 2.E.G. 3.I.M.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 429, datë 23.05.2022 1.H.M. 2.G.E. 3.E.P.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 430 prot., datë 23.05.2022(i ndryshuar) 1.A.SH. 2.T.B. 3.R.G.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 48,864,000 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (M. sh.p.k) 47,490,229.50 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 1,373,770.50 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 21.06.2022	8. Burimi FI.ncimit Te ardhura		9. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1.D. sh.p.k, 2.M. sh.p.k, 3.T. sh.p.k , 4.B.sh.p.k, 5.S. V. sh.p.k, 6.A.K. b) S’kualifikuar T. sh.p.k, 2.B. sh.p.k, 3.S. V., 4.A.K.,
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj nga data e dorezimit te sheshit			

		c) Kualifikuar 1.M. sh.p.k, 2.D. sh.p.k
10.Ankimime AK-s'ka/ka; ka APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 85 prot., datë 18.07.2022	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i i Rrugës Qender Shtiqën -Aeropot””, me fond limit në shumën **48,864,000** lekë,pa Tvsh dhe vlerë kontrate në shumën **47,490,229.50** Leke pa Tvsh Oferta fituese) si dhe **56,988,275.4** Lek me Tvsh kanë marrë pjesë 6 OE, nga të cilët 2 janë kualifikuar dhe 4 janë s’kualifikuar, ku është shpallur fitues OE/BOE “**M. sh.p.k**” me vlerë oferte në shumën **47,490,229.50** lekë konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 376 datë 06.05.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.G.M.(inxhinier Gjeodet/Gjeolog) 2.E.G. (ekonomiste) 3.I.M. (ixhinier topograf).

Sipas procesverbalit të datës 23.05.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit kane përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit ,analizat teknike të çmimve ,të përfshira në manual,në bazë të përlllogaritjeve të çmimeve për çdo zë të veçantë duke marrë për baze te dhenat e projektimit , llogaritjet sasiore të matshme,volumet e punimeve”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, vlera limit e kontrates se perlllogaritur rezulton të jetë **48,864,000** lekë pa tvsh.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 376 datë 06.05.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.G.M.(Inxhinier Gjeodet/gjeolog) 2.E.G. (Ekonomiste) 3.I.M. (Inxhinieri Hidro -Teknik). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 547/1, datë 23.05.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.H.M. (Jurist), 2. G.E. (Juriste),3.E.P. (Arkitekte), janë evidentuar në procesverbalin e datës 27.05.2022 të cilat janë si më poshtë;

(Evidento kriteret e veçanta sipas procesverbalit dhe DST-ve)vijon.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a. Operoret ekonomik pjesemarres ne kete prokurim duhet qe te plotesojne kapacitet ligjore, teknike dhe profesionale per kryerjen e ketij prokurimi.

b. Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen shoqerise, sipas formatit te miratuar me VKM Nr.943 date 28.12.2016 (i ndryshuar).

c. Licensa profesionale e Operoreve Ekonomik e lidhur me ekzekutimin e punes te kontrates objekt prokurimi, duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
1.	NP - 1	A	Punime germimi ne toke
2.	NP - 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
3.	NP-5	A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
4.	NP-12	A	Punime te inxhinierise se mjedisit
5.	NS-7	A	Sinjalistika rrugore jondriçuese
6.	NS-18	A	Punime topogjeodezike

Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë (i ndryshuar).

c. Vërtetim te leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore te parashikuara per vitin **2022**. Per plotesimin e kriterit te mesiperme te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit). Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

2. Një punësim mesatar i të paktën 20 (njetzet) punonjësve per tre muajt e fundit (shkurt-mars-prill 2022) , te vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** per pagim detyrimesh dhe per kontributet e **Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a** ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen (shkurt-mars-prill 2022)

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën (shkurt-mars-prill 2022)

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”,

“b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

3. Operatoret Ekonomik duhet te kete pjese te stafit te tij te punes si drejtues teknik, per periudhen e kerkuar sa me siper:

- Inxhinier Ndërtim i 1 (nje)

Per inxhinierin pjese e stafit, duhet detyrimisht te jete te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per periudhen e mesiperme, duhet te paraqitet

- kontrate pune e noterizuar, e vlefshme pergjate periudhes se zbatimit te kontrates
- cv
- diplome profesionale
- Liçence profesionale per zbatimin e kontrates.

Operatoret ekonomik duhet te kene pjese te tij, stafin ndihmes si me poshte:

- Teknik Ndërtim i 1 (nje)
- Manovrator 3 (tre)
- Punetor asfalti 2 (dy)

të vërtetuar me: diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”,kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libreze pune dhe të figurojne në listëpagesa për periudhen shkurt-mars-prill 2022.

4.Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën ISO 9001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
- **Çertifikatën ISO 14001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).**
- Çertifikatën ISO 45001 – 2018 (Sistemi i menaxhimit të shendetit e sigurise ne pune).
- Çertifikatën ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurise rrugore dhe trafikut).

Këto kërkesa për çertifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. (trajtuara gjerësisht nëprojektraportin e auditimit)

5.Operatori ekonomik duhet te paraqese automjetet dhe makinerite (sipas tabelës) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qera te vertetuara keto me dokumentacionin perkates:

a).Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete/makineri dhe pajisje pune të përshkruara në Projektraportin e auditimit:

Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.

Ofertuesi duhet të paraqesë mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit, si më poshtë:

1. Kokore, minimumi 20 copë.
2. Komplet i ndihmës së shpëjtë, minimumi 2 copë

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit te

fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në lidhje me numrin total të kapacitetit teknik, për punonjësit rezulton se, kriteri i vendosur përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 8 punonjës duke filluar nga Drejtues Teknik dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër prej mesatarisht 20 punonjës për shkurt-mars-prill 2022 që i është kërkuar pjesëmarrësve ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 39 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike,projekti i zbatimit, preventivi, grafiku i punimeve jane hartuar nga Projektuesi/it.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

d. Operoret ekonomik pjesemarres ne kete prokurim duhet qe te plotesojne kapacitet ligjore, teknike dhe profesionale per kryerjen e ketij prokurimi.

e. Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen shoqerise, sipas formatit te miratuar me VKM Nr.943 date 28.12.2016(i ndryshuar).

f. Licensa profesionale e Operoreve Ekonomik e lidhur me ekzekutimin e punes te kontrates objekt prokurimi, duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
1.	NP - 1	A	Punimegermimi ne toke
2.	NP – 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pistaeroportuale.
3.	NP-5	A	Ujësjiellës, kanalizime, veprakullimi e vaditje.
4.	NP-12	A	Punimeteinxhinierise se mjedisit
5.	NS-7	A	Sinjalistikarrugorejondriçuese
6.	NS-18	A	Punimetopogjeodezike

Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 430 datë 23.05.2022,(i ndryshuar) të titullarit të AK, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”,i përbërë prej, 1.A.SH. (Arkitekt) 2.T.B. (Mesme/Ndërtim Profesionale) 3.R.G. (Inxhinier Gjeodet/Gjeoplog). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 02, të datës 01.07.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	M. sh.p.k	47,490,229.50	Kualifikuar

2	D. sh.p.k	48,734,731.50	Kualifikuar
2	T. sh.p.k	48.091.498.35	S'kualifikuar; a.OE nuk permbush pikat 6.1 , 6.2 dhe 6.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit konkretisht fabriken e asfaltit ose disponimin e nje kontrate furnizimi.
3	B.sh.p.k	39.372.984	OE nuk permbush kriterin per pune te ngjashme pasi puna qe eshte realizuar me shoqerine "T. E. 2" sh.p.k nuk ka dokument nga autoriteti kontraktor qe verteton se "B."sh.p.k ka miratim si nenkontraktor. Kontrata e paraqitur ne SPE, e realizuar me FSHZH nuk eshte e shoqeruar me Formularin e vleresimit per realizimin e kontrates.
4	S. V. sh.p.k	40.189.190	a.Oe nuk ka deklaruar ne shtojcen 8 se disponon depoziten e ujit me kapacitet jo me te vogel se 10.000 liter si dhe nuk ka paraqitur asnje dokument provues se disponon kete kapacitet. Oe nuk ka paraqitur aktin e ekspertit te vulosur per bilancin e 2019. Bilanci 2020 nuk vertetohet se eshte vulosur nga organet tatimore. Sipas vertetimit Nr.T063663795 rezulton se OE ka detyrime ne Kontribute Sigurimesh ne Shumen 620.293 Leke
5	A.K. shpk	0	a.OE ka paraqitur vetem vertetim xhiro per tre vitet e fundit vertetim statusi aktiv dhe ekstrakt te thjeshte.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 04.07.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, si dhe ngaverifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga 6 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 4 OE, janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 04.07.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "M. sh.p.k" për të cilën është lidhur kontrata datë Datë 18.07.2022 për vlerën 47,490,229 lekë pa TVSH dhe vlera 56,988,275 lekë me Tvsh, dhe me afat 4 muaj nga data e dorezimit të sheshit Ndërtim it.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtim i i Rrugës Qender Shtiqën -Aeropot" Nga Bashkia Kukës, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriteret të cilat kanë ulur konkurrencën përmes vendosjes së kriterëve. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre konkretisht: liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen dhe duke sjellë një mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se

si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi në cilësinë e titullarit të AK z. S.G.J. e z. G.G.J., ndërsa. Z. G.M., zj. E.G., z. I.M., z. H.M., zj. G.E., zj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të NjP për hartimin e kriterëve dhe njësish të hartimit të specifikimeve teknike.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, nenin 3, parimet e përgjithshme, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim i i rrugës Kolsh, gjatesi 1543 ml” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i i rrugës Kolsh, gjatesi 1543 ml”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Tender i hapur” REF-31037-05-27-2022 Urdhri nr.404 prot., datë 16.05.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri Nr.381, date 10.05.2022, 1.A.SH. 2.D.B. 3.H.D.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr.404 datë 16.05.2022 1.M.D. 2.G.E. 3.E.P.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.405 prot., datë 16.05.2022. 1.V.T. 2.M.G. 3.Z.J. Ndryshuar me urdherin Nr.527 Prot., dt.15.06.2022 (zevendësohet z. M.G. me z.G.M.)
4. Fondi Limit (pa tvsh) 30,303,000 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues:(M. shpk) 29,877,625 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 425,375 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 15.06.2022	8. Burimi Financimit Te ardhurat		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 2 OE 1.M. SHPK 2.S.M.O U. SHPK b) S’kualifikuar S. U. SHPK c) Kualifikuar: M. SHPK
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj nga data e dorezimit te sheshit te Ndërtim it			
10.Ankimime AK-s’ka APP– s ka KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.81 prot., datë 30.06.2022		12.Përgjigje

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i i rrugës Kosh me gjatesi 1543 ml”, me fond limit në shumën 30,303,000 lekë, dhe vlerë kontrate

në shumën 29,877,625 lekë (Pa Tvsh), kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomike (M. shpk dhe S.M.O U. shpk), nga të cilët, operatori ekonomik M. shpk është kualifikuar dhe operatori ekonomik S. unision SHPK është s'kualifikuar, ku është shpallur fitues OE/BOE "M. shpk" me vlerë oferte në shumën 29,877,625 lekë (Pa Tvsh) konstatohet se:

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit";

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr.381 datë 10.05.2022 është ngritur grupi i punës "Përlllogaritjen e fondit limit", i përbërë nga 1.A.SH.(Arkitektur), 2. D.B.(Inxhinieri Ndërtim i), 3.H.D.(Ekonomiste).

Sipas procesverbalit të datës 14.05.2022, të mbajtur për efekt të pasqyimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit, është bazuar në cmimet e manualit teknik të cmimeve të Ndërtim it, analizave teknike të cmimeve të perfshira në manual si dhe analizat teknike për zerat që nuk perfshihen në manual, e cila rezulton të jetë 30,303,000 lekë pa tvsh.

-Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike janë realizuar nga ana e të njëjtit komision, të percaktuar nga ana e titullarit të AK me urdherin Nr. 381 Prot.,dt. 10.05.2022 z.A.SH. dhe znj. D.B. janë specialist të fushës. Nga ky komision është mbajtur procesverbali Nr.2556/1 Prot., dt.14.05.2022 "Për argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit dhe për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt:Ndërtim i rrugës Kolsh".

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej

- 1.M.D. – Juriste
- 2.E.P. – Arkitekture
- 3.G.E. -Juriste

janë evidentuar në procesverbalin e datës 27.05.2022, të cilat janë si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

g. Operatoret ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim duhet që të plotësojnë kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

h. Operatoret ekonomike duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën shoqërisë, sipas formatit të miratuar me VKM.

i.Licënca profesionale e Operatoreve Ekonomik e lidhur me ekzekutimin e punës të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
1.	NP - 1	A	Punime germimi në tokë
2.	NP – 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
3.	NP-7	A	Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
4.	NS-6	A	Sinjalistika rrugore jondriçuese
5.	NS-18	A	Punime topogjeodezike

Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjrisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

Pika 2.3/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.pika 2.3/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2. Një punësim mesatar i të paktën 20 (njetete) punonjësve për tre muajt e fundit (shkurt-mars-prill 2022), të vërtetuar me;

▪ Vërtetim të lëshuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** për pagim detyrimesh dhe për kontributet e **Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a** ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (shkurt-mars-prill 2022)

▪ Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën (shkurt-mars-prill 2022)

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikes 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

3. Operatorët Ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij të punës si drejtues teknik, për periudhën e kërkuar sa më sipër:

• Inxhinier Ndërtim i 1 (nje)

Për inxhinierin pjesë e stafit, duhet detyrimisht të jetë të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për periudhën e mesiperme, duhet të paraqitet:

• kontrate pune e noterizuar, e vlefshme për gjatë periudhës së zbatimit të kontratës

• cv

• diplome profesionale

• licence profesionale

Operatorët ekonomik duhet të kenë pjesë të tij, stafin ndihmes si më poshtë:

• Teknik Ndërtim i 1 (nje)

• Mekanik 1 (nje)

• **Manovrator 3 (tre)**

• Punëtor asfalti 2 (dy)

të vërtetuar me: diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme, deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libere pune dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën shkurt-mars-prill 2022

*Duke qenë se makinerite dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë operatori ekonomik për ekzekutimin e kontratës kerkohen të jenë të jenë në pronësi ose me qera, rrjedhimisht në rastin kur makinerite disponohen me qera, vendosim që **manovratorët** të mos disponohen në listepagesat e shoqërisë ofertuese, pasi ata mund të kontraktohen nga shoqëri të tjera.*

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikes 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqërore

te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehsuara me origjinalin.

Në lidhje me numrin total të kapacitetit teknik, për punonjësit rezulton se, kriteri i vendosur përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 8 punonjës duke filluar nga Drejtues Teknik dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër prej mesatarisht 20 punonjës për shkurt-mars-prill 2022 që i është kërkuar pjesëmarrësve ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

4. Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën ISO 9001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
- Çertifikatën ISO 14001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
- Çertifikatën ISO 45001 – 2018 (Sistemi i menaxhimit të shendetit e sigurise ne pune).
- Çertifikatën ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurise rrugore dhe trafikut).

Këto kërkesa për çertifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet te paraqese automjetet dhe makinerite (sipas tabelës) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qera te vertetuara keto me dokumentacionin perkates:

a). Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete/makineri dhe pajisje pune të përshkruara në Projektraportin e auditimit:

Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për cfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës. Këto kërkesa të pa argumentuara mund të ndikojnë në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 405 datë 16.05.2022 të titullarit të AK, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.Z.J. (Financier), 2. M.G. (Inxhinier e burimeve minerare), 3.V.T. (shëf sektori ne Drejtorine e rrugeve). Me urdherin Nr. 527, date 15.06.2022, u be ndyshimi i KVO, per paraqiti kerkeae per zevendesim. z.M.G. u zevendesua z.G.M., (Inxhinieri minerare)

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 02, të datës 17.06.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	M. SHPK	29,877,625	Kualifikuar
2	S. U. SHPK	21,473,492	S'kualifikuar; Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur kopje të rregullt të bilancit për vitin 2020 të paraqitur pranë Administratës Tatimore, sepse nuk është bërë konfirmimi i rregullt për çdo fletë nga ky autoritet, pasi në asnjë fletë nuk dallohet qartësisht vula e Administratës Tatimore. (Konsiderohet kusht për skualifikim) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara për vitin 2022, si dhe nuk ka paraqitur të dhëna për shlyerjen e taksave vendore të

		<p>parashikuara për vitin 2022 në deklaratën e bërë sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). (Konsiderohet kusht për skualifikim)</p> <p>Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur çertifikata të sakta të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, pasi sa i takon çertifikatës ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut), afati i mbarimit të çertifikatës është përpara afatit të përfundimit punimeve, sepse kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës është 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, ndërsa data e mbarimit të çertifikatës ISO 39001:2012 është data 27.06.2022, vetëm 11 ditë kalendarike pas zhvillimit të tenderit. (Konsiderohet kusht për skualifikim)</p> <p>Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për pagim detyrimesh dhe për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Shkurt, Mars, Prill 2022, ndërsa në shtojcën nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit) është shprehur: “Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentat e tenderit, dhe e vërtetoj këtë më dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor”. (Konsiderohet kusht për skualifikim)</p> <p>Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt, Mars, Prill 2022, ndërsa në shtojcën nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit) është shprehur: “Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentat e tenderit, dhe e vërtetoj këtë më dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor”. (Konsiderohet kusht për skualifikim)</p>
--	--	--

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 29.06.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga 2 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 1 OE, është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 29.06.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “M. shpk” për të cilën është lidhur kontrata datë 30.06.2022 për vlerën 29,877,625 lekë pa TVSH dhe vlera 35,853,150 lekë me TVSH, dhe me afat 4 (kater) muaj, nga momenti i dorëzimit të sheshit të Ndërtimit.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i i rrugës Kolsh, gjatesi 1543 ml” Nga Bashkia Kukës, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezultoi se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, kanë hartuar dhe miratuar kriterë të cilat kanë ulur konkurrencën përmes vendosjes së kriterëve. Vendosja e të gjitha kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre konkretisht: liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. Këto kriterë nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen dhe duke sjellë një mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifitimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifitimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi në cilësinë e titullarit të AK z. S.GJ. e z. G.GJ., ndërsa. Z. A.SH., zj. D.B., zj. H.D., zj. M.D., zj. G.E., zj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të NjP për hartimin e kriterëve dhe njësish të hartimit të specifitimeve teknike.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, nenin 3, parimet e përgjithshme, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifitimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

(Shënim: Nga procedurat e prokurimit të realizuara, u morën për shqyrtim/auditim me zgjedhje procedurat e mësipërme)

Në lidhje me zbatimin e kontratës;

4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

1. Për objektin **“Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”**, gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Kukës dhe OE “C.” ShPK me Nr.55Prot. datë 26.04.2021.*
- *Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin Situacioni nr.3;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 3;*

2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Kukës dhe OE “GJ. & CO” ShPK me Nr. 82 Prot. datë 02.07.2021.*

- *Korrespondencat mes Bashkisë Kukës dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “GJ. & CO” ShPK.*

Kontratat

Punimet kryhen sipas kontratës për punë publike me Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 me objekt “Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, të përfaqësuar nga Titullari z. S.GJ. dhe të Operatorit Ekonomik “C.” ShPK me përfaqësues z. F.C. me licenca profesionale NZ 0005/25. Vlera e kontratës është 305,672,177 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 14 muaj nga momenti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Sipas kërkesës së kontraktorit Nr.108 Prot. datë 01.09.2022 afati i përfundimit të punimeve është zgjatur është ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.5224Prot. datë 01.09.2022 duke përcaktuar si datë për përfundimin e tyre 05.07.2023. Kjo zgjatje e afatit të përfundimit të punimeve ka ardhur si rezultat se Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer në kokë likuidimin e situacioneve pjesore të përfunduara, mosdorëzimi i sheshit të ndërtimit për objektet e parashikuara që do të ndërtohen në fshatin Lomje, problematikat e dala gjatë integritimit me projektin e mëparshëm si dhe prekja e stafit me virusin Covid 19.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit NR.82 Prot, datë 02.07.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “GJ. & CO” ShPK, me përfaqësues H. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1735/19, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 3,509,727.96 lekë me TVSH.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga BOE “D.-E” ShPK dhe “A. C.KS” ShPK sipas kontratës Nr.68 Prot. datë 10.09.2020 me afat 30 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Në këtë projekt janë parashikuar të ndërtohen; vendosja e matësve në pallate me kolonë të brendshme (qyteti Kukës), rikonstruksion i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, ndërtim linje kryesore shpërndarëse përgjatë rrugës P. dhe rikonstruksioni i nyejve ekzistuese, ndërtim kaptazhi (burimi nr.3) Lomje, ndërtim linje nga kaptazhi i burimit nr.3 deri tek linja ekzistuese, ndërtim puse shuarje Lomje, ndërtim depo 30 m3 dhe ndërtim linje furnizimi për këtë depo së bashku me rrjetin shpërndarës për fshatin Lomje, mbrojtja e kaptazhit nr.2, rikonstruksion i linjës nga burimi Domaj deri në dalje të tunelit Kolosjan, ndërtim i rrjetit të furnizimit për depon Bushat dhe Mhole, ndërtim i vendrojtës në kaptazhin Domaj.

Financimi i realizimit të punimeve civile, mbikëqyrja dhe kolaudimi është kryer me fondet e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta me shkresën Nr. 2999 Prot. datë 24.11.2020 si dhe ndarja përkatëse me shkresën Nr. 2999/1 Prot. datë 24.01.2020.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 05.07.2021 dhe administruar në Bashkinë Kukës me Nr.3026/1Prot. datë 05.07.2021.

Punimet nuk kanë përfunduar pasi janë hasur vështirësi nga ana e banorëve në realizimin e vendosjes së matësve dhe riparimin e kolonave të brendshme të pallateve në qytetin e Kukësit. Afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar me amendamentet përkatëse Nr. 5224 Prot. datë 01.09.2021 dhe Nr.79Prot. datë 05.07.2023.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën Nr.336/1 Prot. datë 07.10.2020 dhe administruar në Bashkinë Kukës me Nr. 5900 Prot. datë 11.10.2022, ka kërkuar miratimin e projekt preventivit

të rishikuar të volumeve si dhe përdorimin e fondit rezervë për nevojat e ndryshme të punimeve brenda preventivit ofertues, këto të shoqëruara me relacionet përkatëse.

Miratimi i ndryshimeve në preventiv i volumeve (+/-) si dhe përdorimi i fondit rezervë është bërë me procesverbalin Nr. 5904 Prot datë 11.10.2022. Vlera e preventivit të rishikuar është i njëjtë me kontratën fillestare ku në të është përfshirë edhe vlera e fondit rezervë.

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **983,375 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë Rrjeti shpërndarës Lagja Industriale Kukës, zëri Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 1633.47 m² dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit nr. 3. Referuar vizatimeve sipas faktit plakat e granilit janë vendosur mbi një shtresë rëre me trashësi 3 cm e cila është e përfshirë në librezën e masave dhe e likuiduar në zërin 2.261 Shtresë rëre në volumin 48.99m³. Sipas analizës së çmimeve 2.288 Trotuar me pllaka, pa bordurën e betonit vërehet se, për vendosjen e pllakave është llogaritur shtresë zhavorri, llac çimento, beton C 7/10 dhe çimento. Meqenëse vendosja e pllakave është realizuar vetëm me shtresën e rërës, e cila është e likuiduar, mbikëqyrësi i punimeve duhet të kryente korigjimet përkatëse për pjesët e zërave të pa realizuar duke i zbritur ato nga çmimi njësi. Për sa më sipër kontraktori ka përfituar më tepër vlerën e zërave të pa realizuar për njësi 491 lekë/m² në total 802,033 lekë pa TVSH (1633.47 m² x 491lekë/m²).

-Në kategorinë Rikonstruksion i linjës nga Burimi Domaj deri në dalje të tunelit Kolosjan, konstatohet se sasia totale e gërmuar është 1749.04 m³ ku nga këto 773.33 m³ janë përdorur për mbushjen e kanaleve dhe 1003.34 m³ është transportuar në vend depozitim. Pra rezulton se sasia e përdorur për mbushjen dhe e transportuar është 1776.67 m³ ose 27.63 m³ më shumë nga ajo e gërmuar. Për sa më sipër sipërmarrësi i punimeve ka përfituar më tepër volumin e punimeve për zërat Transport dheu me auto deri 5 km kjo në vlerën 8,814 lekë pa TVSH (27.63m³x 319 lekë/m³) dhe Depozitim dheu në vend depozitim kjo në vlerën 13,263 lekë pa TVSH (27.63m³x 480 lekë/m³).

-Në kategorinë, Rikonstruksion i linjës nga Burimi Domaj deri në dalje të tunelit Kolosjan, nyja 1 dhe 2 janë realizuar së bashku dhe zbatimi i saj është sipas kushteve të terrenit. Për zërin Gërmim me krah seksion të detyruar b>1, h=1.5m, tokë e fortë në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 108.97 m³ dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit pjesor nr.3. Nga vizita në terren u konstatua se ky zë punimesh nuk është kryer sipas vizatimeve sipas faktit pasi vetëm një pjesë e nyjes është nën sipërfaqen natyrale të terrenit kështu që nga matjet e kryera sasia e volumit të gërmuar të pa kryer është afërsisht 65 m³. Pra kontraktori ka përfituar më tepër volumin e 65 m³ për zërin Gërmim me krah seksion të detyruar b>1, h=1.5m, tokë e fortë kjo në vlerën 58,500 lekë pa TVSH (65m³x 900 lekë/m³). Për rrjedhojë nga moskryerja e volumit të gërmimit kontraktori ka përfituar më tepër volumin 65 m³ për zërin Transport dheu me auto deri 5 km në vlerën 20,735 lekë pa TVSH (65 m³ x 319 lekë/m³) dhe zërin Depozitim dheu në vend depozitim në vlerën 31,200 lekë pa TVSH (65 m³ x 480 lekë/m³). Gjithashtu u konstatua se zëri Mbushje me çakëll pas mureve të pusëtës nuk ishte realizuar kështu që kontraktori ka përfituar më tepër volumin prej 48.83 m³, të pasqyruar në librezën e

masave dhe të likuiduar në situacionin pjesor nr.3, në vlerën 48,830 lekë pa TVSH (48.83 m³ x 1000 lekë/m³).

1. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.																												
Situata:	<p>Në objektin <u>“Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”</u> sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “C.” ShPK me Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 305,672,177 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 14 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimet e kontratës nr.5224prot. datë 01.09.2022 dhe nr.79prot. datë 05.07.2023, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Projekti fillestar;</i> • <i>Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);</i> • <i>Pagesat pjesore nga Situacioni nr. 1 deri Situacioni nr. 3;</i> • <i>Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës nr. 3;</i> • <i>Ndryshimet e miratuara nga AK;</i> • <i>Korrespondencat mes Bashkisë Kukës dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin “GJ. & CO” ShPK.</i> <p>si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="462 1045 1416 1459"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Kategoria e Punimeve</th> <th>Emërtimi i Zërit</th> <th>Vlera (lekë pa TVSH)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Rrjeti shpërndarës Lagja Industriale Kukës</td> <td>Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit</td> <td>802,033</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2</td> <td rowspan="2">Rikonstrukcion i linjës nga Burimi Domaj</td> <td>Transport dheu me auto deri 5 km</td> <td>8,814</td> </tr> <tr> <td>Depozitim dheu në vend depozitim</td> <td>13,263</td> </tr> <tr> <td rowspan="4">3</td> <td rowspan="4">Rikonstrukcion i linjës nga Burimi Domaj, nyja 1 dhe 2</td> <td>Gërmim me krah seksion të detyruar b>1, h=1.5m, tokë e fortë</td> <td>58,500</td> </tr> <tr> <td>Transport dheu me auto deri 5 km</td> <td>20,735</td> </tr> <tr> <td>Depozitim dheu në vend depozitim</td> <td>31,200</td> </tr> <tr> <td>Mbushje me çakëll pas mureve të pusëtës</td> <td>48,830</td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: right;">SHUMA</td> <td>983,375</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.13.</p>	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)	1	Rrjeti shpërndarës Lagja Industriale Kukës	Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit	802,033	2	Rikonstrukcion i linjës nga Burimi Domaj	Transport dheu me auto deri 5 km	8,814	Depozitim dheu në vend depozitim	13,263	3	Rikonstrukcion i linjës nga Burimi Domaj, nyja 1 dhe 2	Gërmim me krah seksion të detyruar b>1, h=1.5m, tokë e fortë	58,500	Transport dheu me auto deri 5 km	20,735	Depozitim dheu në vend depozitim	31,200	Mbushje me çakëll pas mureve të pusëtës	48,830	SHUMA			983,375
Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)																										
1	Rrjeti shpërndarës Lagja Industriale Kukës	Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit	802,033																										
2	Rikonstrukcion i linjës nga Burimi Domaj	Transport dheu me auto deri 5 km	8,814																										
		Depozitim dheu në vend depozitim	13,263																										
3	Rikonstrukcion i linjës nga Burimi Domaj, nyja 1 dhe 2	Gërmim me krah seksion të detyruar b>1, h=1.5m, tokë e fortë	58,500																										
		Transport dheu me auto deri 5 km	20,735																										
		Depozitim dheu në vend depozitim	31,200																										
		Mbushje me çakëll pas mureve të pusëtës	48,830																										
SHUMA			983,375																										
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <i>ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i></p> <p>- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu II, Pika 8.1 <i>ku përcaktohet se: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë</i></p>																												

	<p><i>kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës</i></p> <p>-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.</p> <p>- Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE <i>“GJ.&CO” ShPK</i> me Nr.82Prot. datë 02.07.2021 me objekt: <i>“Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”</i>, Neni 7, <i>“Detyrat dhe Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Punimeve”</i>.</p>
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 983,375 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e supervisorit i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 983,375 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "C." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 për zbatimin e punimeve.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi OE “GJ.&CO” ShPK sipas kontratës së shërbimit NR.82Prot, datë 02.07.2021 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”.

2. Për objektin **“Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar ‘Havzi Nela’, Kukës”**, gjatë auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Kukës dhe OE “C.” ShPK me Nr.139 Prot. datë 25.11.2022.*
- *Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin progresi përmbledhës v;*
- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin progresiv përmbledhës;*

3) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Kukës dhe OE “M.” ShPK me Nr.140 Prot. datë 25.11.2022.*

- *Korrespondencat mes Bashkisë Kukës dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin “M.” ShPK.*

Kontratat

Punimet kryhen sipas kontratës për punë publike me Nr.139 Prot. datë 25.11.2022 me objekt *“Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar ‘Havzi Nela’, Kukës”* të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, të përfaqësuar nga Titullari z. S.GJ. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “C.” ShPK me përfaqësues z. F. C. me licenca profesionale NZ0005/25. Vlera e kontratës është 127,064,830.80 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit NR.140Prot, datë 25.11.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "M." ShPK, me përfaqësues P. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/8, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,357,304.85 lekë me TVSH.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga OE "M." ShPK ku ishin të parashikuara të kryhen punimet e rikonstruksionit të godinës ekzistuese ku përfshihen; prishja e suvave të mureve dhe tavaneve, prishja e shtresave të soletës, çmontimi i dyerve dhe dritareve, prishja e pllakave dhe heqja e pajisjeve hidrosanitare. Pas prishjeve do të kryhen instalimet elektrike e hidraulike, do të kryhen suvatimet, vendosja e dyerve dhe dritareve të reja, vendosja e shtresave të reja si dhe lyerja e objektit me bojë hidroplastike. Në këtë projekt është parashikuar të ndërtohet dhe një objekt i ri me përmasa 15x5.5m katër kate mbi tokë me të gjitha pjesët përbërëse për funksionimin e tij. Gjithashtu për të dy objektet është parashikuar instalimi i sistemit të komunikimit (internet) me pjesët përbërëse, sistem sigurie vëzhgimi me kamera CCTV, instalimi i sistemit të ngrohjes me kaldajë dhe sistemi i detektimit të zjarrit me pjesët përbërëse kundra tij.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 30.11.2022. Punimet po kryhen brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Sipas situacionit progresiv të paraqitur rezulton se punimet janë kryer në masën 100%, ku po kryhen rifiniturat dhe testimet e sistemeve; mekanike, elektrike, sistemi kundra zjarrit dhe vëzhgimit.

Sipërmarrësi i punimeve me kërkesën datë 08.05.2023 (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për nevojat e ndryshme të punimeve brenda preventivit ofertues, ka paraqitur propozimet përkatëse të shoqëruara me relacionet teknike përkatëse. Bazuar në propozimet e kontraktorit dhe miratimit nga ana e tij mbikëqyrësi i punimeve më datë 10.05.2022 i është drejtuar Autoritetit Kontraktor për miratimin e këtyre ndryshimeve.

Me Procesverbalin e datës 11.05.2023 administruar nga Bashkia Kukës Nr.1705Prot. datë 11.05.2023, janë miratuar kërkesa për ndryshime volumesh (+/-), si dhe preventivi i rishikuar me vlerë 1,240.6 lekë pa TVSH, më pak se ai i kontratës fillestare ku në të është përfshirë edhe vlera e fondit rezervë.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, në objektin ekzistues dhe të ri, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit) dhe specifikimet teknike, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,384,600 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë, Punime shtresash (Objekti ekzistues), zëri Shtresë parketi (palestra) në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 305 m² dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Për nivelimin e sipërfaqes ku do të vendoset parketi, referuar manualit të çmimeve analiza 2.276 konstatohet se duhet të kryhet me bI.r pishe 50x50mm por faktikisht, sipas situacionit ky nivelim është kryer me llustër çimento 1:2 (2cm). Për këtë arsye mbikëqyrësi i punimeve duhet të kryente ndryshimet në çmimin e zërit Shtresë parketi (palestra) për koston e bI.reve prej pishe në vlerën 420 lekë/m². Për sa më sipër

sipërmarrësi i punimeve e ka përfituar më tepër në volumin e punimeve të kryer 305m² për bl. rret, kjo në vlerën 128,100 lekë pa TVSH (305 m² x 420 lekë/m²).

-Në kategorinë, Pajisje elektrike, zëri F V UPS, 3-fazor rack mounted në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 1 copë ku përfshihet furnizimi dhe vendosja dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga verifikimi u konstatua se sistemi UPS nuk ishte furnizuar kështu që as nuk ishte vendosur në punë. Për sa më sipër sipërmarrësi i punimeve ka përfituar vlerën e UPS 3-fazor prej 501,500 lekë pa TVSH.

-Në kategorinë, Rrjeti i dedektimit të zjarrit, zëri "F Central i alarmit të zjarrit, me 1 loop, tip inteligjent, i adresueshëm, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshëm, i pajisur me bateri me 72 orë pavarësi (Programim, testim & komisionim i sistemit të detektimit të zjarrit)" në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh të kryera 2 copë ku përfshihet furnizimi dhe vendosja dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga verifikimi u konstatua se sistemi ishte vendosur vetëm një central i alarmit të zjarrit. Për sa më sipër sipërmarrësi i punimeve ka përfituar vlerën e një centrali të detektimit të zjarrit prej 515,000 lekë pa TVSH, ku përfshihet furnizimi dhe vendosja e tij.

-Në kategorinë, Fikse zjarri me bombola, sipas zërave "F.V Fikëse zjarri me CO2, destinacioni për mbrojtjen e pajisjeve elektrike në ndërtesë. Tip bombul (e lëvizshme). Klasa e zjarrit 113B, kapaciteti normal 5 kg, pesha 14.1 kg. Diametri 152mm, lartësia 750 mm." 3 copë; "F.V Fikëse zjarri me CO2, e varur me funksion automatik" 1 copë; "F.V Fikëse zjarr me pluhur, destinacioni për mbrojtjen e pajisjeve elektrike në ndërtesë. Tip bombul (e lëvizshme). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartësia 640 mm." 15 copë dhe "F.V Fikëse zjarri karrelato" 1 copë të likuiduara sipas situacionit përfundimtar. Nga verifikimi u konstatua se bombolat e lëvizshme për fikjen e zjarrit nuk ishin vendosur në vendet e përcaktuara. Për sa më sipër sipërmarrësi i punimeve ka përfituar vlerën e bombolave të lëvizshme prej 240,000 lekë pa TVSH, ku përfshihet furnizimi dhe vendosja e tyre.

1. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.		
Situata:	<p>Në objektin <u>"Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar 'Havzi Nela', Kukës"</u>, sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE "C." ShPK me Nr.139Prot. datë 25.11.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 127,064,830.80 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti fillestar; • Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit); • Pagesat pjesore deri në situacionin progresiv përmbledhës; • Librezat e masave pjesore deri në situacionin përmbledhës; • Ndryshimet e miratuara nga AK; • Korrespondencat mes Bashkisë Kukës dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin "M." ShPK. <p>si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:</p>		
	Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit Vlera (lekë pa TVSH)

	1	Punime shtresash (Objekti ekzistues)	Shtresë parketi (palestra)	128,100
	2	Pajisje elektrike	F V UPS, 3-fazor rack mounted	501,500
	3	Rrjeti i dedektimit të zjarrit	F Central i alarmit të zjarrit, me 1 loop, tip inteligjent, i adresueshëm, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshëm, i pajisur me bateri me 72 orë pavarësi (Programim, testim & komisionim i sistemit të detektimit të zjarrit	515,000
	3	Fikse zjarri me bombola	F.V Fikëse zjarri me CO2, destl.cioni për mbrojtjen e pajisjeve elektrike në ndërtesë. Tip bombul (e lëvizshme). Klasa e zjarrit 113B, kapaciteti normal 5 kg, pesha 14.1 kg. Diametri 152mm, lartësia 750 mm.	36,000
			F.V Fikëse zjarri me CO2, e varur me funksion automatik	12,000
F.V Fikëse zjarri me pluhur, destl.cioni për mbrojtjen e pajisjeve elektrike në ndërtesë. Tip bombul (e lëvizshme). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartësia 640 mm			180,000	
		F.V Fikëse zjarri karrelato	12,000	
			SHUMA	1,384,600

Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.12.

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: *“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*.

- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 ku përcaktohet se: *“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi të, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”*.

-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3.

- Kontrata e shërbimit të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “M.” ShPK me Nr.140Prot. datë 25.11.2022 me objekt: *Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar ‘Havzi Nela’, Kukës”*, Neni 7, *“Detyrat dhe Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Punimeve”*.

Ndikimi/Efekti:

Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 1,384,600 lekë pa TVSH.

Shkaku:

Certifikimi nga ana e supervisorit i volumeve të punimeve të pakryera në

	fakt nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 1,384,600 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "C." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.139Prot. datë 25.11.2022 për zbatimin e punimeve.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi OE "M." ShPK sipas kontratës së shërbimit NR.140Prot, datë 25.11.2022 me objekt: "Mbikëqyrje e punimeve në objektin, Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar 'Havzi Nela', Kukës".

(Shënim: Nga totali i dosjeve të zbatimit të kontratave, u audituan vetëm dosjet e mësipërme)

Mbi auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël:

Për sa më sipër u kërkua nga grupi i auditimit dokumentet si më poshtë:

- 1.Regjistri i Realizimeve për Prokurimet me Vlerë të Vogël për vitin 2021-2022
- 2.Dosjet fizike të procedurave me vlerë të vogël për vitin 2021- 2022
- 3.Urdhëri i titullarit të Bashkisë Kukës për ngritjen KPVV.

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) u konstatua si më poshtë vijon:

Pas shqyrtimit të të dhënave të paraqitura nga Bashkisë Kukës, të dhënat e mbledhura nga përgjigjet e pyetësorit të realizuar nga grupi i auditimit, u konstatua se për vitin 2022 janë realizuar 43 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 24,397,159 lekë pa TVSh ndërsa për vitin 2021 janë realizuar 31 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 17,915,100 lekë pa TVSh.

Titullari i Ak Bashkia Kukës me urdhrin nr. 764 datë 10.12.2021 "Për delegimin e kompetencave për nëshkrimin e akteve administrative" ka autorizuar z. G.GJ. për nëshkrimin e akteve administrative të mëposhtme:

.si dhe dokumentat e tjera që lidhen me zbatimin e procedurave të prokurimit mbi/nën kufirin monetarë.

Me urdherin nr. 40, datë 25.01.2022, të firmosur nga z.G.GJ. është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla. Ky komision ka në përbërje znj. I.P. kryetar dhe anëtarët znj. F.S. dhe znj. N.P. Në muajin shkurt 2022 me urdherin nr. 151, datë 11.02.2022 është ndryshuar komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, në përbërje të komisionit në vazhdim janë z. E.SH. kryetar, znj. I.P. dhe znj. N.P. anëtarë.

Për periudhën 2022

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik(SPE) u konstatua si më poshtë vijon:

Nga 43 procedurat e prokurimit të kryera gjatë vitit 2022 u konstatuan se në **20 procedura prokurimi në shumën totale të fondit limit në vlerën 11,790,868 lekë pa TVSH, janë bërë klasifikim i ndryshëm i kodeve CPV (Kodi Përkatës Në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit) dhe objektit të prokurimit për procedura me natyrë të ngjashme duke sjell copëzimin e fondit për blerje me vlera të vogla të një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.**

Në asnjë procedurë nuk është argumentuar dhe dokumentuar nëse përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë është bërë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit në të gjitha rastet nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

Më poshtë parqitet në trajtë narrative situata për 20 procedurat e paraqitura në formë tabelle më sipër, konkretisht:

- **Në 2 procedura** me Kod CPV të njëjtë “Punë Ndërtimi” dhe objekt prokurimi të ngjashëm të cilat janë zhvilluar në muajin Tetor me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,750,000 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde e prokurimit, konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Tetor me objekt prokurimi “Reabilitim i oborrit dhe këndit të lojrave për Kopshtin Nr.2, Lagje 3”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “D.” me fond limit në shumën 861,960 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Tetor me objekt prokurimi “Rikualifikim i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare "Lidhje e Prizerenit Kukës”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “D.” me fond limit në shumën 930,439 lekë pa TVSH.

- **Në 7 procedura** me Kod CPV të ngjashëm “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë periudhës Mars – Qershor, me shumën totale të fondit limit në vlerën 2,862,500 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi “Aktivitete për 1 Qershorin - Ditës ndërkombëtare të fëmijeve”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “B.K.”, me fond limit në shumën 450,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi “Shërbim për organizimin e festivalit të fëmijëve”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “3E C.”, me fond limit në shumën 500,000 lekë pa TVSH.

Procedura me kod CPV “Dhurata dhe shpërblime ” dhe objekt prokurimi “Blerje dhuratash për mbrëmjen qëndrore të vitit të ri”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “5 XH G.”, me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentacioneve të dosjeve për procedurat e përmendura më sipër u konstatua se edhe pse për këto procedura janë përzgjedhur objekte prokurimi dhe kode CPV të ndryshme ato kanë natyrë të njëjtë sa i përket mallrave dhe shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në këto procedura .

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi “Aktivitete për hapjen e turizmit malor në Shishtavec”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “E.Z.”, me fond limit në shumën 350,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Qershor me kod CPV “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi “Aktivitete në ditën së bjeshkëve 11-Korriku ”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “G.P.”, me fond limit në shumën 600,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Qershor me kod CPV “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi “Aktivitete të festës tradicionale të Gjallicës dhe Rrunave”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “G.P.”, me fond limit në shumën 850,000 lekë pa TVSH.

Procedura me kod CPV “Shërbime pritjeje” dhe objekt prokurimi “Aktiviteti I.gurues i projektit për kopshtin Nr.2, Lagje 3”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “3E.”, me fond limit në shumën 112,500 lekë pa TVSH.

- **Në 7 procedura** me Kod CPV të njëjtë “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të

fondit limit në vlerën 2,706,748 lekë pa TVSH është copëzuar fondin dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit , konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Prill me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve të ndërtimit për objektin: Sistemim Asfaltim i rrugëve të brendshme të fshtatit Nange”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “P.G.”, me fond limit në shumën 360,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për projektin "Ndërtim i Bazamentit të Fushes stërvitore”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “P.G.”, me fond limit në shumën 163,900 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për projektin "Ndërtimi i murit rrethues të fushës stërvitore, Ilirjan Thaci””, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “P.G.”, me fond limit në shumën 255,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Korrik me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për Projektin "Ndërtim i rrugës Qëndër Shtiçen-Aeroport””, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “P.G.”, me fond limit në shumën 635,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Korrik me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për projektin "Ndërtim i rrugës Kolsh (gjatësi 1543 ml)”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “G&L C.”, me fond limit në shumën 348,300 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Dhjetor me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit ” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje për projektin Rikonstrukcion i godinës së re të shërbimit zjarrëfikës dhe sheshit”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “HE & SK 11”, me fond limit në shumën 515,500 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Shtator me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit ” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për Parkun e Aventurave”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “XH.N.” , me fond limit në shumën 428,248 lekë pa TVSH.

- **Në 2 procedura** me Kod CPV të njëjtë “Projekte” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,904,221 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Prill me kod CPV “Projekte” dhe objekt prokurimi “Hartim projekti për objektin Kanali Kullues Shtiçen”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “M.”, me fond limit në shumën 943,414 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Projekte” dhe objekt prokurimi “Hartim projekti për objektin: Rruga Novosej”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “M.”, me fond limit në shumën 960,807 lekë pa TVSH.

-**Në 2 procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,725,000 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit, konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Nentor me kod CPV “Shërbim i Agjensisë së Siguracionit” dhe objekt prokurimi “Shërbim i sigurimit të detyrueshëm TPL të automjeteve”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “A.”, me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Mars me kod CPV “Shërbime të Sigurimit të Jetës” dhe objekt prokurimi “Sigurim i punonjësve të MZSH-së”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “A.jetë, me fond limit në shumën 925,000 lekë pa TVSH.

Për periudhën ushtrimore 2021

Nga auditimi i periudhës 01.01.2021 – 31.12.2021 bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga ky institucion, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik(SPE) u konstatua si më poshtë vijon

Me urdhërin nr. 87, datë 05.02.2021, të firmosur nga znj. M. O. si personi i autorizuar prej titullarit të Autoritetit Kontraktor z. S.GJ. është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla. Ky komision ka në përbërje z. E.T. kryetar dhe anëtarët znj. F.S. dhe znj. N.P. Ky komision nuk ka pësuar ndryshime të tjera deri në fund të vitit 2021.

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe nga verifikimi i procedurave me zgjedhje në Sistemin e Prokurimit Elektronik(SPE) u konstatua si më poshtë vijon:

Nga 31 procedurat e prokurimit të kryera gjatë vitit 2021 u konstatuan se në **10 procedura prokurimi në shumën totale të fondit limit në vlerën 5,650,000 lekë pa TVSH, janë bërë klasifikim i ndryshëm i kodeve CPV (Kodi Përkatës Në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit) dhe objektit të prokurimit për procedura me natyrë të ngjashme duke sjell copëzimin e fondit për blerje me vlera të vogla të një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.**

Në asnjë procedurë nuk është argumentuar dhe dokumentuar nëse përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë është bërë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit në të gjitha rastet nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

Më poshtë parqitet në trajtë narrative situata për 10 procedurat e paraqitura në forme table me sipër, konkretisht:

- **Në 2 procedura** me Kod CPV të ngjashëm “Shërbime të organizimit të eventeve”, objekt prokurimi të ngjashëm me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,400,000lekë pa TVSH pasi u shqyrtuan dokumentacioni i dosjeve konstatohet se për këto procedura janë përzgjedhur objekte prokurimi dhe kode CPV të ndryshme por ato kanë natyrë të njëjtë sa i përket mallrave dhe shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në këto procedura duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Dhjetor me kod CPV “Dhurata, shpërblime” dhe objekt prokurimi “Blerje dhuratash për mbrëmjen qendrore të vitit të ri”, me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH , Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “N.H.”.

Procedura e zhvilluar në muajin Qershor me kod CPV “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi “Aktivitet i ditës së bjeshkëve 11-korrik”, me fond limit në shumën 600,000 lekë pa TVSH , Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “A.G.”.

- **Në 2 procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar në muajin Nëntor, me shumën totale të fondit limit në vlerën 950,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit, pra këto procedura duhet të kryheshin tenderim konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Nëntor me kod CPV “Veshje sportive” dhe objekt prokurimi “Blerje materiale sportive”, me fond limit në shumën 450,000 lekë pa TVSH, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “L.K.”.

Procedura e zhvilluar në muajin Nëntor me kod CPV “Uniforma Policie” dhe objekt prokurimi “Blerje uniforma për Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare”, me fond limit në shumën 500,000 lekë pa TVSH, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “G.S.”.

- **Në 4 procedura procedura** me Kod CPV të ngjashëm dhe objekt prokurimi të njëjtë, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,575,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit, pra këto procedura duhet të kryheshin tenderim konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Shtator me kod CPV “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve të ndërtimit për objektin:Rikonstruksion i rrugës Malqene”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “P.G.”, me fond limit në shumën 398,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Punë ndërtimi” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për objektin: Asfaltim i rrugës së fshatit Bushat”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “M.”, me fond limit në shumën 326,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Maj me kod CPV “Punë ndërtimi” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për objektin:” Sistemim asfaltim i Rrugës Pallati Kulturës - GodI. e Turizmit Kukës”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “XH.N.”, me fond limit në shumën 480,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Prill me kod CPV “Punë ndërtimi” dhe objekt prokurimi “Mbikëqyrje e punimeve për objektin:Rehabilitimi i rrugës Rilindja”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “L.& CO”, me fond limit në shumën 371,000 lekë pa TVSH.

- **Në 2 procedura procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,725,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit, pra këto procedura duhet të kryheshin tenderim konkretisht:

Procedura e zhvilluar në muajin Tetor me kod CPV “Shërbim i Agjensisë së Siguracionit” dhe objekt prokurimi “Shërbim i sigurimit të detyrueshëm TPL të automjeteve”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “I. sh.a”, me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH.

Procedura e zhvilluar në muajin Mars me kod CPV “Shërbime të Sigurimit të Jetës” dhe objekt prokurimi “Sigurim i punonjësve të MZSH-së”, Operatori Ekonomik i shpallur fitues është “A., me fond limit në shumën 925,000 lekë pa TVSH.

Titulli i gjetjes nr.1: Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për vitet ushtrimore 2021 dhe 2022.

Situata: Për vitin 2022, Nga auditimi ka rezultuar se për 43 procedurat e prokurimit të kryera u konstatuan se në **20 procedura** prokurimi në shumën totale të fondit limit **në vlerën 11,790,868 lekë pa TVSH**, është bërë klasifikim i ndryshëm i kodeve CPV (Kodi Përkatës Në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit) dhe i objektit të prokurimit për procedura me natyrë të ngjashme duke sjell copëzimin e fondit për blerje me vlera të vogla të një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe në asnjë procedurë nuk është argumentuar dhe dokumentuar nëse përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë është bërë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Raporti përmbledhës i procedurës së

prokurimit në të gjitha rastet nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

- **Në 2 procedura** me Kod CPV të njëjtë “Punë Ndërtimi” dhe objekt prokurimi të ngjashëm të cilat janë zhvilluar në muajin Tetor me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,750,000 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde e prokurimit.

- **Në 7 procedura** me Kod CPV të ngjashëm “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë periudhës Mars – Qershor, me shumën totale të fondit limit në vlerën 2,862,500 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

- **Në 7 procedura procedura** me Kod CPV të njëjtë “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 2,706,748 lekë pa TVSH është copëzuar fondin dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

- **Në 2 procedura procedura** me Kod CPV të njëjtë “Projekte” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,904,221 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

-**Në 2 procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,725,000 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Për vitin 2021, Nga auditimi ka rezultuar se për 31 procedurat e prokurimit të kryera u konstatuan se në **10 procedura** prokurimi në shumën totale të fondit limit në vlerën **5,650,000 lekë pa TVSH**, është bërë klasifikim i ndryshëm i kodeve CPV (Kodi Përkatës Në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit) dhe i objektit të prokurimit për procedura me natyrë të ngjashme duke sjell copëzimin e fondit për blerje me vlera të vogla të një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe në asnjë procedurë nuk është argumentuar dhe dokumentuar nëse përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë është bërë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit në të gjitha rastet nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

- **Në 2 procedura** me Kod CPV të ngjashëm “Shërbime të organizimit të eventeve”, objekt prokurimi të ngjashëm me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,400,000lekë pa TVSH pasi u shqyrtuan dokumentacioni i dosjeve konstatohet se për këto procedura janë përzgjedhur objekte prokurimi dhe kode CPV të ndryshme, por ato kanë natyrë të njëjtë sa i përket mallrave dhe shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në këto procedura duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

- **Në 2 procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar në muajin Nëntor, me shumën totale të fondit limit në vlerën 950,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit.

- **Në 4 procedura procedura** me Kod CPV të ngjashëm dhe objekt prokurimi të njëjtë, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,575,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit.

- **Në 2 procedura procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,725,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Trajtuar gjerësisht në akt-konstatimin nr.2, datë 04.09.2023

Kriteri: mospërputhje Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 2, në të cilën citohet se;

Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 1, paragrafi dytë në të cilën citohet se;

Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

pika 8 në të cilën citohet se;

Në asnjë rast, procedura e prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit.

Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 3, në të cilën citohet se;

Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e procedurës konform kuadrit rregullator për prokurimet me vlerë të vogël.

Shkaku: Mosnjohje e ligjit, VKM dhe Udhëzimit përkatës për blerjet e vogla.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandim: Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese të merren masa e nevojshme si më poshtë:

1. Komisioni i Blerjeve të Vogla, të marrë masa për administrimin e çdo procedurë në dosje të veçanta.
2. Të hartojë fondin limit duke pasqyruar metodën e ndjekur dhe dokumentacionin provues.
3. Të hartojë procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për operatorët ekonomikë të rënditur deri në vendin e 10-të.
4. Komisioni i Blerjeve të Vogla, të firmosë faturat e tvsh-së për blerjen e mallit ose shërbimit të kryer.
5. Komisioni i Blerjeve të Vogla, të përcaktojë në urdhrin e prokurimit fondin e përlllogaritur.
6. Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për planifikimin e blerjeve dhe shërbimeve, duke mos kryer copëzim të fondeve.
7. Drejtoria Ekonomike, të kryejë likuidimin e faturave brenda afatit ligjor.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z. G.GJ. me detyrë, në cilësinë personit të autorizuar nga titullari i AK, për veprimet dhe mos veprimet në pozicionin që prfaqson.
- 2) Z. E.SH. kryetar i Komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.

- 3) Z. E.T. kryetar i Komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.
- 4) Znj. I.P., anëtarë i Komisionit të blerjeve me vlerë të vogël si dhe në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimet, për përzgjedhjen e OE pjesmarrës në procedurat e prokurimit.
- 5) Znj. N.P. anëtarë i Komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.
- 6) Znj. F.S. anëtarë i Komisionit të blerjeve me vlerë të vogël.
- 7) Z. K.T. në cilësinë e antarit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt “Reabilitim i oborrit dhe këndit të lojrave për Kopshtin nr. 2, Lagje 3” i ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit.

Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt objekt “Reabilitim i oborrit dhe këndit të lojrave për Kopshtin nr. 2, Lagje 3”.

Titulli i gjetjes nr.2: Procedura e prokurimit me objekt “Reabilitim i oborrit dhe këndit të lojrave për Kopshtin nr. 2, Lagje 3”, me fond limit në shumën 861,960 lekë pa TVSh, me OE fituese “D.” Shpk me ofertë ekonomike në shumën 830,000 lekë pa TVSh.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se në dokumentacionin e paraqitur për pjesëmarrje në këtë procedurë nga OE në shtojcën 7, mbi plotësimin e deklaratës së konfliktit të interesit, është deklaruar se “nuk është në kushtet e konfliktit të interesit” me punonjës të AK.

- Në formularin e deklarimit bashkëngjitur praktikës së krijimit të grupit të punës nënshkruar më datë 26.09.2022 nga z. K.T., ky punonjës ka deklaruar dhe nënshkruar ekzistencën e konfliktit të interesit.

- Në listëpagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën ushtrimore viti 2022 muajin gusht z. K.T. figuron si i punësuar në të njëjtën kohë në Bashkinë Kukës dhe pranë OE “D.” Shpk gjithashtu ky punonjës është i biri i ortakut të vetëm të OE Fitues, z. K.D.

- Me urdhërin nr. 752 prot., datë 26.09.2022 të nënshkruar nga z. G.GJ., në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari i AK z. S.GJ., “Për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit, për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Reabilitimi i oborrit dhe këndit të lojrave për kopshtin nr.2, lagjia nr.3”, z. K.T. është caktuar anëtar i këtij grupi pune edhe pse ky punonjës ka deklaruar më parë se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit .

- Me urdhërin nr. 5744 prot., datë 04.10.2022 është hartuar/nënshkruar procesverbali “Për argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit dhe për hartimin e specifikimeve teknike”, për procedurën e prokurimit me objekt: “Reabilitimi i oborrit dhe këndit të lojrave për kopshtin nr. 2, lagjia nr.3” dhe shkresa me të njëjtin numër protokoll, drejtuar Drejtorisë Juridike.

- Në urdhërin e prokurimit nr.752 datë 04/10/2022 formulari 2 “Për prokurimin me vlera të vogla” të nënshkruar nga z. G.GJ. në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari i AK z. S.GJ. është përzgjedhur procedura e prokurimit me vlerë të vogël për procedurën “Reabilitimi i oborrit dhe këndit të lojrave për kopshtin nr.2,lagjia nr. 3” dhe më datë 07/10/2022 është nisur ftesa për ofertë me nr 5841/1 prot. OE “D.” Shpk, edhe pse nga z. K.T. është deklaruar konflikti i interesit.

- Nga verifikimi i dokumentave në dosje dhe në SPE, rezultoi se për procedura me Kod CPV të njëjtë “Punë ndërtimi” dhe objekt prokurimi të ngjashëm të cilat janë zhvilluar në muajin Tetor respektivisht më datë 06.10.2022 dhe 10.10.2022, me vlerën totale të fondit limit 1,750,000 lekë pa Tvsh, me OE “D.” Shpk fitues, konstatohet copëzim fondi duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

- Në praktikat shkresore të procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojrave për kopështin nr.2, lagjia nr.3” dhe procedurës me objekt: “Rikualifikim i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare “Lidhje e Prizerenit” Kukës”, u konstatua që egzistojnë nga dy formularë për deklarimin e mospasjes së konfliktit të interesit me shrehje të kundërta nga z. E.SH. (kryetar), znj. G.E. dhe znj. N.P. (anëtare të komisionit) konkretisht:

Për procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojrave për kopështin nr.2, lagjia nr.3” më datë 07.10.2022, komisioni deklaroi dhe nënshkruan ekzistencën e konfliktit të interesit dhe më datë 10.10.2022 deklaroi/nënshkruan se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit.

Për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikim i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare “Lidhje e Prizerenit” Kukës” më datë 05.10.2022, komisioni deklaroi dhe nënshkruan ekzistencën e konfliktit të interesit dhe më datë 06.10.2022 deklaroi/nënshkruan se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit. Nga shqyrtimi i raportit përmbledhës (REF-44755-10-07-2022) datë 18.10.2022 konstatohet se:

- Ftesa për ofertë ju është nisur 5 (pesë) OE (OE “M.” Shpk, OE “D.” Shpk, OE “P. G.” Shpk dhe OE “O.” Shpk) por nuk është argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

Nga Komisioni Prokurimit të Blejre me vlerë të vogël në bazë kriterit të çmimit më të ulët më datë 10.10.2022, është shpallur fitues OE “R.” Shpk, renditur në vend të parë por nuk është paraqitur sipas afateve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. KVO nuk ka bërë njoftimin përkatës në APP, për OE lidhur me mosparaqitjen pa njoftuar në procedurën që shpallet fitues.

- Me Procesverbalin e datës 11.10.2022, KVO ka dërguar njoftimin e fituesi për OE “D.” Shpk, renditur në vend të dytë, me vlerë ekonomike të ofertës 830,000 lekë pa Tvsh, pas kalimit të afatit të ankimit me procesverbalin e mbajtur në datë 17.10.2022, në bazë të kriterit të çmimit më të ulët ky komision shpall fitues OE “D.” Shpk e renditur në vend të dytë.

- Kontrata me nr.120 Prot., datë 18.10.2022, është lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kukës, përfaqësuar nga z. S.GJ. në cilësinë e Titullarit të Ak dhe OE “D.” Shpk , përfaqësuar nga z. K.D. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor për OE “D.” Shpk.

Për këtë çështje KVO nuk ka s’kualifikuar këtë OE, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit. Deklarata e paraqitur nga OE konsiderohet e rreme, dhe punonjësi nuk ka vënë në dijeni AK, për këtë situatë. Gjithashtu KVO, në dijeni të ndodhjes përpara faktit të një konflikti interesi të mundshëm, nuk ka sinjalizuar në instancat përkatëse për këtë dukuri, dhe nuk është shprehur në Raportin përfundimtar mbi vlerësimin e ofertave, të cilën ja ka paraqitur titullarit të AK. Titullari ka miratuar dhe raportin e KVO, për të cilën ka dijeni të kësaj dukurie dhe përsëri nuk ka bërë asnjë vendimarrje, për punonjësin i cili është në marrëdhënie pune edhe te OE “D.” Shpk. *Veprime për të cilat mban përgjegjësi titullari i AK z. G.GJ. Trajtuar gjerësisht në Projektraportin e auditimit.*

Kriteri: Pikën 5 të Nenin 13 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Nenin 27 të VKM nr. 285, datë datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pika 4 e Nenin 73 të VKM nr. 285, datë datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pikën 2 të nenit 18 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Pikën 1 të nenit 19 të ligjit nr. 162/2020 “për prokurimin publik”.

Pika 4. atëherë titullari i autoritetit kontraktor, në varësi të dëmit që mund të jetë shkaktuar, vendos nëse duhet të zëvendësohen anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit e të vijojë procesin apo të anulojë procedurën e prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e procedurës konform kuadrit rregulator për prokurimet me vlerë të vogël.

Shkaku: Mosnjohje e ligjit, VKM dhe Udhëzimit përkatës për blerjet e vogla.

Rëndësia: E Lartë.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kukës dhe strukturave Drejtuese të merren masa për të zëvendësuar anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të kryhet procesi i dokumentimit dhe gjurmës së auditimit në mënyrë të tillë që në të ardhmen të parandalohen situatë ku mund të ketë anëtarë të komisioneve në kushte të konfliktit të interesit.

Observacion:

Për sa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet shkresës nr. 391, datë 10.11.2023, administruar nga KLSH me nr. 524/7, datë 13.11.2023, ka paraqitur komente dhe shpjegime për Projektraportin e Auditimit në lidhje me procedurat e prokurimit e konkretisht, nga Zj. I.P., z. E.T. dhe zj. N.P., është paraqitur observacion lidhur me;

Pretendimi i subjektit:

-Janë paraqitur pretendime në lidhje me procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

-Gjithashtu pretendohet se zj I.P. ka qënë më leje lindje nga data 26.04.2022-01.04.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionet e dërguara sqaron se;

Nuk janë paraqitur dokumentacion, referenca ligjore apo fakte të reja për pretendimet e observuesve, të ndryshme nga sa janë paraqitur për aktkonstatimet gjatë fazës së hartimit të Projektraportit të Auditimit, për të cilat grupi i auditimit i ka sqaruar sikurse gjatë auditimit në terren po ashtu edhe më pas. Gjithashtu z. K.T. ka qënë pjesë e komisionit të llogaritjes së fondit limit pasi ka qënë pjesë e komisionit të bvv.

Sqarojmë se zj. I.P., ka qënë përgjegjëse e prokurimeve caktuar me shkresën nr. 25 prot., datë 19.01.2022, çka rëzon pretendimin e saj për hartimin e regjistrave të prokurimit, për copëzimin e fondeve, të cilat hartohen në fillim të vitit.

Për këto arsye observacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë.

2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 429/1 prot; datë 19.05.2023, me objekt: “**Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**”, prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit;

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Auditimi konsistoi në këto fusha:

1. *Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.*
2. *Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimimi i kondicioneve urbane.*
3. *Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.*
4. *Dhënia e certifikatës së përdorimit.*

Bashkia Kukës ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.8, në datë 02.02.2017.

➤ **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për vitin 2022**

Duke ju referuar sistemit e-Leje të lejeve të ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Kukës, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, janë zhvilluar 81 aplikime, ndër të cilat janë miratuar **2 leje** zhvillimi, **16 leje** ndërtimi, **9** deklarata paraprahe për kryerje punimesh dhe **3** çertifikata përdorimi, të paraqitura në Aneksin L1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Kukës, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² është miratuar **1 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m² është miratuar **1 leje** ndërtimi, **2 leje** për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, **5 leje** ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni, **4 leje** për ndryshim funksioni, **1 leje** për ndryshimin e subjektit zhvillues, **1 leje** për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit, **1 leje** infrastrukture, **3** çertifikata përdorimi dhe **9** deklarata paraprahe për kryerje punimesh, të paraqitura në Aneksin L2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar lejet e ndërtimit dhe të certifikatës së përdorimit, të paraqitur në Aneksin L3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situata, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit, pasi nuk është në përputhje me projektin e ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-leje.

Titulli i gjetjes 1: Mosparaqitja e saktë e planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit, pasi nuk është në përputhje me projektin e ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-leje.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga “Kosova”, lagjia nr.2, Kukës, në shqyrtimin e projektit të ndërtimit dhe mbivendosjen me plansistemin, evidentohet që daljet konsol në katin e parë zhvillohen jashtë kufirit të pronës dhe nuk pasqyrohet me përmasat e sakta në planvendosjen e miratuar.

Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt*”, miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës, në përshkrimet dhe specifikimet e paraqitura në planvendosje nuk përputhen me projektin arkitektonik, pasi në prerjen B-B evidentohet që fasada lindore nuk është faqe kallkan pasi ka çarje në të.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 15, pika 1, gërma c, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;

Ndikimi/Efekti: Mospasqyrimi i saktë i planvendosjes dhe të dhënave të pasqyruara në të ndikon në mosrespektimin e distancave ndërmjet objekteve, në normat e lejuara të distancave; në lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re; në diellëzimin dhe orientimin;

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kukës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar planvendosjen e paraqitur si edhe të dhënat e përshkruara në të, që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.S.G.J., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës; Z.A.SH., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 10.10.2019 e në vijim; Znj.E.P., me detyrë shef i sektorit të DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.D.B., me detyrë specialist i DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.O.L., me pozicion juriste, nga periudha 06.03.2015, me raport për barrë lindje 27.10.2020- 30.04.2021

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë në lidhje me mosrespektimin e distancave të lejuara nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 2: Mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kritereve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit:

1. “*Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues Ikt*”, miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.8, në datë 02.02.2017, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë S.1.4, në sistemin urban, me kategorinë e lejuar s. shërbime dhe nënkategorinë e lejuar S.1. ambjente rekreacioni, duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 2, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 50%, me lartësi ndërtimi 18 metra dhe me numrin e lejuar të kateve mbi tokë 6 kate. Në planvendosjen e miratuar, në orjentimin verior, distanca ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës për objektin në lartësinë e 3 kateve është 1.5 metra, nga 4 metra që duhet respektuar, në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar me vendimin nr. 457, në neni 35.Gjithashtu në orjentimin lindor, distanca nga kufiri i pronës është 1 metër, nga 4 metra që është distanca minimale e lejuar. Ndërsa duke u bazuar tek Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.8, datë 08.02.2017, Neni 7, pika 16, përcaktohet që distanca e lejuar midis ndërtimit dhe kufirit të pronës në zonat e reja për zhvillim, ose në zonat ekzistuese për rihvillim, distanca minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është e barabartë me ½ e lartësisë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë. Objekti ka lartësinë totale 10.89 metra dhe distanca që duhet të respektojë sipas rregullores së planit është 5.45 metra.

2. “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga "Kosova", lagjia nr. 2, Kukës. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.8, në datë 02.02.2017, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë A3.3.15, në sistemin

urban, me kategorinë e lejuar banim 100% dhe nënkategorinë e lejuar të përdorimeve banimi, tregtare me sipërfaqe të vogël, shërbimet e interesit të përbashkët, zyra, shkolla, kopshte, qendra mjekësore, bare dhe restorante, hotele dhe shtëpi pritjeje, duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 1.3, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 60%, me lartësi ndërtimi 18 metra dhe me numrin e lejuar të kateve mbi tokë 6 kate.

Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 35, pika 1 dhe neni 34, pika 7, distanca që duhet të respektohet nga kufiri i pronës është 4 metra, për objektin në lartësinë e 3 kateve, duke përfshirë edhe daljen konsol prej 1.5 metrash dhe 1 metër. Në bazë të planvendosjes së miratuar në lejen e ndërtimit, për objektin në lartësinë e 3 kateve, nga 4 metër që është distanca minimale e lejuar nga kufiri i pronës është lënë distanca minimale 1 metër nga kufiri i pronës, në orjentimin e përcaktimit dhe në orjentimin jugor. Ndërsa duke u bazuar tek Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.8, datë 08.02.2017, Neni 7, pika 16, përcaktohet që distanca e lejuar midis ndërtimit dhe kufirit të pronës në zonat e reja për zhvillim, ose në zonat ekzistuese për rrizhvim, distanca minimale ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës është e barabartë me ½ e lartësisë maksimale mbi tokë të ndërtimit më të lartë. Objekti ka lartësinë totale 11.3 metra dhe distanca që duhet të respektojë sipas rregullores së planit është 5.65 metra.

Kriteri: VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 35, “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës”.

“Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës”, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.8, datë 08.02.2017, Neni 7, pika 16.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës cënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe zhvillimin e mëtejshëm të ndërtimeve të reja në parcelat me të cilat kufizohet, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kukës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.S.G.J., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës; Z.A.SH., me detyrë Drejtor i DPZHT, nga periudha 10.10.2019 e në vijim; Znj.E.P., me detyrë shef i sektorit të DPZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.D.B., me detyrë specialist i DPZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.O.L., me pozicion juriste, nga periudha 06.03.2015, me raport për barrë lindje 27.10.2020- 30.04.2021.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosparaqitjen në hartën treguese të gjurmës së objektit për të cilin apikohet për leje ndërtimi për shtesë kati dhe pasqyrimin e të dhënave të ndryshme në dokumentacionin që vërteton të drejtën pasurore të pronës që do të zhvillohet.

Titulli i gjetjes 3: Mosparaqitja në hartën treguese e gjurmës së objektit për të cilin apikohet për leje ndërtimi për shtesë kati dhe pasqyrimi i të dhënave të ndryshme në dokumentacionin që vërteton të drejtën pasurore të pronës që do të zhvillohet.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se për objektin. “Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt”, miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës, në

dokumentacionet e ngarkuara në sistemin e-leje, të cilat vërtetojnë pronësinë e truallit dhe ndërtesës në të cilën do të zhvillohen katet shtesë, paraqiten të dhëna dhe përshkrime të ndryshme lidhur me sipërfaqen ekzistuese të ndërtimit përpara miratimit të shtesës. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në neni 15, pika b, në dokumentacionet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t’u pajisur me leje ndërtimi janë edhe dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta. Në çertifikatën për vërtetimin e pronësisë, të ngarkuar në kopjen e dokumentit të pronësisë të ngarkuar në sistemin e-leje, për pasurinë me nr.27/60, në zonën kadastrale 2315, me sipërfaqe truall 1524.9 m2, në pronësi të znj.S. V. P., të lëshuar në datën 30.01.2020, sipërfaqja e ndërtesës është 881.98 m2. Në fragmentin e hartës treguese të lëshuar në datën 28.04.2021, në pasurinë me nr.27/60, në zonën kadastrale 2315, me indeksin e hartës KU-H-6, pasqyrohet gjurma e një godinë të vetme në lartësinë e 2 dhe 3 kateve. Objekti për të cilin është aplikuar për leje për shtesë në lartësinë e dy kateve, nuk pasqyrohet në hartën treguese. Në dokumentat e pronësisë janë të ngarkuar 2 kartela pasurie, më të dhëna të ndryshme. Kartela e parë e lëshuar në datën 26.05.2021, me 3 faqe përshkrim, me sipërfaqe ndërtese prej 984.53 m2. Në kufizimet e pronësisë të përshkruara në pikën D të kartelës së pasurisë së paluajtshme përcaktohet se në vitin 18/06/2013, mbi pasurinë vendoset masë sigurimi sipas vendimit nr.15 datë 18.02.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe në vitin 21/11/2014, pasuria vihet në sekuestro konservativ e nga permbarues B.S. Gjithashtu në 23/11/2020 përshkruhet se në kartelë diferenca fakt-dokument është 68.2m2. Në datën 28.12.2021 është lëshuar një tjetër kartelë, në të cilën përshkrimi i kufizimeve të pronësisë të vitit 2013 dhe 2014 nuk paraqiten më si pjesë e kartelës. Në dokumentacionin e ngarkuar për aplikimin për leje ndërtimi, nuk dokumentohet Vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër. Në datën 01.12.2021 paraqitet një kërkesë drejtuar Drejtorisë së Pronave Publike të Ardhurave Publike, Lejeve dhe Licensave, në të cilën subjekti S. ShPK kërkon tërheqjen e dokumentacionit të pronësisë të paraqitur në sistemin e-leje dhe zëvendësimin e tij me dokumentacionin e ri. Në çertifikatën për vërtetimin e pronësisë, të bashkëlidhur shkresës, për pasurinë me nr.27/60, në zonën kadastrale 2315, me sipërfaqe truall 1524.9 m2, në pronësi të znj. S. V. P., të lëshuar në datën 19.09.2021, sipërfaqja e ndërtesës është 984.53 m2. Në kartelën e pasurisë bashkëngjitur dokumentacionit, e lëshuar në datën 19.07.2021, me 3 faqe përshkrim, me sipërfaqe ndërtese prej 984.53 m2. Edhe në këtë kartelë janë paraqitur kufizimet e pronësisë të vitit 2013 dhe 2014, si në kartelën e datës 26.05.2021.

Kriteri: Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në neni 15, pika b.

Ndikimi/Efekti: Mosparaqitja në dokumentacionin e pronësisë gjurmën e objektit në të cilin do të zhvillohen katet shtesë ndikon në miratimin lejes së ndërtimit për shtesë kati, pa konfirmuar më parë ekzistencën e katit mbi të cilën do të zhvillohen katet e tjera, duke ndikuar në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e ndërtimit të objektit.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kukës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, që të vërtetojnë ekzistencën e objektit në të cilin do të zhvillohet shtesa e kateve të ndërtimit në hartën treguese, në të dhënat/përshkrimet e paraqitura në kartelën e pasurisë dhe të mos ketë kufizim të pronësisë, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.S.GJ., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës; Z.A.SH., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 10.10.2019 e në vijim; Znj.E.P., me detyrë shef i sektorit të DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.D.B., me detyrë specialist i DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.O.L., me pozicion juriste, nga periudha 06.03.2015, me raport për barrëindje 27.10.2020- 30.04.2021.

Gjatë auditimit të çertifikateve të përdorimit u konstatuan 2 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen e realizimit të punimeve të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes 4: Mospërputhja e realizimit të punimeve të ndërtimit me lejen e ndërtimit të miratuar, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit nuk janë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar për objektet:

1. “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga "Kosova", lagjia nr. 2, Kukës. Çertifikata e përdorimit është dhënë në bazë të lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin Nr.8, datë 20.01.2021, me një vlefshmëri 12 muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve. Data e njoftimit të fillimit të punimeve është 29.01.2021. Më pas është miratuar leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me anë të vendimit Nr.62, datë 03/02/2022. Në projektin arkitektonik të pasqyruar në lejen e ndërtimit të miratuar dhe në projektin “as building” të paraqitur në çertifikatën e përdorimit, në planimetrinë e katit të dytë evidentohet që në ballkon ka dalje vetëm pranë nuklit të shkallëve. Në realizimin e objektit evidentohet që ballkoni i katit të dytë ka sipërfaqe më të madhe dhe është i aksesueshëm edhe nga dy dhomat në krah me nuklin e shkallëve. Gjithashtu trajtimi i fasadës veriore dhe jug perëndimore me vetratë xhami nuk është i njëjtë me projektin e paraqitur. Realizimi i objektit nuk është në përputhshmëri me projektin e ndërtimit të miratuar. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, në fotot e pasqyruara të realizimit të objektit, evidentohet që rrethimi i jashtëm i objektit në orjetimin jug perëndim, tejkalon kufirin e pronës, duke përfshirë edhe hapësirën me të cilën kufizohet.

2. “*Objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë dhe objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë*”, miratuar me vendimin Nr.5489 datë 22/09/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në adresën Lagjia 5, Kukës. Çertifikata e përdorimit është miratuar në bazë të lejes së ndërtimit me vendimin Nr 171, datë 29/09/2020 dhe lejes për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit me vendimin Nr. 31, datë 02/03/2021. Nga verifikimi i projektit “as building” të ngarkuar në sistemin e-leje dhe realizimit në terren të zbatimit të punimeve, kati përdhe nuk është realizuar si ambient shërbimi dhe nuk është trajtuar me fasadë e vetratë xhami si në projektin e miratuar. Në planvendosjen e miratuar në ndryshimin e projektit janë të pasqyruara disa shkallë që aksesojnë ambientet e shërbimeve në hyrje të secilës godinë dhe rampë për personat me aftësi të kufizuar, të cilat nuk janë realizuar në zbatimin e projektit të ndërtimit. Gjithashtu godinat janë të ngritura 45 cm mbi nivelin e kuotës së sistemit të terrenit përreth, në ndryshim nga realizimi. Rampa për aksesin e katit nëntokë nuk është realizuar sipas projektit të miratuar dhe zhvillohet jashtë kufirit të pronës. Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit”, neni 42, pika 3, përcaktohet se: “Çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas

fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor.”. Ndërsa në pikën 4, të nenit 42, të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, përcaktohet se: “Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.”. Gjithashtu duke u bazuar në VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27, mbikëqyrja e punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, pika 3, përcaktohet se: “Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollin e mbajtura, ai merr masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle.” Nga mungesa e verifikimit në terren dhe shqyrtimi i akteve të kontrollit që vërtetojnë realizimin e punimeve të ndërtimit, ka sjellë si pasojë realizimin e objektit jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, “Çertifikata e përdorimit”, VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1.

Ndikimi/Efekti: Realizimi i ndërtimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin e ndërtimeve në mospërputhje me parametrat dhe kriteret e zhvillimit urban, të tilla si distanca nga kufiri i pronës, distanca ndërmjet objekteve, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kukës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me certifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.1, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.S.GJ., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës; Z.A.SH., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 10.10.2019 e në vijim; Znj.E.P., me detyrë shef i sektorit të DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.D.B., me detyrë specialist i DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.O.L., me pozicion juriste, nga periudha 06.03.2015, me raport për barrë lindje 27.10.2020- 30.04.2021.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.S.GJ., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës; Z.A.SH., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 10.10.2019 e në vijim; Znj.D.B., me detyrë specialist i DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.O.M., me pozicion topografe, nga periudha 16.06.2022 e në vijim.

Gjatë auditimit të certifikateve të përdorimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit pa përfunduar punimet e ndërtimit.

Titulli i gjetjes 5: Miratimi i certifikatës së përdorimit pa përfunduar punimet e ndërtimit, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se certifikata e përdorimit është miratuar përpara përfundimit të punimeve të ndërtimit në objektin: “Objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën

tokë dhe objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me nje kat parkimi nën tokë”, miratuar me vendimin Nr.5489 datë 22/09/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në adresën Lagjia 5, Kukës. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.3, në datë 17.05.2019, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë pjesërisht në njësinë A3.2.13. Njësia A3.2.13 bën pjesë në sistemin urban, me kategorinë A. Banim dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 0.8, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 50%, me lartësi ndërtimi 12 metra, me numrin e lejuar të kateve mbi tokë 4 kate dhe kërkon zhvillimin me PDV në rast ndërhyrje të rikualifikimit, zëvendësimit të tesutit ekzistues urbanistik të ndërtimit që favorizon një cilësi më të mirë arkitektonike dhe jetese në zonë. Me anë të Vendimit Nr.12, datë 10.06.2020, të Këshillit Kombëtar të Territorit, është miratuar leja e zhvillimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh 8 kat me 1 kat nëntokë, në rrugën “Dëshmorët”, Bashkia Kukës”. Me anë të Vendimit Nr.61, datë 29.12.2020, të Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e ndryshimit të destinacionit të katit përdhe në objektin nr.2 që po ndërtohet sipas kërkesës së Bashkisë Kukës për blerjen e kateve përdhe në të dy objektet në funksion të përdorimit si ambjent arsimor (kopësht-çerdhe), vendosi të:1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Kukës për blerjen e ambjenteve të shërbimeve të katit përdhe në objektet që po ndërton EKB-ja në qytetin e Kukësit, për t’i përdorur për ambjentet arsimore.2.Të miratojë ndryshimin e projektit të banesës Nr.2 lidhur me përshtatjen e katit përdhe të kësaj banese nga ambjente banimi në ambjente shërbimi.3.Të miratojë aneks marrëveshjen si pjesë përpërëse e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.2476/2 prot., datë 10.12.2019 dhe Nr.4214 prot., datë 06.12.2019, të ndryshuar, sipas draftit bashkëlidhur këtij vendimi. Bashkia Kukës, me anë të shkresës Nr.6181/1 prot., datë 17.12.2020, merr përsipër të përmbushë detyrimet e saj, sipas marrëveshjes dypalëshe që do të hartohet mbi mënyrën e likuidimit. Banesat që do të ndërtohen do të kenë të njëjti projekt zbatimi në katin përdhe (si ambiente shërbimi) dhe me vetrata xhami. Çdo ndryshim i mëtejshëm për përshtatje sipas funksionit do të mbulohet nga vetë Bashkia Kukës. Marrëveshja ndërmjet dy palëve nuk është realizuar dhe ndarjet e katit përdhe të objekteve nuk janë realizuar, duke miratuar certifikatën e përdorimit me punime të papërfunduara dhe ambientet nuk janë ende në përdorim. Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit”, neni 42, pika 3, përcaktohet se: “Çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor.” Nga mungesa e verifikimit në terren dhe shqyrtimi i akteve të kontrollit që vërtetojnë realizimin e punimeve të ndërtimit, ka sjellë si pasojë miratimin e certifikatës së përdorimit të objektit, pa përfunduar realizimi i punimeve të ndërtimit.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, “Çertifikata e përdorimit”, VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1.

Ndikimi/Efekti: Miratimi i certifikatës së përdorimit përpara përfundimit të punimeve cënon qëndrueshmërinë dhe sigurinë në objekt.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHT Kukës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me certifikatë përdorimi objekte pa verifikuar më parë përfundimin e realizimit të punimeve të ndërtimit.

Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me nr.2, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit: Z.S.GJ., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës; Z.A.SH., me detyrë Drejtor i DPKZHT, nga periudha 10.10.2019 e në vijim; Znj.D.B., me detyrë specialist i DPKZHT, nga periudha 25.11.2021 e në vijim; Znj.O.M., me pozicion topografe, nga periudha 16.06.2022 e në vijim.

2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit me nr. 429/1 prot., datë 19.05.2023, me objekt: **“Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:**

1.1 Mbi krijimin e organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit.

Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor të Bashkisë Kukës (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me VKB nr.71 date 24.12.2021, për miratimin e strukturës organizative dhe konfirmimi i Prefektit Shkresën nr. 1/62 date 06.01.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kukës dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara”, ku përfshihet Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor e cila përbehet nga 8 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor dhe 7 inspektore në fakt aktualisht në punë janë 8 punonjës, Kryeinspektori dhe shtatë Inspektori në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 1 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

1.2. Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësisë të vartësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMTV, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e Bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Kukës për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022 rezultoi se janë mbajtur gjithsej 60 procesverbale konstatimi në zbatim të ligjit 107/2014, ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Në lidhje me realizimin e të ardhurat nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë (IMTV) konstatohet se:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IMTV Bashkia Kukës, sipas evidencave të vëna në dispozicion për periudhën objekt auditimi rezultoi se janë mbajtur procesverbalet e konstatimit të shkeljeve në punimet e ndërtimit të hartuara nga IMTV, vendimet e marra nga kryeinspektori për pezullimin e punimeve të ndërtimit, vendimet e gjobave dhe vendimet e prishjeve për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi. Në formë tabele paraqiten vendimeve të marra nga IMTV për vitin 2022 *si vijon:*

Nr.	Lloji i aktit	2021	2022
1	PV/Akte kontrolli	4	2
2	PV/Akte konstatimi	92	60
3	Vendime gjobe	61	25
4	Vendime pezullimi	87	43
5	Vendime prishje	5	9
6	PV ekzekutimi të prishjeve	1	2
7	Kallëzime penale	-	-
8	Njoftime detyrimi	61	25
9	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	56	17

10	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	-	-
11	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1	1
12	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12	12
13	Raporte vjetore	1	1
14	Raporte mujore	12	12
15	Kërkesë për mjete pune (faromë)	1	1
16	Ankese Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë		1
17	Korrespondenca me urbanistikën (DPZHT) Bashkia Kukës	50	40
18	Korrespondenca me Policinë, Prokurorinë lidhur me kundërvajtësit	50	30
19	Kërkesë përcjellëse dhe për bashkëpunim (Drejtorisë F.I.ncës dhe Buxhetit, Drejtorisë Juridike) lidhur me gjokat bashkë me tabelat përkatëse.	7	7

Burimi: Bashkia Kukës

Nga auditimi rezultoi se Sektori i IMT, Bashkia Kukës për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022 ka miratuar planin vjetor të punës si dhe ka miratuar planet mujore për periudhën objekt sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

2. Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Titulli i gjetjes: Nivel i ulët i arkëtimit të gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Kukës.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që administrojnë IMTV-ja në Bashkinë Kukës u konstatua se **për vitin 2022 janë dhënë 25 masa “Dënim me gjobë”**. **Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2022 është 5,250,000 lekë.** Janë paguar në mënyrë vullnetare vetëm **7 gjoba** me vlerë **370,000 lekë** dhe mbeten për tu paguar **18 gjoba** me vlerë totale **4,880,000 lekë**. Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat ligjore që janë marrë nga IMTV Kukës për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave rezultoi se, ka filluar procesi për të arkëtuar gjobat që nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore. Të gjithë kundërvajtësit janë njoftuar për detyrimin që kanë si rezultat i shkeljes që është konstatuar nga IMTV. Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, rezultoi se

- Janë lëshuar nga Gjykata 11-Urdhër ekzekutimi vendimesh.
- Janë refuzuar nga Gjykata 4-vendime
- Janë 2- vendime gjobash në procesin “Kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi” drejtuar Gjykatës Administrative e shkallës së parë Shkodër, e cila nuk është shprehur ende.
- Për 1 vendim është dërguar akti "Njoftim detyrimi" për kundërvajtësin për të nisur procedurën Kërkesë për " Lëshim urdhër ekzekutimi" Gjykatës Administrative të shkallës së parë Shkodër. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Përveç gjobave të vendosura në vitin 2022 IMTV është në proces të ndjekjes së procedurave të arkëtimit edhe për gjobat e tjera të vendosur më herët. Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur gjobat që janë në proces nga IMTV, ndërsa lista e detajuar e gjobave të vendosura nga IMTV përpara vitit 2022 është trajtuar në raportin e mëparshëm të auditimit të KLSH-së.

Përmbledhëse e gjobave që janë në proces për t'u arkëtuar

Viti	Nr. gjobave	Vlera
2018	8	1,050,000

2019	17	3,810,000
2020	32	279,070,000
2021	59	25,900,000
2022	18	4,880,000
Totali	116	314,710,000

Burimi: IMTV Kukës, përpunoi grupi i auditimit

IMTV ka dërguar periodikisht informacion në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit lidhur me gjobat e vendosura, nga ana e kësaj të fundit rezulton se është bërë kontabilizimi i gjobave.

Për sa më sipër rezulton se, **në fund të vitit 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 314,710,000 lekë.**

Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, rezulton se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultat e duhura, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9 “Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji”, neni 22, pika 1, “Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji”, neni 3, pika 5 “Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë”.

Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë⁷.

Kriteri: ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Kukës nga mos arkëtim i gjobave të vendosura nga IMTV.

Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit nga IMTV për ndjekjen e hapave ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale 314,710,000 lekë, nga e cila vlera 4,880,000 lekë i përket vitit 2022. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në

⁷ Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve pika 1, “Gjopa dhe shumata, që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, pika 3 “Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 për qind në muaj të masës së gjobës, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm parashikon përqindje të ndryshme për kamatëvonesat”.

gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i vendimeve të mara nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bashkia Kukës, rezultoi se: Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më 31.12.2022 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Kukës, ka marrë 14 vendime për prishje objektesh pa leje (sipas tabelës së mësipërme), Referuar tabelës së sipërcituar rezulton se janë ekzekutuar vullnetarisht 8 vendime janë në proces gjyqësor 2 vendime, janë anuluar nga IMTV 2 vendime si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedurë për 2 vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara nga ana e IMT Bashkia Kukës për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Në mënyrë të detajuar vendimet e mara nga IMT për prishjen e objekteve pa leje paraqiten në aneksin nr. 3 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Kriteri: Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Shkaku: Moszbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e besueshmërisë në funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit si dhe të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IVMT lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi, në zbatim të **ligjit Nr.9780**, datë 16.07.2007, i ndryshuar, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10, Neni 12, Neni 15 dhe në zbatim të **ligjit 107/2014**, datë 31.7.2014, I ndryshuar, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 50, Neni 51, Neni 52.

Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, u evidentuan **11 raste** të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar njoftim fillim punimesh, të realizuar me punime të tjera që nuk përfshihen në pikat për të cilat është marrë autorizim për zhvillimin e punimeve dhe të realizuara jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit e certifikatën e përdorimit të miratuar.

Titulli i Gjetjes: Zhvillimi i ndërtimeve pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar njoftim fillim punimesh, të realizuar me punime të tjera që nuk përfshihen në pikat për të cilat është marrë autorizim për zhvillimin e punimeve dhe të realizuara jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit e certifikatën e përdorimit të miratuar.

Situata: Në bazë të verifikimeve për realizimin në terren të zhvillimit të territorit, u evidentuan **11 raste** të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar njoftim fillim punimesh, të realizuar me punime të tjera që nuk përfshihen në pikat për të cilat është marrë

autorizim për zhvillimin e punimeve dhe të realizuara jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit e certifikatën e përdorimit të miratuar, të pasqyruara si më me poshtë:

1. Në objektin 8 kate të pozicionuar në rrugën “Dëshmorët”, z. J.D. ka marrë autorizim për zhvillimin e punimeve të mirëmbajtjes së zakonshme me Nr. 6333 Prot., datë 03.11.2022. Në tarracën e objektit, në të cilën sipas lejes së ndërtimit zhvillohet dalja e nuklit të shkallëve dhe mbulesa mbi daljen e nuklit të shkallëve janë zhvilluar punime ndërtimi, duke krijuar një mbyllje me konstruksion metalik e vetratë xhami të sipërfaqes së tarracës, duke e shndërruar në ambient të shfrytëzueshëm, duke krijuar një kat shtesë mbi objektin ekzistues. Objekti zhvillohet në lartësinë e 9 kateve, nga lartësia e 8 kateve për të cilën është miratuar leja e ndërtimit. Shtesa e katit është realizuar pa u pajisur me leje ndërtimi. Për punimet e kryera nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për kundërvajtje dhe nuk është proceduar me vendim për prishje

2. Objekti “Godinë shërbimesh 3 kate”, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga "Kosova", lagjja nr. 2, Kukës, i pajisur me certifikatë përdorimi është zhvilluar në ndryshim nga leja e ndërtimit të miratuar. Më pas ka marrë një autorizim për zhvillimin e punimeve të mirëmbajtjes së zakonshme me Nr. 1124 Prot., datë 27.03.2023, por ka zhvilluar konstruksion me kolona, me çati dhe mbyllje me vetratë xhami, jashtë territorit të parcelës në të cilën zhvillohet objekti. Për punimet e kryera nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për kundërvajtje dhe nuk është proceduar me vendim për prishje.

3. Në zonën Shtiqën të Kukësit, u konstatua ndërtimi i shtesës së katit në një objekt ekzistues pa u pajisur me leje ndërtimi, punime të kryera nga Znj. M.M.. Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes me nr.415, datë 10.11.2022 dhe nr.409, datë 14.10.2022, por nuk janë marrë masat e duhura duke mos marrë vendim dënimi me gjobë dhe vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

4. Në zonën Shtiqën të Kukësit, në Urën 6-metroshe, u konstatua ndërtimi me konstruksion beton-arme i katit përdhe të një objekti pa u pajisur me leje ndërtimi, punime të kryera nga Znj. F.M.. Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes me nr.441, datë 08.05.2023 dhe vendimi nr.25, datë 08.05.2023, për pezullimin e punimeve, por nuk janë marrë masat e duhura duke mos marrë vendim dënimi me gjobë dhe vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

5. Në zonën Shtiqën të Kukësit, në Urën 6-metroshe, u konstatua ndërtimi me konstruksion beton-arme i katit përdhe të një objekti pa u pajisur me leje ndërtimi, punime të kryera nga Z. T.M.Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes me nr.372, datë 03.03.2022 dhe vendimi nr.212, datë 07.03.2022, për pezullimin e punimeve, por nuk janë marrë masat e duhura duke mos marrë vendim dënimi me gjobë dhe vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

6. Në lagjen nr.7, Zabel, u konstatuan konstruksione të reja ndërtimi pa u pajisur me leje ndërtimi, punime të kryera nga Z. A.D.. Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes me nr.437, datë 25.04.2023 dhe vendimi nr.255, datë 25.04.2023, për pezullimin e punimeve, por nuk janë marrë masat e duhura duke mos marrë vendim dënimi me gjobë dhe vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

7. Në lagjen nr.5, pranë xhamisë Kukës, u konstatua ndërtimi i karabI.së së një objekti 2 kate me çati pa u pajisur me leje ndërtimi, punime të kryera nga Z. G.C. Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes për zhvillimin e katit përdhe pa leje ndërtimi, me nr.276, datë 06.05.2021, me vendimin nr.126, datë 06.05.2021, për pezullimin e punimeve dhe me vendimin nr.121, datë 31.05.2021 është vendosur gjobë në vlerën 500.000 lekë. Gjithashtu është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes për ngritjen e

karabI.së dhe ndërtimit të çatisë, me nr.345, datë 17.09.2021, me vendimin nr.192, datë 17.09.2021, për pezullimin e punimeve dhe me vendimin nr.139, datë 06.12.2021 është vendosur gjobë në vlerën 50.000 lekë. Në objekt nuk janë pezulluar punimet, por kanë vijuar me punimet e ndërtimit, duke zhvilluar pjesërisht mbyllje me muraturë tulle dhe nuk janë marrë masat e duhura duke mos marrë vendim dënimi me gjobë për punimet e kryera dhe vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

8. Në lagjen e re, në rrugën Kukës-Uzinë km1,u konstatua ndërtim i objektit me kolona dhe muraturë me blloqe pa u pajisur me leje ndërtimi, punime të kryera nga Z. L.N. Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes me nr.382, datë 28.07.2022, vendimi nr.220, datë 28.07.2022, për pezullimin e punimeve dhe vendimi nr.177, datë 22.08.2022 me gjobë në vlerën 50.000 lekë. Objekti ka përfunduar punimet dhe nuk është marrë vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

9. Në lagjen nr.7, në Zabel, u konstatua ndërtimi me murëmbajtës, çati dhe shtimi me konstruksion i verandës me anë të një autorizimi nga Bashkia Kukës për punime mirëmbajtje të zakonshme, me nr.1655 Prot., datë 08.05.2023, punime të kryera nga Znj.F.C. Nga strukturat e IVMT-së Kukës është mbajtur procesverbali për konstatimin e kundërvajtjes me nr.489, datë 05.07.2023 dhe vendimin nr.272, datë 05.07.2023, për pezullimin e punimeve, por nuk janë marrë masat e duhura duke mos marrë vendim dënimi me gjobë dhe vendim për prishje e ndërtimit pa leje ndërtimi.

10. Në zbatimin në terren të lejes së ndërtimit të miratuar me Vendimi Nr.61,Datë 03/02/2022, për objektin “Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt”, me zhvillues S. ShPK, punimet e ndërtimit nuk janë realizuar në përputhje me lejen e ndërtimit, duke shtuar sipërfaqe ndërtimi në fasadën jugore dhe duke mos e realizuar kallkan fasadën nga lindja. Nga strukturat e IVMT-së Kukës nuk janë marrë masat e duhura për konstatimin e punimeve që nuk janë realizuar sipas projektit të ndërtimit.

11. Në zbatimin në terren të lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin Nr 171, datë 29/09/2020, lejes për ndryshim të projektit gjatë ndërtimit me vendimin Nr. 31, datë 02/03/2021 dhe miratimit të certifikatës së përdorimit me vendimin Nr.5489 datë 22/09/2022, u konstatua që realizimi i objektit nuk është në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar. Kati përdhe nuk është realizuar si ambient shërbimi dhe nuk është trajtuar me fasadë e vetratë xhami si në projektin e miratuar. Në plan vendosjen e miratuar në ndryshimin e projektit janë të pasqyruara disa shkallë që aksesojnë ambjentet e shërbimeve në hyrje të secilës godinë dhe rampë për personat me aftësi të kufizuar, të cilat nuk janë realizuar në zbatimin e projektit të ndërtimit. Gjithashtu godinat janë të ngritura 45 cm mbi nivelin e kuotës së sistemimit të terrenit përreth, në ndryshim nga realizimi. Çertifikata e përdorimit është miratuar pa përfunduar punimet. Nga strukturat e IVMT-së Kukës nuk janë marrë masat e duhura për konstatimin e punimeve që nuk janë realizuar sipas projektit të ndërtimit. Inspektoriati i Ndërtimit të Territorit në Bashkinë Kukës, nuk ka plotësuar detyrat funksionale, në zbatim të ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007, Neni 10, Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, Neni 12, Ushtrimi i kontrollit dhe ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 51, Inspektimi. Sa më sipër, është në mospërputhje me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51,“Inspektimi”, Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.

Kriteri: Ligji nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, “Inspektimi”, Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 5, “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, neni 12, “Ushtrimi i kontrollit”.

Ndikimi/Efekti: Ndërtimi i objekteve pa u pajisur me leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kondicioneve urbane, në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si dhe në respektimin e distancave.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e IVMT Kukës

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga IVMT Kukës të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve të ndërtimit, për marrjen e vendimeve të dënimit me gjobë, për marrjen e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi dhe ekzekutimit e tyre, në bazë të legjislationit në fuqi. Gjithashtu të verifikohet përputhshmëria dhe tipologjia e lejeve dhe autorizimeve të dhëna me situatën e kryer në terren për çdo rast.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. S.G.J., me detyrë Kryetari i Bashkisë Kukës,
2. Z. M.G., me pozicion Kryeinspektor i IVMT Kukës,
3. Z. E.D., me pozicion Kryeinspektor i IVMT Kukës,
4. Z. D.K., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
5. Z. Hasan Olloni, me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
6. Z. R.T., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
7. Z. M. R., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
8. Z. I.M., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
9. Znj. E.SH., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
10. Znj. M.S., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
11. Znj. G.E., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës,
12. Znj. F.S., me pozicion Inspektor i IVMT Kukës.

2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të programit të auditimit nr. 549/1prot., datë 20.06.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Kukës, referuar drejtimit të auditimit nr. 7, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

5. Dokumentacioni i vënë në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve, planet e veprimit, shkresën brenda 20 ditëve për planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve;

6. Urdhërin për njohjen dhe zbatimin me planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve;

7. Dokumentacion mbështetës për realizimin e rekomandimeve;

8. Pyetësori i dërguar ndaj subjektit Bashkia Kukës mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve;

Për sa më sipër konstatohet se:

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me shkresën e KLSH nr. 571/8prot., datë 19.09.2022 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për

Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Kukës, sipas Programit të Auditimit me nr. 571/1 prot. datë 13.06.2022.

Bashkia Kukës ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022, gjithashtu, nga institucioni nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, **pra janë pranuar të gjitha rekomandimet.**

2.7.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

Nga verifikimi rezulton se me shkresën nr. 5927 prot., datë 11.10.2022, ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022.

Në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, rezulton se:

Nga ana e Bashkia Kukës nuk është dërguar raporti mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor për zbatimin e rekomandimeve veprim jo në përputhje me përcaktimet e ligjit funksional për KLSH-në.

Gjithashtu rezulton se Bashkia Kukës nuk ka raportuar rregullisht në Këshillin e Njesisë (Këshillin Bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50 pika 5 “Auditimi i jashtëm”.

Titulli i gjetjes: Mos raportim brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit dhe mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Situata: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Kukës me shkresën nr. 5927 prot., datë 11.10.2022, ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022. Bashkia Kukës nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për f.incat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

Kriteri: Ligji nr. nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pikën nr. 2, neni 30, të ligjit e cila citon:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për f.incat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5., e cila citon se:

Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Kukës të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Kukës me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

2.7.3 Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Nga verifikimi rezulton se, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative, 5 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, të ardhurat të munguara. Gjithashtu i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kukës t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, masa Disiplinore për punonjësit e atakuar në material.

Nga auditimi rezulton se: nga 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat është realizuar pjesërisht 2 masë në proces zbatimi 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 13 masa.

Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Kukës, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Kukës nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Bashkia Kukës nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, nga titullari i Bashkisë Kukës se me shkresën nr. 5927 prot., datë 11.10.2022, ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022.

Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën e KLSH nr. 571/8prot., datë 19.09.2022 ka dërguar Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Kukës në të cilin, për përmirësimin e gjendjes, është kërkuar zbatimin i rekomandimeve në rubrikat Masa organizative, Masa për për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe të ardhura të munguara si dhe Masat Disiplinore të detajuara në plan veprimin e hartuar për këtë qëllim, për të cilat rezulton si më poshtë:

- Nga 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat është realizuar pjesërisht 2 masë në proces zbatimi 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 13 masa.

- Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

- Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Kukës, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Kukës nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm.

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe kontrollin” me ndryshime.

Shkaku: Mos ndjekja e gjitha procedurave për zbatimin e rekomandimeve për 13 masat organizative, për arkëtimin e të ardhurave të munguara për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 144,992,243 lekë të vlerës 17,966,783 lekë nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, mos arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV në vlerën totale prej 309,830,000 lekë, **nga mos pagesa e detyrimit për kontratat e qirave aktualisht është 1,628,127 lekë**, si dhe masat disiplinore për punonjësit të konstatuar me shkelje nga auditimi i mëparshëm.

Ndikimi/Efekti: Ndikon në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë së Bashkisë Kukës, mos mbledhjen e të ardhurave dhe rritjen e performancës së Institucionit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm në mënyrë të detajuar paraqitet më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” rezultoi se:

- Nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet publike, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj.

- Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si, dhe eprori direkt i Bashkisë Kukës, për vitin 2021 nuk kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

-Për vitin 2021 në Bashkinë Kukës, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, pika 3.3.

1.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kukës të merren masa për:

- Hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;

- Krijimin e procedurave për delegimin e detyrave;
- Hartimin e gjurmëve standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Vendosjen e një sistemi elektronik të mirëfilltë unik të mbajtjes së kontabilitetit;
- Hartimin e mekanizmave të cilat t'i dedikohen ankesave për korrupsion;
- Vendosjen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT;

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe ka ngarkuar drejtorit përkatëse për zbatimin e rekomandimit. Deri në momentin e verifikimit situata ngelet e pa ndryshuar. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kukës, rezulton se:

- Një auditues është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Kukës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 183, datë 13.09.2019, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit.
- Nuk është planifikuar dhe nuk është kryer auditim në fushat me risk si, në sektorin IMTV-së, sektori i taksave dhe tarifave vendore, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.
- Në programet dhe në procesin e auditimit të NJAB nuk konstatohet ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, e cila sjellë shkallë të ulët të zbatimit të tyre nga subjektet e audituara. Për vitin 2021, nga 303 rekomandime të dhëna, janë zbatuar 16 rekomandime dhe janë pa zbatuar 287 rekomandime.
- Nuk është kërkuar nga auditi i brendshëm që subjektet e audituara, pas marrjes së rekomandimeve të hartojnë planin për zbatimin e tyre.

2.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Kukës të marrë masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën në vazhdim të organizohet dhe të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar, kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH si dhe ka ngarkuar drejtorinë e Burimeve Njerëzore për zbatimin e rekomandimit si she AB. Rezulton se referuar strukturës organizative të miratuar me Vendimi i Këshillit Nr.71 date 24.12.2021, për miratimin e strukturës organizative dhe konfirmimi i Prefektit shkresën Nr. 1/62 date 06.01.2022, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë, është bërë plotësimi i strukturës së AB me 4 punonjës.

Gjithashtu sektori I AB me shkresën nr. 4448 datë 07.10.2021 ka dërguar Drejtorisë së harmonizimit planin e auditimeve për vitin 2022 ku në program është parashikuar dhe programi i zbatimeve të rekomandimeve për vitin 2022. Si dhe nuk ka planifikuar fushat me risk në përzgjedhjen e subjekteve. **Ky rekomandim është Zbatuar pjesërisht.**

3. Gjetje nga auditimi: Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim fin.ncimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 është 193,912,437 lekë, krahasuar me vlerën në fillim të vitit ushtrimor prej 158,489,871 lekë, është rritur me 35,422,566 lekë, ose në masën prej 22%.

Edhe pse janë marrë masa të mira për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2021, konstatohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor për të gjithë periudhën e auditimit. Peshën kryesore të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta e zënë detyrimet ndaj institucioneve të tjera buxhetore në vlerën 85,867,527 lekë dhe detyrimet për investime prej 45,071,088 lekë, të ndjekura nga detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 22,417,656 lekë, detyrime për mallra në vlerën 11,020,394 lekë, detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 1,063,545 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 12,682,171 lekë, detyrime për mirëmbajtje në vlerën 6,465,584 lekë, detyrime për tatimin mbi të ardhurat në vlerën 1,274,221 lekë, të tjera 8,050,251 lekë.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, në rritje progresive mbi nivelin prej 25 për qind (> 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 56, pika 1.

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: *Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH si dhe ka ngarkuar Drejtorinë e Financës. Sipas dokumentacionit rezulton se me shkresën nr. 398 prot., datë 03.02.2023 në MFE në lidhje me detyrimet e prapambetura ku gjendja aktuale me 31.12.2022 paraqitet në vlerën 168,213,052 lekë. Nga të cilat vlera 84,419,759 lekë i përket institucionet buxhetore. Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.*

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 7,043,241 lekë, nga e cila vlera 4,720,812 lekë i përket 7 vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, ndërsa vlera 2,322,429 lekë për 2 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore. Vlera e pa likuiduar e vendimeve

gjqësore më datë 31.12.2021 referuar listave analitike që administrojnë Bashkia Kukës është 7,864,084 lekë për 18 vendime.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në likuidimin e vendimeve gjyqësore, nuk ka respektuar radhën e likuidimit sipas përparësisë kohore, bazuar në radhën e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8.

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, të marrë masa që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: *Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH si dhe ka ngarkuar Drejtorinë e Financës. Sipas dokumentacionit rezultoi se me shkresën nr. 265 prot., datë 24.01.2023 drejtuar degës së thesarit Kukës me kërkesën për “Sistemimin e detyrimeve të prapambetura. Ky rekomandim është në proces zbatimi.*

5. Gjetje nga auditimi: Vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2021 është 193,912,437 lekë, ndërsa vlera totale e detyrimeve të prapambetura sipas akt rakordimeve me thesarin është 108,044,910 lekë. Në këtë vlerë nuk përfshihet vlera prej 85,867,527 lekë që i përket detyrimit për institucionet buxhetore. Gjithashtu, Bashkia Kukës nuk ka deklaruar në raportimin e bërë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë vlerën e plotë të vendimeve gjyqësore. Vlera e deklaruar është 1,063,545 lekë ndërsa vlera sipas listave analitike është 7,864,084 lekë. Një pjesë e vendimeve gjyqësore nuk janë deklaruar si detyrime sepse Bashkia Kukës ka nënshkruar marrëveshje për likuidimin me këste të detyrimit dhe një pjesë nuk janë regjistruar sepse janë paraqitur me vonesë në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI.

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në raportimin që dërgon në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar në fund të vitit, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH si dhe ka ngarkuar Drejtorinë e Financës. Sipas dokumentacionit rezulton se me shkresën nr. 398 prot., datë 03.02.2023 në MFE nga ku rezulton përsëri me diferenca të cilat vinë si shkak i vlerës së detyrimit prej 84,419,759 lekë ndaj institucioneve të ndryshme shtetërore është raportuar në MFE por nuk është e pasqyruar në akt rakordimet me thesarin sepse rregjistrimi i këtyre detyrimeve është ende në proces rakordimi apo një pjesë janë në proces gjyqësor. Vlera e detyrimeve të rakordua me thesarin është 83,793,293 lekë (168,213,052 - 84,419,759). **Ky rekomandim është i pa zbatuar.**

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pavarësisht kërkesave që ka dërguar në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2021 nuk ka marrë informacion ose ai ka qenë jo i plotë. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DAPPLL për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Gjatë hartimit të paketës fiskale 2023 dhe në vijimësi

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk janë bërë ndryshime në miratimin e paketës fiskale. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

7. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të audituara, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqitet në vlerën 2,370,800 lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për vitin 2021 është në vlerën 568,328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, dhe VKB nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”. Gjithashtu rezulton se, Bashkia Kukës ka filluar punën për të saktësuar numrin e familjeve që kanë tokë bujqësore me AMTP si dhe kategoritë që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota për të llogaritur më pas saktësisht planifikimin e të ardhurave nga toka bujqësore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën

bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë.

Deri në Dhjetor 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk janë bërë ndryshime në miratimin e paketës fiskale. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 "Disponibiliteti në thesar" nuk paraqet gjendjen e saktë në bilanc. Kjo llogari duhet të sistemohet për diferencën 102,907,074 lekë, ku nga 280,267,814 duhet të jetë 158,359,154 lekë. Llogaritë e klasës 5 nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8/2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP" pika 46/a , 49, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 520 "Disponibiliteti në thesar" në vlerën 158,359,154 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

8.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar akt rakordimit me degën e thesarit Kukës llogaria 520 "Disponibiliteti në thesar" paraqitet në vlerën **250,479,334 lekë e cila** nuk rakordon me llogarit kundërparti në pasiv të bilancit, respektivisht llogaria 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" paraqitem në vlerën 23,392,531 lekë dhe llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" paraqitet në vlerën 149,444,012 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për diferencën 77,642,791 lekë, ku nga **250,479,334** duhet të jetë 172,836,543 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analitikëve të llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve i përkasin edhe objekteve të përfunduara, duke siguruar vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 5,611,778 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të kryejë veprimet e sistemimit për llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime" duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

9.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk është bërë sistemimi i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime". **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

10. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të regjistrimit dhe pajisjes me titull pronësie të aktiveve për llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe llogarinë 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" të paraqitur 0 lekë në

bilanc, në kundërshtim me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

10.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk është bërë sistemimi i llogarive të sipërcituara në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

11. Gjetje nga auditimi: Aktivet afatgjata materiale të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në vlerën 1,531,017,817 lekë janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Kukës nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Kukës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk është bërë sistemimi i llogarisë së sipërcituara në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

12. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë 215 “Mjete transporti” rezulton se është aplikuar norma e amortizimit 20 % dhe jo 13.8%. Si rezultat kjo anomali ka sjellë që llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM” të mbivlerësohet me 1,759,884 lekë, pasi vlera e saj në pasqyrat financiare është 1,100,466,218 lekë, kur në fakt duhet të jetë 1,098,695,329 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”, respektivisht në vlerën 1,098,695,329 lekë për vitin 2021.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

12.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk është bërë sistemimi i llogarisë së sipërcituara në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

13. Gjetje nga auditimi: Vlera e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk është e njëjtë me tepricën e llogarisë 520. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 10,607,978 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 10,607,978 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

13.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Kukës me shkresën nr. 1683/1, datë 15.11.2022 ka hartuar planin e veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Rezulton se për vitin 2022 nuk është bërë sistemimi i llogarisë së sipërcituara në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kukës nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 14,758,973 lekë për vitin 2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 14,758,973 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 49-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 14,758,973 lekë për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

14.1.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi dhe mbetet po e njëjta situatë edhe për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. nr. 448/8 Prot., datë 20.10.2021, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 69-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit të KLSH, rezulton se:

- Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës **57,847,995 lekë** të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së.

- Nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës **14,537,823 lekë pa TVSH** nga z. A.F. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe z. P.TH., në cilësinë e Shefit të Tatim Taksave, për dëmin e shkaktuar nga procesi i inventarizimit dhe menaxhimit të mallit “Karburant”.

Mos marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 69-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të arkëtojë vlerën e mbetur prej 57,847,995 lekë, përsa i takon zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të KLSH-së.

- Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 14,537,823 lekë pa TVSH nga z. A.F. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe z. P.TH., në cilësinë e Shefit të Tatim Taksave, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.

- Të merren masa për ndjekjen e 15 rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe që gjithashtu janë trajtuar edhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë legalizimin e banesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitet 2018-2020 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në

infrastrukturë 300 subjekte të legalizuara me vlerë 11,536,508 lekë. Për vitin 2021 janë legalizuar gjithsej 184 objekte me detyrim ndaj Bashkisë Kukës për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 6,430,275 lekë. **Në total të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Kukës nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet janë në vlerën 17,966,783 lekë për 484 debitorë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-së nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2021”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 484 debitorë në vlerën 17,966,783 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Kukës rezultoi se, gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën 4,793,595 lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare në shumën 3,222,231 lekë dhe detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 1,571,274 lekë.

Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore më mënyrë progresive më 31.12.2021 në Bashkinë Kukës janë në vlerën **144,992,243 lekë** të përbëra nga:

- **9,294,922 lekë** detyrime nga **2181** familje për pagesat e taksave dhe tarifave vendore;
- **135,697,321 lekë** detyrime nga **486** subjekte fizik/juridik.

Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **9,294,922 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifat familjare;
- **135,697,321 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifat e bizneseve.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

3. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kukës janë 4 subjekte (G.P., V.SH., S.P.A., D. 2001 SHPK) që rezultojnë aktiv në QKB dhe operojnë të pa pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G.P., V.SH., S.P.A. dhe D. 2001 SHPK dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qirave dhe dokumentacionit lidhur me pagesat për të gjitha kontratat rezulton se, më datë 31.12.2021 janë 5 qiramarrës (E.-SHPK&E. SHPK, E.-SHPK-2 kontrata, A. ShA, L. & K. E. SHPK) që nuk i kanë paguar detyrimet referuar kushteve të kontratës. Këto detyrime arrijnë në vlerën totale 4,750,643 lekë. Subjektet E.-SHPK (2 kontrata) dhe L. & K. E. kanë paguar detyrimet gjatë vitit 2022 ndërsa subjekti A. ShA, ka lidhur marrëveshje për pagesë më këste ku ka paguar vlerën 600,000 lekë dhe i mbeten për të paguar edhe 393,333 lekë. **Si rezultat vlera e të ardhurave të munguara nga mos pagesa e detyrimit për kontratat e qirave aktualisht është 1,628,127 lekë.**

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave nuk disponon një regjistër të plotë dhe të përditësuar për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënien me qira të aseteve të bashkisë. Nuk janë të regjistruara saktë afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit. Për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës, veprime në kundërshtim me nenet e kontratave të qirave përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrin masa që qiramarrësit E. SHPK & E. SHPK, dhe A. ShA të paguajnë detyrimet referuar kushteve të kontratës në vlerën totale **1,628,127 lekë** (E. SHPK në vlerën 1,234,794 lekë dhe A. ShA në vlerën 393,333 lekë). Gjithashtu, në vijimësi DAPK të ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

DAPK të hartojë një regjistër të plotë dhe të saktë për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënien me qira të aseteve të bashkisë. Të përditësojë saktë të dhënat mbi afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administron Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Kukës lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve rezulton se, **për vitin 2021** nuk janë paguar **59 gjoba** me vlerë totale **25,900,000 lekë**.

IMTV ka bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, duke njoftuar kundërvajtësit për detyrimin që kanë, duke dërguar në gjykatë të gjitha gjobat për të bërë të mundur nxjerrjen e titullit ekzekutiv si dhe duke dërguar në përmbarrim një pjesë të gjobave, por rezulton se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultatet e duhura. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9. **Në fund të vitit 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV për periudhën 2018-2021 janë në vlerën totale 309,830,000 lekë.**

Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 23-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale **309,830,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

D. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa

disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Kukës t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kukës nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim është pa zbatuar.

Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Kukës nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 690/7 prot., datë 25.10.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:

-Nga 16 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht për zbatim 16 Masa Organizative, nga 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat është realizuar pjesërisht 2 masë në proces zbatimi 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 13 masa.

-Nga 5 Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë realizuar të 5 masat.

-Për rekomandimin në lidhje me marrjen e masave disiplinore në kompetencë të Bashkisë Kukës: Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i përealizuar.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi titullari i Bashkisë z. S.GJ., z. M.I., z. Sh. D.i, z. A.SH. dhe zj. M. D.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i të dhënave të paraqitura në vetëvlerësimin e Bashkisë Kukës, të dhënat e mbledhura nga përgjigjet e pyetësorit të realizuar nga grupi i auditimit, si dhe rezultatet e testeve të kryera, u konstatua se komponentët e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe kontrollit nuk po funksionojnë mjaftueshëm në gjithë strukturat e njësisë. Edhe pse ka përpjekje për të arritur konsolidimin dhe përmirësimin e funksionimit ende ka hapësira për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit.

“Mjedisi i kontrollit”

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezultoi se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Vërtetimet e lëshuara nga ky institucion përgatiten dhe protokollohen pa u depozituar më parë në protokoll një kërkesë me shkrim nga qytetarët për tu pajisur me këto shërbime si dhe mungojnë formatet standarde të miratuara për aplikim sa i përket llojeve të shërbimeve që ofron ky institucion. Në evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se nuk kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave dhe mungon një

analizë e këtij procesi ku të trajtohen problematikat e konstatuara me të cilat është ndeshur ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe plani i masave për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Nga shqyrtimi i evidencave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se struktura organizative e miratuar për vitin 2022, përbëhet nga 713 punonjës, 68% të pozicioneve të strukturës të cilat përfaqësojnë 482 pozicione pune nuk kanë të përcaktuar detyrat dhe kompetencat në rregulloren e brendshme, konkretisht: Sekretari i Këshillit Bashkiak, Koordinatori i Njësisë Administrative, Sekretari i Sekretariatit të Këshillit Bashkiak, 16 Drejtor Drejtorie, 5 Shefa Sektori , Kryeinspektori i policisë bashkiake, 10 Përgjegjëse sektori , 4 Inspektorë , 147 Specialistë dhe edukatore, 207 Punonjës ndihmës/Roja Operative/ Shofer administrate./Sanitare dhe 89 Policë bashkiak, punonjës të sigurisë zjarrfikës.

“Menaxhimi i Riskut”

Në evidencat e vëna në dispozicion nga Bashkia Kukës nuk u evidentuan analiza konkrete sa i përket kontrollit të funksionimit të strategjisë së miratuar të riskut në nivel programi, aktiviteti, lidhur me nivelin e realizimit të objektivave, evidentimit të problematikave që patën ndikim në realizimin e objektivave dhe përgatitjen e planit të masave për minimizimin e riskut lidhur me to në të ardhmen. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, mungon vlerësimi për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.

“Aktivitetet e Kontrollit”

Bashkia Kukës nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Bashkia Kukës ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsisë. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie.

-Bashkia Kukës ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Kukës ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës.

“Informimi dhe komunikimi”

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Kukës dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, sipas nivelit të hierarkisë shkëmbehet në mënyrë shkrese dhe elektronike dhe verbale. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pasi menaxhimit i mungojnë raportet e nevojshme lidhur me performancën e njësisë në raport me objektivat e caktuara.

“Monitorimi”

Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e

Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 19-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Titullari i Bashkisë Kukës, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Koordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. Të merren masa për përcaktimin e detyrave dhe kompetencave sipas pozicioneve të strukturës së Bashkisë. Të kryhet monitorimi i respektimit të afateve për trajtimin e kërkesave/ankesave në mënyrë që të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve. Të merren masa që të plotësohet struktura e punonjësve si dhe krijimi i organigramave sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm u konstatua se: 1. Disa nga subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, nuk kanë paraqitur Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna. 2. Drejtuesja e Njësisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka kryer sigurimin e cilësisë së punës. Plani Strategjik pjesë e të cilit është dhe plani vjetorë është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE për vitet 2022-2024 me shkresën nr. 4448 Prot., datë 07.10.2021, bazuar në standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Plani vjetor i auditimit për vitin 2022 është ndryshuar me urdhrin nr.853 prot. datë 01.11.2022, plani i ndryshuar është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 6261 Prot. datë 02.11.2022. Në relacionin bashkëngjitur praktikës për ndryshimin e planit drejtuesi i njësisë shprehet se: *“ndryshimi i planit për vitin 2022 ka ardhur si rezultat i angazhimit të kësaj njësie në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin paraardhës nga auditimi i brendshëm, qenia e kësaj njësie në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH për periudhën qershor-korrik dhe mungesa e burimeve njerëzore në dispozicion të kësaj njësie për vitin 2022.”* Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masat e nevojshme që ndryshimi i planit të kryhej më përpara si dhe jo gjatë vitit, duke mos cënuar eficientësinë e punës audituese. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *“Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *“Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”*; Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 *“Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”*, Kapitulli IV, pika 4.1.1 *“Plafikimi i një angazhimi auditimi”*, Kapitulli IV, pika 4.1.12 Hapi 11, Kapitulli VII, pika 7.1.1 *“Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet vetë nga NjAB”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 19-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditim i u konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, pasi planifikimi ka vlerën 146,581,425 lekë, ndërsa realizimi vlerën 209,035,532 lekë, ose në masën 143%. Tejkalmi i planit me 43%, nuk ka ardhur si rezultat i arkëtimit nga ndonjë taksë e pa mundur për tu parashikuar më parë, por nga mungesa e një plani të studiuar dhe të pa mbështetur në të dhëna reale të numrit të taksapaguesve privat dhe familjar, si dhe pa bërë llogaritje konkrete për të ardhurat që realizohen nga secila lloje takse dhe tarife vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mos identifikimit të faktorëve të cilët ndikojnë në planifikimin jo të saktë, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Kukës, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalmimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 70, datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të mare masa për grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë si dhe të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më 31.12.2022 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Kukës, ka marrë 14 vendime për prishje objektesh pa leje nga ku rezulton se janë ekzekutuar vullnetarisht 8 vendime janë në proces gjyqësor 2 vendime, janë anuluar nga IMTV 2 vendime, si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedurë për 2 vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara nga ana e IMT Bashkia Kukës, për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Në mënyrë të detajuar vendimet e mara nga IMT për prishjen e objekteve pa leje paraqiten në aneksin nr. 3 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 123-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatohet vendimi i prishjes së objektit si dhe të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Referuar analizimit të të dhënave bazuar në shkresën nr. 398 prot datë 03.02.2023, rezulton se vlera totale e detyrimeve të prapambetura që deklarohet në MFE për vitin 2022 është në vlerën 168,213,052 lekë, por duke marrë parasysh faktin që vlera për

institucionet buxhetore prej 84,419,759 lekë nuk është regjistruar në thesar për arsyen e përmendur më lart, në total vlera e detyrimeve i takon të jetë **83,793,293** lekë (168,213,052 - 84,419,759). Përsa i takon vlerës së detyrimeve financiare për vitin 2022, Bashkia Kukës klasifikohet se e ka vlerën e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta, poshtë nivelit prej 25 për qind (< 25%) të shpenzimeve vjetore të miratuara, referuar shkresës përcjellëse në MFE. Bashkia është klasifikuar në kategorinë me vështirësi financiare dhe kjo tregon se vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin e dytë pasues, të muajit të përcaktuar në ligj. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës ka dërguar në MFE edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Sipas këtij plani shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2023 është 35,717,090 lekë, shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2024 është 45,650,000 lekë dhe shuma e parashikuar për shlyerje në vitin 2025 është 88,569,097 lekë. Gjithashtu, përsa i takon faturave të pa likuiduara rezultojnë 61 fatura të pa likuiduara për shërbime (tabelës 10/1) në vlerën 63,656,753 lekë, e cila nuk përputhet me totalin e raportuar në bilancin e vitit 2022 referuar llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila ka vlerën 0 lekë ndërsa llogaria 467 “Kreditore të ndryshëm” ka vlerën 392,934 lekë dhe llogaria 401-408 ka vlerën 66,592,381 lekë, në total detyrimet në pasiv janë në vlerën 66,985,315 lekë e cila nuk rakordon me detyrimet e raportuara në MFE. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu XI “Vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre”, neni 56, pika 1. Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për të ndjekur me përpikmëri planin 3-vjeçar që kanë hartuar për mënyrën e likuidimit të detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe të kryejë procesin e rakordimit me institucionet përkatëse për vlerat e detyrimeve të prapambetura që regjistrohen në thesar. Gjithashtu të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Kukës dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Referuar akt rakordimit me degën e thesarit Kukës llogaria 520 “Disponibiliteti në thesar” paraqitet në vlerën **250,479,334 lekë e cila** nuk rakordon me llogarit kundërpasiv në pasiv të bilancit, respektivisht llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” paraqitem në vlerën 23,392,531 lekë dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në vlerën 149,444,012 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për diferencën 77,642,791 lekë, ku nga **250,479,334** duhet të jetë 172,836,543 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP” pika 46/a , 49, 50, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 54-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marri masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” në vlerën 77,642,791 lekë.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për vitin 2022 Bashkia Kukës nuk ka kryer procesin e inventarizimit çka do të thotë që llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike. Konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke mos specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s' kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për llogaritë 32- "Inventar i imët", 202- "Studime dhe kërkime", 210- "Toka, Troje, Terrene", 211 – "Pyje, Plantacione" llog 212- "Ndërtesa e Konstruksione", 213- "Ruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore", 214 – "Instalime teknike, makineri e pajisje", 215- "Mjete Transporti". *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 54-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të pasqyruar në llogarit analitike inventariale. Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve, me të gjithë elementët e nevojshëm të tij.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 15,423,224 lekë, ndërsa më 31.12.2022 paraqitet në vlerën **23,392,531 lekë**. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e Financës nuk ka bërë përditësimin e listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 "Kreditor për mjete në ruajtje". Mungesa e këtij informacioni, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 54-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në **5 (pesë)** procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s'kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjen. Gjithashtu rezulton se disa prej kërkesave të veçanta, në këto

procedura si dhe specififikimet teknike nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, duke sjellë një konfuzion ndaj OE pjesëmarrës, nuk është sqaruar lidhja e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrës së kontratës. ***Këto kritere nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP, vendosja e tyre, ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrin ligjor për prokurimin publik.*** Veprime e mosveprime që nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, nenin 3, Kreu V, neni 21, pikat 1 dhe 5, neni 36, pika 4, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, nenin 2, neni 12, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2, pagarafti dytë, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3, neni 61, pika 2, pagarafti dytë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 69-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga “Kosova”, lagjja nr.2, Kukës, në shqyrtimin e projektit të ndërtimit dhe mbivendosjen me plan sistemin, evidentohet që daljet konsol në katin e parë zhvillohen jashtë kufirit të pronës dhe nuk pasqyrohet me përmasat e sakta në planvendosjen e miratuar. Nga auditimi, u konstatua se për objektin “*Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt*”, miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës, në përshkrimet dhe specififikimet e paraqitura në planvendosje nuk përputhen me projektin arkitektonik, pasi evidentohet që fasada lindore nuk është faqe kallkan. Sa më sipër, nuk janë në përputhje me VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 15, pika 1, gërma c, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese; (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 116-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar planvendosjen e paraqitur si edhe të dhënat e përshkruara në të, që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektet e mëposhtme nuk janë respektuar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës sipas kritereve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit: **1.** “*Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt*”, miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës; **2.** “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga “Kosova”, lagjja nr. 2, Kukës. Sa më sipër, nuk është në përputhje VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 35, “*Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës*”; me “*Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kukës*”, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.8, datë 08.02.2017, Neni 7, pika 16. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 116-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për objektin *Shtesë 2 kate, mbi objektin ekzistues 1kt*, miratuar me vendim Nr.61, datë 03/02/2022, me zhvillues S. ShPK, në rrugën “D.”, Kukës, në dokumentacionet e ngarkuara në sistemin e-leje, të cilat vërtetojnë pronësinë e truallit dhe ndërtesës në të cilën do të zhvillohen katet shtesë, paraqiten të dhëna dhe përkthime të ndryshme lidhur me sipërfaqen ekzistuese të ndërtimit përpara miratimit të shtesës. Sa më sipër, nuk është në përputhje me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në neni 15, pika b. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5., faqe 116-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë, që të vërtetojnë ekzistencën e objektit në të cilin do të zhvillohet shtesa e kateve të ndërtimit në hartën treguese, në të dhënat/përkthimet e paraqitura në kartelën e pasurisë dhe të mos ketë kufizim të pronësisë, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se realizimi i punimeve të ndërtimit nuk janë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar për objektet:

1. “*Godinë shërbimesh 3 kate*”, miratuar me vendimin Nr. 4034, datë 13/06/2022, me zhvillues N.D., në adresën “Rruga "Kosova", lagjja nr. 2, Kukës.

2. “*Objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë dhe objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë*”, miratuar me vendimin Nr.5489 datë 22/09/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në adresën Lagjja 5, Kukës. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 42, “*Çertifikata e përdorimit*”; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5., faqe 116-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se certifikata e përdorimit është miratuar përpara përfundimit të punimeve të ndërtimit në objektin: “*Objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë dhe objekt 8 kate banimi dhe shërbimi me një kat parkimi nën tokë*”, miratuar me vendimin Nr.5489 datë 22/09/2022, me zhvillues Enti Kombëtar i Banesave, në adresën Lagjja 5, Kukës. Sa më sipër, nuk është në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar, neni 42, “*Çertifikata e përdorimit*”, VKM 408, datë 13.5.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 17, pika e dhe nenet 27 dhe 27/1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 116-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Kukës të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi objekte pa verifikuar më parë përfundimin e realizimit të punimeve të ndërtimit.

15. Gjetje nga Auditimi: Për vitin 2022, Nga auditimi ka rezultuar se për 43 procedurat e prokurimit të kryera u konstatuan se në **20 procedura** prokurimi në shumën totale të fondit limit në vlerën **11,790,868 lekë pa TVSH**, është bërë klasifikim i ndryshëm i kodeve CPV (Kodi Përkates Në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit) dhe i objektit të prokurimit për procedura me natyrë të ngjashme duke sjell copëzimin e fondit për blerje me vlera të vogla të një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe në asnjë procedurë nuk është argumentuar dhe dokumentuar nëse përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë është bërë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit në të gjitha rastet nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

Në 2 procedura me Kod CPV të njëjtë “Punë Ndërtimi” dhe objekt prokurimi të ngjashëm të cilat janë zhvilluar në muajin Tetor me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,750,000 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde e prokurimit.

Në 7 procedura me Kod CPV të ngjashëm “Shërbime të organizimit të eventeve” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë periudhës Mars – Qershor, me shumën totale të fondit limit në vlerën 2,862,500 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në 7 procedura me Kod CPV të njëjtë “Mbikëqyrja e punës së ndërtimit” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 2,706,748 lekë pa TVSH është copëzuar fondin dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në 2 procedura me Kod CPV të njëjtë “Projekte” dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,904,221 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

-**Në 2 procedura** me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2022, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,725,000 lekë pa TVSH është copëzuar fondi dhe janë shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Për vitin 2021, Nga auditimi ka rezultuar se për 31 procedurat e prokurimit të kryera u konstatuan se në **10 procedura** prokurimi në shumën totale të fondit limit në vlerën **5,650,000 lekë pa TVSH**, është bërë klasifikim i ndryshëm i kodeve CPV (Kodi Përkates Në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit) dhe i objektit të prokurimit për procedura me natyrë të ngjashme duke sjell copëzimin e fondit për blerje me vlera të vogla të një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve dhe në asnjë procedurë nuk është argumentuar dhe dokumentuar nëse përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë është bërë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi. Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit në të gjitha rastet nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

- **Në 2 procedura** me Kod CPV të ngjashëm “Shërbime të organizimit të eventeve”, objekt prokurimi të ngjashëm me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,400,000lekë pa TVSH pasi u shqyrtuan dokumentacioni i dosjeve konstatohet se për këto procedura janë përzgjedhur objekte prokurimi dhe kode CPV të ndryshme por ato kanë natyrë të njëjtë sa i përket mallrave dhe

shërbimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në këto procedura duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në 2 procedura me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar në muajin Nëntor, me shumën totale të fondit limit në vlerën 950,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në 4 procedura me Kod CPV të ngjashëm dhe objekt prokurimi të njëjtë, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,575,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në 2 procedura me Kod CPV dhe objekt prokurimi të ngjashëm, të cilat janë zhvilluar përgjatë vitit 2021, me shumën totale të fondit limit në vlerën 1,725,000 lekë pa TVSH duke copëzuar fondin dhe shmangur procedurat standarde të prokurimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 69-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: Nga ana e Titullarit të Institucionit në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese të merren masa e nevojshme si më poshtë:

-Komisioni i Blerjeve të Vogla, të marrë masa për administrimin e çdo procedurë në dosje të veçanta.

-Të hartojë fondin limit duke pasqyruar metodën e ndjekur dhe dokumentacionin provues.

-Të hartojë procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e 10-të.

-Komisioni i Blerjeve të Vogla, të firmosë faturat e tvsh-së për blerjen e mallit ose shërbimit të kryer.

-Komisioni i Blerjeve të Vogla, të përcaktojë në urdhrin e prokurimit fondin e përllogaritur.

-Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për planifikimin e blerjeve dhe shërbimeve, duke mos kryer copëzim të fondeve.

-Drejtoria Ekonomike, të kryejë likuidimin e faturave brenda afatit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në dokumentacionin e paraqitur për pjesëmarrje në këtë procedurë nga OE në shtojcën 7, mbi plotësimin e deklaratës së konfliktit të interesit, është deklaruar se “nuk është në kushtet e konfliktit të interesit” me punonjës të AK.

Në formularin e deklaramit bashkëngjitur praktikës së krijimit të grupit të punës nënshkruar më datë 26.09.2022 nga z. K.T., ky punonjës ka deklaruar dhe nënshkruar ekzistencën e konfliktit të interesit.

Në listëpagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore, dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën ushtrimore viti 2022 muajin gusht z. K.T. figuron si i punësuar në të njëjtën kohë në Bashkinë Kukës dhe pranë OE “D.” Shpk gjithashtu ky punonjës është i biri i ortakut të vetëm të OE Fitues, z. K.D.

Me urdhrin nr. 752 prot., datë 26.09.2022 të nënshkruar nga z. G.GJ., në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari i AK z. S.GJ., “Për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit, për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojërave për kopshtin nr.2, lagjia nr.3”, z. K.T. është caktuar anëtar i këtij grupi pune edhe pse ky punonjës ka deklaruar më parë se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit .

Me urdhrin nr. 5744 prot., datë 04.10.2022 është hartuar/nënshkruar procesverbali “Për argumentimin dhe dokumentimin e vlerës së fondit limit dhe për hartimin e specifikimeve teknike”, për procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojërave

për kopshtin nr. 2, lagjja nr.3” dhe shkresa me të njëjtin numër protokolli, drejtuar Drejtorisë Juridike.

Në urdhrin e prokurimit nr.752 datë 04/10/2022 formulari 2 “Për prokurimin me vlera të vogla” të nënshkruar nga z. G.GJ. në cilësinë e personit të autorizuar nga titullari i AK z. S.GJ. është përzgjedhur procedura e prokurimit me vlerë të vogël për procedurën “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojërave për kopshtin nr.2, lagjja nr. 3” dhe më datë 07/10/2022 është nisur ftesa për ofertë me nr 5841/1 prot. OE “D.” Shpk, edhe pse nga z. K.T. është deklaruar konflikti i interesit. Nga verifikimi i dokumentave në dosje dhe në SPE, rezultoi se për procedura me Kod CPV të njëjtë “Punë ndërtimi” dhe objekt prokurimi të ngjashëm të cilat janë zhvilluar në muajin Tetor respektivisht më datë 06.10.2022 dhe 10.10.2022, me vlerën totale të fondit limit 1,750,000 lekë pa Tvsh, me OE “D.” Shpk fitues, konstatohet copëzim i fondi duke shmangur procedurat standarde të prokurimit.

Në praktikën shkresore të procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojërave për kopshtin nr.2, lagjja nr.3” dhe procedurës me objekt: “Rikualifikim i terreneve sportive në shkollën 9-vjecare “Lidhje e P.t” Kukës”, u konstatua që ekzistojnë nga dy formularë për deklarimin e mospasjes së konfliktit të interesit me shprehje të kundërta nga z. E.SH. (kryetar), znj. G.E. dhe znj. N.P. (anëtare të komisionit) konkretisht:

Për procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i oborrit dhe këndit të lojërave për kopshtin nr.2, lagjja nr.3” më datë 07.10.2022, komisioni deklaron dhe nënshkruan ekzistencën e konfliktit të interesit dhe më datë 10.10.2022 deklaron/nënshkruan se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit.

Për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikualifikim i terreneve sportive në shkollën 9-vjeçare “Lidhje e P.t Kukës” më datë 05.10.2022, komisioni deklaron dhe nënshkruan ekzistencën e konfliktit të interesit dhe më datë 06.10.2022 deklaron/nënshkruan se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit. Nga shqyrtimi i raportit përmbledhës (REF-44755-10-07-2022) datë 18.10.2022 konstatohet se:

Ftesa për ofertë ju është nisur 5 (pesë) OE (OE “M.” Shpk, OE “D.” Shpk, OE “P. G.” Shpk dhe OE “O.” Shpk) por nuk është argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë sipas përcaktimeve të bëra në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit nuk është hartuar dhe plotësuar bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 99 “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit”.

Nga Komisioni i Prokurimit të Blerje me vlerë të vogël në bazë të kriterit të çmimit më të ulët më datë 10.10.2022, është shpallur fitues OE “R.” Shpk, renditur në vend të parë por nuk është paraqitur sipas afateve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. KVO nuk ka bërë njoftimin përkatës në APP, për OE lidhur me mosparaqitjen pa njoftuar në procedurën që shpallet fitues.

Me Procesverbalin e datës 11.10.2022, KVO ka dërguar njoftimin e fituesit për OE “D.” Shpk, renditur në vend të dytë, me vlerë ekonomike të ofertës 830,000 lekë pa Tvsh, pas kalimit të afatit të ankimit me procesverbalin e mbajtur në datë 17.10.2022, në bazë të kriterit të çmimit më të ulët ky komision shpall fitues OE “D.” Shpk e renditur në vend të dytë.

Kontrata me nr.120 Prot., datë 18.10.2022, është lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kukës, përfaqësuar nga z. S.GJ. në cilësinë e Titullarit të Ak dhe OE “D.” Shpk, përfaqësuar nga z. K.D. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor për OE “D.” Shpk.

Për këtë çështje KVO nuk ka s’kualifikuar këtë OE, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit. Deklarata e paraqitur nga OE konsiderohet e rreme, dhe punonjësi nuk ka vënë në

dijeni AK, për këtë situatë. Gjithashtu KVO, në dijeni të ndodhjes përpara faktit të një konflikti interesi të mundshëm, nuk ka sinjalizuar në instancat përkatëse për këtë dukuri, dhe nuk është shprehur në Raportin përfundimtar mbi vlerësimin e ofertave, të cilën ja ka paraqitur titullarit të AK. Titullari ka miratuar dhe raportin e KVO, për të cilën ka dijani të kësaj dukurie dhe përsëri nuk ka bërë asnjë vendimmarrje, për punonjësin i cili është në marrëdhënie pune edhe te OE “D.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 69-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kukës dhe strukturave Drejtuese të merren masa për të zëvendësuar anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të kryhet procesi i dokumentimit dhe gjurmës së auditimit në mënyrë të tillë që në të ardhmen të parandalohen situata ku mund të ketë anëtarë të komisioneve në kushte të konfliktit të interesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna konstatohet se, Bashkia Kukës ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën me shkresën nr. 5927 prot., datë 11.10.2022, por nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezulton se Bashkia Kukës nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për fll.ncat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm u konstatua se, Bashkia Kukës nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas Projektraportit të Auditimit dhe anekseve përkatëse, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022 për zbatimin e rekomandimeve pasi nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative e ligjore për përmirësimin e gjendjes, konkretisht:

- Nga 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat është realizuar pjesërisht 2 masë në proces zbatimi 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 13 masa.

Nga 5 për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara, janë pranuar për zbatim 5 masa, nuk janë zbatuar të 5 masat.

Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Kukës, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Kukës nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm, për të cilën kjo masë rezulton e pa zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 129-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Rikërkojmë

zbatimin e rekomandimeve që janë të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përshejtimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi si vijon:

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kukës të merren masa për:

- Hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;
- Krijimin e procedurave për delegimin e detyrave;
- Hartimin e gjurmëve standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Kukës;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Vendosjen e një sistemi elektronik të mirëfilltë unik të mbajtjes së kontabilitetit;
- Hartimin e mekanizmave të cilat t'i dedikohen ankesave për korrupsion;
- Vendosjen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit IT;

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, të marrë masa që jo vetëm të regjistrojë të gjitha vendimet gjyqësore që paraqiten pranë saj, por edhe të hartojë grafikun e likuidimit të tyre, duke u bazuar në përparësinë e paraqitjes së tyre në njësinë shpenzuese. Kryetari i Bashkisë Kukës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Kukës, në raportimin që dërgon në MFE dhe në akt rakordimin me thesarin, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të të gjitha detyrimeve që kanë mbetur pa u likuiduar në fund të vitit, me qëllim identifikimin e vlerës reale të detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e realizimit.

Gjatë hartimit të paketës fiskale 2023 dhe në vijimësi

7.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën 1,802,472 lekë.

Deri në Dhjetor 2022

8.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 520 “Disponibiliteti në thesar” në vlerën 158,359,154 lekë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

9.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të kryejë veprimet e sistemimit për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa:

-Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”, duke krijuar regjistrat me të dhënat e datës së hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, etj.

-Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacionin përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

11.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Kukës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë sistemimin e normës së amortizimit për llogarinë 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”, respektivisht në vlerën 1,098,695,329 lekë për vitin 2021.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 10,607,978 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

14.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 14,758,973 lekë për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

15.1 Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1. Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të arkëtojë vlerën e mbetur prej 57,847,995 lekë, përsa i takon zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të KLSH-së.

-Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 14,537,823 lekë pa TVSH nga z. A.F. në cilësinë e Shefit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe z. P.TH., në cilësinë e Shefit i Tatim Taksave, vlerë

kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues.

-Të merren masa për ndjekjen e 15 rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe që gjithashtu janë trajtuar edhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 484 debitorë në vlerën 17,966,783 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtime të reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Kukës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **9,294,922 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifatat familjare;

- **135,697,321 lekë** detyrime nga taksat dhe tarifatat e bizneseve.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarrja për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G.P., V.SH., S.P.A. dhe D. 2001 SHPK dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrin masa që qiramarrësit E. SHPK & E. SHPK, dhe A. ShA të paguajnë detyrimet referuar kushteve të kontratës në vlerën totale **1,628,127 lekë** (E. SHPK në vlerën 1,234,794 lekë dhe A. ShA në vlerën 393,333 lekë). Gjithashtu, në vijimësi DAPK të

ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

DAPK të hartojë një regjistër të plotë dhe të saktë për regjistrimin e të gjitha kontratave që lidhen për dhënien me qira të aseteve të bashkisë. Të përditësojë saktë të dhënat mbi afatet e kontratave, vlera e tyre si dhe pagesat periodike që kryhen nga qiramarrësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale **309,830,000 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Kukës t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.**

MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”, sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “C.” ShPK me Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 305,672,177 lekë me TVSH, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet progresive, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 5 (pesë) zëra punimesh në shumën 983,375 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “GJ.&CO” ShPK, Nr.82Prot. datë 02.07.2021 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Optimizimi i furnizimit me ujë të qytetit të Kukësit, Bashkia Kukës, Faza III”, Neni 7, “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Punimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 69-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 983,375 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "C." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.55 Prot. datë 26.04.2021 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë e në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar ‘Havzi Nela’, Kukës”, sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “C.” ShPK me Nr.139Prot. datë 25.11.2022 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 127,064,830.80 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet progresive, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 7 (shtatë) zëra punimesh në shumën 1,384,600 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Kukës dhe OE “M.” ShPK, Nr.140 Prot. datë 25.11.2022 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për objektin, Rikualifikim i shkollës së mesme të bashkuar ‘Havzi Nela’, Kukës”, Neni 7, “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Punimeve”., “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të Punimeve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 69-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Kukës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për zbritjen e punimeve të certifikuara më tepër dhe rakordimin e tyre, të vlerës 1,384,600 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik, në situacionet pasardhës deri në atë përfundimtar, përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve OE "C." ShPK me të cilin është lidhur kontrata Nr.139Prot. datë 25.11.2022 për zbatimin e punimeve.

Menjëherë e në vijimësi

MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, referuar të dhënave të vëna në dispozicion, pritshmëria e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kukës paraqiten në vlerën 2,370,800 lekë, ndërsa planifikimi i bërë nga DAPPLL për vitin 2022 është në vlerën 568,328 lekë. Diferenca në planifikim është 1,802,472 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 2. VKB-së nr. 70, datë 24.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me Drejtorinë e Bujqësisë për evidentimin e saktë të familjeve të pajisura me certifikatë pronësie të tokës bujqësore me qëllim planifikimin sa më të saktë të taksës mbi tokën bujqësore, si dhe për të shmangur mungesën e të ardhurave vjetore në buxhetin e Bashkisë Kukës në vlerën **1,802,472 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se struktura që administron dokumentacionin dhe përlogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Referuar auditimit të ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se në fundin e vitit 2022 në territorin e Bashkisë Kukës janë legalizuar 766 objekte me vlerë totale të taksës së ndikimit në infrastrukturë për t'u paguar 28,513,783 lekë, kanë paguar detyrimin 142 qytetarë në vlerën 4,577,342 lekë dhe janë ende debitor ndaj bashkisë 624 qytetarë me vlerë 23,936,441 lekë. Vetëm për vitin ushtrimor 2022 nuk kanë paguar detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë 109 qytetar në vlerën 5,904,323 lekë. Gjithashtu rezulton se, gjatë vitit 2022 nga ASHK nuk është dërguar informacion i plotë në Bashkinë Kukës lidhur me objektet e legalizuara. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; VKB-në nr. 70, datë 24.12.2021 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 624 debitorë në vlerën 23,936,441 lekë.**

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Kukës konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën **146,202,964 lekë.** Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën **30,166,419 lekë.** Në total detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Kukës janë në **vlerën 176,369,383 lekë, e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) për buxhetin e Bashkisë Kukës e përbëra nga:**

Vlera e borxhit tatimor më datë 31.12.2021.

Detyrimet nga taksat dhe tarifave familjare në shumën 10,505,643 lekë (1943familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifave e bizneseve në shumën 135,697,321.00 lekë (486 subjekte);

Borxh i krijuar gjatë vitit 2022

Detyrimet nga taksat dhe tarifave familjare në shumën 4,040,222 lekë;

Detyrimet nga taksat dhe tarifave e bizneseve në shumën 26,126,197 lekë (439 subjekte);

Vlera e borxhit tatimor më datë 31.12.2022

Detyrimet nga taksat dhe tarifave familjare në shumën 14,545,865 lekë (2247 familje);

Detyrimet nga taksat dhe tarifave e bizneseve në shumën 161,823,517.88 lekë (471subjekte);

Lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës konstatohet se, të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore nuk janë marrë masa të tjera ligjore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me force e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, neni 114, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35, dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10. Ligjin nr. 68/2017, "Për fll.ncat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën: Detyrimet nga taksat dhe tarifatat familjare në shumën 14,545,865 lekë (2247 familje); Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve në shumën 161,823,517 lekë (471subjekte);

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kukës, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga strukturat e Bashkisë Kukës DAPPLL rezulton se në këtë bashki janë 4 subjekte (G.P., V.SH., S.P.A., D. 2001 SHPK) që rezultojnë aktiv në QKB dhe operojnë të pa pajisur me autorizim për ushtrimin e aktivitetit për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht - VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante” si dhe VKB-në nr. 70, datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Kukës për vitin 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë verifikimet e dokumentacionit të subjekteve G.P., V.SH., S.P.A. dhe D. 2001 SHPK dhe të marrë masa që këto subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën përkatëse. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Kukës u konstatua se **për vitin 2022** janë dhënë 25 masa “*Dënim me gjobë*”. **Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2022 është 5,250,000 lekë.** Janë paguar në mënyrë vullnetare vetëm **7 gjoba** me vlerë **370,000 lekë** dhe mbeten për tu paguar **18 gjoba** me vlerë totale **4,880,000 lekë.** Nga IMTV Kukës për të bërë të mundur arkëtimin e gjobave rezulton se, ka filluar procesi për të arkëtuar gjobat që nuk janë paguar në mënyrë vullnetare nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore. Të gjithë kundërvajtësit janë njoftuar për detyrimin që kanë si rezultat i

shkeljes që është konstatuar nga IMTV. Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, rezulton se

- Janë lëshuar nga Gjykata 11-Urdhër ekzekutimi vendimesh.

- Janë refuzuar nga Gjykata 4-vendime

- Janë 2- vendime gjobash ne procesin “Kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi” drejtuar Gjykatës Administrative e shkalles se pare Shkodër, e cila nuk është shprehur ende.

- Për 1 vendim është dërguar akti "Njoftim detyrimi" për kundërvajtësin për të nisim procedurën Kërkesë për " Lëshim urdhër ekzekutimi" Gjykatës Administrative të shkalles së parë Shkodër. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Gjithashtu rezulton se në fund të vitit 2022 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale **314,710,000 lekë**. Edhe pse nga ana e IMTV janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e arkëtimit të gjobave, rezulton se masat e marra kanë qenë të vonuara dhe ende nuk kanë dhënë rezultat e duhura, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, neni 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 123-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare vlerën e gjobës së vendosur nga IMTV për vlerën totale 314,710,000 lekë, nga e cila vlera 4,880,000 lekë i përket vitit 2022. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kukës**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

A. “Vërejtje me paralajmërim”, për;

1. **Z. A.SH.**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi, si dhe në **3** raste në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në **2** raste të miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me planvendosjet e miratuara, në mosrespektimin e distancave, në realizimi e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratua;
2. **Zj. D.B.**, me detyrë specialiste pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe

specifikimeve teknike, në 2 procedura, si dhe në 3 raste në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me planvendosjet e miratuara, në mosrespektimin e distancave, në realizimi e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar;

“Vërejtje” për;

1. **Z. E.T.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike për problemet e konstatuara, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, si dhe në hartimin e regjistrave të prokurimit në 1 procedurë si dhe në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.
2. **Z. H.M.**, me detyrë Specialiste prokurimesh, për problemet e konstatuara në lidhje hartimin e kriterëve të kualifikimit, specifikimeve teknike dhe fondit limit jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik në 3 procedura;
3. **Zj. E.P.**, me detyrë Shef i Sektorit të Planifikimit të Territorit, për problemet e konstatuara, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 3 procedura si dhe në 3 raste në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të çertifikatave të përdorimit jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me planvendosjet e miratuara, në mosrespektimin e distancave, në realizimi e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me lejen e ndërtimit të miratuar;
4. **Zj. M.D.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike, për problemet e konstatuara, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 3 procedura;
5. **Z. G.M.**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura;
6. **Z. H.O.**, me detyrë Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, për 11 raste të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar njoftim fillim punimesh, të realizuar me punime të tjera që nuk përfshihen në pikat për të cilat është marrë autorizim për zhvillimin e punimeve dhe të realizuara jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit e certifikatën e përdorimit të miratuar, në mospërputhje me Inspektimin e Ndërtimit dhe kriteret e përcaktuara në Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit;
7. **Z. M.R.**, me detyrë Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, për 11 raste të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar njoftim fillim punimesh, të realizuar me punime të tjera që nuk përfshihen në pikat për të cilat është marrë autorizim për zhvillimin e punimeve dhe të realizuara jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit e certifikatën e përdorimit të miratuar, në mospërputhje me Inspektimin e Ndërtimit dhe kriteret e përcaktuara në Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit;
8. **Znj. O.M.**, me detyrë topografe, për problemet e konstatuara në lidhje me miratimin e 1 leje ndërtimi dhe 1 çertifikatë përdorimi, jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në

Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

9. **Znj. O.L., me pozicion juriste**, për problemet e konstatuara në lidhje me miratimin e 2 leje ndërtimi dhe 1 çertifikatë përdorimi, jo në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe sipas kriterëve të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
10. **Z. M.G., me detyrë Kryeinspektor i IVMT Kukës**, për 11 raste të cilat janë ndërtuar pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaruar njoftim fillim punimesh, të realizuar me punime të tjera që nuk përfshihen në pikat për të cilat është marrë autorizim për zhvillimin e punimeve dhe të realizuara jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit e certifikatën e përdorimit të miratuar, në mospërputhje me Inspektimin e Ndërtimit dhe kriteret e përcaktuara në Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit;

Për punonjësit të cilët kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Kukës, cilët janë trajtuar me Shërbim civil apo Kodin e Punës për arsye se janë larguar, masa e dhënë konsiderohet e ezauruar dhe konkretisht për:

1. **Z. E.D.**, me pozicion Ish-Kryeinspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, i cili është larguar nga puna.
2. **Z. D.K.**, me pozicion Ish-Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, i cili është larguar nga puna.
3. **Z. R.T.**, me pozicion Ish-Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, i cili është larguar nga puna.
4. **Z. I.M.**, me pozicion Ish-Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, i cili është larguar nga puna.
5. **Zj. E.SH.**, me pozicion Ish-Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, e cila është larguar nga puna.
6. **Zj. M.S.**, me pozicion Ish-Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, e cila është larguar nga puna.
7. **Zj. G.E.**, me detyrë specialiste e prokurimeve pranë Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve Publike, për problemet e konstatuara, në cilësinë e hartuesit të fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, në 3 procedura, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, e cila është larguar nga puna.
8. **Zj. F.S.**, me pozicion Ish-Inspektor pranë IMTV Bashkia Kukës, në lidhje me vendimmarjen e procedurave të Inspektoratit të mbrojtjes së territorit Vendor, për të cilin masa e dhënë do të ishte **“Vërejtje”**, i cili është larguar nga puna.

V. ANEKSET

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të

dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT